



**QEVERISJE MË E MIRË PËR NJË NDIKIM MË TË MADH**

*Një thirrje për qytetarët*

**RAPORTI ANALITIK  
PËR KOSOVË**

Mars 2011

**INDEKSI I SHOQËRISË  
CIVILE I CIVICUS**

Raporti Analitik për Kosovë i Indeksit të Shoqërisë Civile të CIVICUS është përgatitur nga ekipi hulumtues i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), në këshillim dhe mbikqyrje të hulumtuesëve dhe këshilltarëve të programit të CIVICUS.

### **KOORDINATOR I ISHC-SË DHE AUTOR**

Taulant Hoxha

### **EKIPI I HULUMTUESËVE TË KCSF-SË**

Besnike Koçani

Fidan Hallaqi

Suzana Arni

Arben Shala

Hajrulla Çeku

Armend Bekaj

### **EKIPI I HULUMTUESËVE DHE KËSHILLTARËVE TË PROGRAMIT TË CIVICUS**

Amy Bartlett

Mark Nowottny

Tracy Anderson

Yosi Echeverry Burckhardt

Andrew Firmin

David Kode

### **EDITUES DHE DIZAJNI**

Fidan Hallaqi

*IMPLEMENTIMI I INDEKSIT TË SHOQËRISË CIVILE TË CIVICUS PËR KOSOVË DHE KY PUBLIKIM JANË PËRKRAHUR FINANCIARISHT NGA TRUSTI BALLKANIK PËR DEMOKRACI (BTD).*

## PARATHËNIE

*Pas një dekade zhvillimesh të hovshme, Kosova tani është futur në një fazë të re të shtet-ndërtimit, fazë kjo që kërkon kontributin e të gjithë aktorëve të përfshirë në këtë proces. Shoqëria civile duhet që të marrë parasysh këto zhvillime të reja shoqërore dhe t'i përshtatet rolit të saj të ri në kuadër të kornizës së përgjithshme shtet-ndërtuese. Me qëllim të një kalimi sa më të lehtë dhe të suksesshëm në këtë rol të ri, shoqëria civile dhe të tjerët duhet të jenë të vetëdijshëm për sfidat dhe problemet e të kaluarës, sikurse që duhet të shfrytëzojnë nga përvojat e suksesshme të nismave të ndryshme të shoqërisë civile.*

*Mu për këtë Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), nëpërmjet Aleancës Botërore për Pjesëmarrje Qytetare CIVICUS, dhe i përkrahur nga Trusti Ballkanik për Demokraci (BTD), vendosi që të ndërmarrë Indeksin e Shoqërisë Civile (ISHC) për Kosovë. Duke synuar që të kontribuojë në zhvillimin e gjithëmbarshtëm të shoqërisë civile, ISHC përfshinë rishikim, mbledhje, validim dhe analizë të një spektri të gjërë të informatave, mbi të cilat pastaj janë nxjerrë një numër i rekomandimeve konkrete për të gjitha palët e përfshira. Një agjendë vepruese gjithëpërfshirëse kërkon qasje të re në shumë nivele dhe përfshin në vete njohuri, përkushtim dhe burime nga të gjithë sektorët e shoqërisë.*

*Të gjeturat konfirmojnë që shoqëria civile është një pjesë integrale e shoqërisë në përgjithësi dhe si e tillë e luan rolin e saj varësisht hapësirës së ofruar nga ambienti brenda të cilit vepron. Edhe pse plotësisht të vetëdijshëm për nevojën e gjetjes së mënyrës për t'u bërë përfaqësues të interesave të qytetarëve dhe për të vepruar në përputhje me parimet më të mira të qeverisjes së mirë, përgjegjësia dhe sfida për rritjen e ndikimit të shoqërisë civile bie gjithashtu edhe mbi një spektër të gjërë të aktorëve shoqërorë, duke përfshirë autoritetet publike, mediat, donatorët dhe të tjerët. Për këtë arsye edhe të gjeturat dhe rekomandimet e prodhuara nga ky studim mund të përdoren si një dokument bosht për të gjitha institucionet vendore dhe ndërkombëtare të interesuara në avancimin e mëtejshëm të këtij sektori.*

*Fuqizimi i shoqërisë civile deri në atë nivel ku mund të jetë aktor i fuqishëm në ndërtimin e një shteti dhe shoqërie demokratike është një proces i gjatë. Do të jetë i domosdoshëm dialogu dhe kontributet nga të gjitha palët deri sa të gjithë të kuptojmë mundësitë që shoqëria civile mund t'i ofrojë shoqërisë në përgjithësi, por edhe limitet me të cilat ky sektor ballafaqohet. Në këtë drejtim dija e bazuar në fakte e ofruar nga ky raport është një kontribut i rëndësishëm, ndërsa informatat e detajuara do të duhej të nxisnin debate dhe veprime rreth aspekteve të ndryshme të shoqërisë civile.*

*Dëshiroj të vlerësoj punën e shkëlqyeshme të bërë nga ekipi hulumtues, i cili u ballafaqua me vështirësi serioze gjatë mbledhjes së të dhënave sekondare relevante dhe për këtë arsye u desh që të japë angazhim shtesë rreth prodhimit të informatave të mjaftueshme për këtë studim gjithëpërfshirës mbi shoqërinë civile. Gjithashtu, dëshiroj të vlerësoj kontributin e secilit pjesëmarrës në aktivitetet e ISHC-së – Komitetit Këshillues, Grupeve të Fokusit, Punëtorisë Kombëtare dhe të gjitha hulumtimeve të veçanta – të cilat na ofruan informata nga dora e parë dhe këshilla për të gjitha segmentet e studimit.*


*Shpreh një mirënjohje e veçantë për Aleancën Botërore për Pjesëmarrje Qytetare CIVICUS dhe ekipit të tyre të ISHC-së për udhëzimet dhe ndihmën e vazhdueshme në këtë zbatim të parë në Kosovë të metodologjisë globale. Përkrahja e tyre ishte shumë e rëndësishme për të arritur standardet e kërkuara ndërkombëtare dhe për të vendosur Kosovën në hartën e shteteve të cilat e vlerësojnë shoqërinë civile në këtë format.*

*Për fund, dëshiroj të shpreh konsideratën e thellë për Trustin Ballkanik për Demokraci për përkrahjen financiare të ISHC-së. Në kuadër të kontributit për ndërtimin e një shoqërie demokratike në Kosovë,*

*përkrahja e BTD-së për këtë projekt ka shënuar një hap para në përkrahjen e vazhdueshme për zhvillimin e shoqërisë civile në Kosovë.*

*Pas Antologjisë së Shoqërisë Civile të vitit 2001, Analizës së Shoqërisë Civile në Kosovë të vitit 2005 dhe shumë studimeve dhe aktiviteteve drejt rritjes së njohurive rreth shoqërisë civile, Indeksi i Shoqërisë Civile për Kosovë 2011 nuk do të jetë studimi i fundit gjithëpërfshirës rreth këtij sektori. KCSF mbetet e përkushtuar për të vazhduar me kontributin e saj rreth avancimit të sektorit nëpërmjet përbushjes së misionit për përkrahje të shoqërisë civile për të promovuar një kulturë demokratike dhe për t'iu përgjigjur nevojave socio-ekonomike të Kosovës.*

Venera Hajrullahu



Drejtoreshë Ekzekutive

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile

## FALENDERIME

Që nga periudha e përgatitjes, Indeksi i Shoqërisë Civile për Kosovë në aktivitetet e tij ka përfshirë një spektër të gjërë të institucioneve, organizatave të shoqërisë civile, donatorëve, mediave, qarqeve akademike, kompanive private dhe individëve. Vetëm me pjesëmarrjen e plotë të të gjithë partnerëve dhe bashkëpunëtorëve të tij ky projekt ka arritur të bëhet një studim pjesëmarrës rreth gjendjes së shoqërisë civile në Kosovë, sikurse që ka arritur të prodhojë edhe rekomandime konkrete bazuar në të gjeturat e studimit.

KCSF shfrytëzon rastin të shprehë konsideratat më të larta për kontributin profesional të të gjithë anëtarëve të Komitetit Këshillues (KK): Alban Bokshi (QOHU!), Aliriza Arenliu (DokuFest), Anton Berishaj (Universiteti i Prishtinës), Ariana Qosaj – Mustafa (Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave), Besim Kajtazi (Qeveria e Kosovës – Zyra e Kryeministrit), Erolld Belegu (EBC dhe Federata e Basketbollit të Kosovës), Flaka Surroi (Grupi Koha), Habit Hajredini (Qeveria e Kosovës – Zyra për Qeverisje të Mirë), Igballe Rogova (Rrjeti i Grave të Kosovës), Ilir Deda (Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave), Iliriana Kaçaniku (Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur), Luan Shllaku (Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur), Naxhije Buçinca (Shoqata e Veteranëve të Arsimit), Petrit Tahiri (Qendra për Arsim e Kosovës), Raba Gjoshi (Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut), Ramadan Ilazi (Lëvizja FOL), Shpend Ahmeti (Instituti GAP), Valon Murati (Qendra për të Drejtat e Njeriut në Universitetin e Prishtinës), Venera Hajrullahu (Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile), Zeqir Veselaj (Qendra Rajonale e Mjedisit – Zyra në Kosovë).

Falenderojmë edhe të gjithë respondentët e Hulumtimit të Popullësisë, Hulumtimit të Organizatave dhe Hulumtimit të Perceptimeve të Jashtme, si dhe të gjithë pjesëmarrësit në takimet e Grupeve të Fokusit dhe Punëtorisë Kombëtare, për përkushtimin e tyre në ndarjen e përvojave dhe komentimin e të dhënave të mbledhura. Gjithashtu, falenderojmë edhe Fondacionin Together, për përfundimin e shkëlqyeshëm të Hulumtimit të Popullësisë brenda një kohe rekorde.

Mirënjohje të veçantë KCSF shpreh edhe për Trustin Ballkanik për Demokraci (BTD), për përkrahjen financiare të këtij projekti dhe përkrahjen e vazhdueshme të shoqërisë civile në Kosovë. Partneriteti dhe komunikimi i shkëlqyeshëm me zyrtarët e projektit Jovan Jovanović dhe Nathan Koeshall e ka bërë BTD-në kontribues të drejtpërdrejtë në suksesin e këtij projekti.

Në fund, vlerësimi kryesor shkon për ekipin e hulumtuesëve të KCSF-së, të cilët kanë qenë të përfshirë në fazat e ndryshme të këtij projekti: Besnike Koçani, Fidan Hallaqi, Suzana Arni, Arben Shala, Hajrulla Çeku, Armend Bekaj si dhe moderatorët dhe raportuesit tjerë të Punëtorisë Kombëtare: Fatmir Curri, Zeqir Veselaj, Rinor Beka, Ramadan Ilazi, Genta Gagica, Dren Puka and Mimika Loshi. Vlerësim i veçantë shkon për Taulant Hoxhën – Koordinatorin e ISHC-së dhe autorin e këtij raporti, për përkushtimin e tij të madh në udhëheqjen e gjithë projektit dhe shkrimin e publikimeve finale, si dhe për Drejtoreshën Ekzekutive të KCSF-së Venera Hajrullahu, për përkrahjen e vazhdueshme dhe këshillat e shkëlqyeshme përgjatë gjithë implementimit të këtij projekti.

## PËRMBAJTJA

|  |    |
|--|----|
| PARATHËNIE.....  | 2  |
| FALENDERIME .....                                      | 4  |
| LISTA E SHKURTESAVE.....                               | 8  |
| PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....                           | 9  |
| HYRJE.....   | 11 |
| PROJEKTI DHE QASJA E INDEKSIT TË SHOQËRISË CIVILE..... | 12 |
| 1. Historiku i Projektit .....                         | 13 |
| 2. Qasja e Projektit.....                              | 14 |
| 3. Zbatimi i ISHC-së .....                             | 16 |
| 4. Kufizimet e Studimit ISHC .....                     | 17 |
| SHOQËRIA CIVILE NË KOSOVË.....                         | 19 |
| 1. Koncepti i Shoqërisë Civile .....                   | 19 |
| 2. Pasqyra Historike e Shoqërisë Civile .....          | 20 |
| 3. Përshkrimi i Shoqërisë Civile .....                 | 21 |
| ANALIZA E SHOQËRISË CIVILE .....                       | 23 |
| 1. Angazhimi Civil .....                               | 23 |
| 1.1. Shtrirja e angazhimit shoqëror.....               | 23 |
| 1.2. Thellësia e angazhimit shoqëror .....             | 24 |
| 1.3. Diversiteti i angazhimit shoqëror .....           | 24 |
| 1.4. Shtrirja e angazhimit politik .....               | 24 |
| 1.5. Thellësia e angazhimit politik.....               | 25 |
| 1.6. Diversiteti i angazhimit politik .....            | 26 |
| 1.7. Përfundimet .....                                 | 26 |
| 2. Niveli i Organizimit .....                          | 27 |
| 2.1. Qeverisja e brendshme .....                       | 27 |
| 2.2. Infrastruktura .....                              | 28 |
| 2.3. Komunikimi sektoral .....                         | 28 |
| 2.4. Burimet njerëzore .....                           | 28 |
| 2.5. Burimet financiare dhe teknologjike.....          | 29 |
| 2.6. Lidhjet ndërkombëtare .....                       | 30 |
| 2.7. Përfundimet .....                                 | 31 |
| 3. Praktikimi i Vlerave .....                          | 32 |
| 3.1. Qeverisja me vendim-marrje demokratike .....      | 32 |
| 3.2. Rregulloret e punës.....                          | 33 |
| 3.3. Kodi i mirësjelljes dhe transparenca .....        | 33 |
| 3.4. Standardet mjedisore .....                        | 33 |



|   |   |    |
|---|---|----|
| 3.5.  | Perceptimet e vlerave në shoqërinë civile si tërësi ..... | 34 |
| 3.6.  | Përfundimet .....   | 35 |
| 4.  | Ndikimi i Perceptuar .....                                | 36 |
| 4.1.  | Reagueshmëria (perceptimi i brendshëm) .....              | 36 |
| 4.2.  | Ndikimi shoqëror (perceptimi i brendshëm) .....           | 37 |
| 4.3.  | Ndikimi në politika (perceptimi i brendshëm) .....        | 37 |
| 4.4.  | Reagueshmëria (perceptimi i jashtëm).....                 | 38 |
| 4.5.  | Ndikimi Shoqëror (perceptimi i jashtëm).....              | 38 |
| 4.6.  | Ndikimi në Politika (perceptimi i jashtëm).....           | 38 |
| 4.7.  | Ndikimi i shoqërisë civile në qëndrime .....              | 39 |
| 4.8.  | Përfundimet .....   | 40 |
| 5.  | Ambienti i Jashtëm.....                                   | 41 |
| 5.1.  | Konteksti socio-ekonomik.....                             | 41 |
| 5.2.  | Konteksti socio-politik.....                              | 42 |
| 5.3.  | Konteksti socio-kulturor.....                             | 44 |
| 5.4.  | Përfundimet .....   | 46 |
| PËRPARËSITË DHE DOBËSITË E SHOQËRISË CIVILE ..... |   | 47 |
| 1.  | Përparësitë .....   | 47 |
| 2.  | Dobësitë .....  | 48 |
| REKOMANDIMET.....                                 |   | 51 |
| 1.  | Angazhimi Civil .....                                     | 51 |
| 2.  | Niveli i Organizimit.....                                 | 53 |
| 3.  | Ndikimi i Perceptuar .....                                | 54 |
| 4.  | Praktikimi i Vlerave .....                                | 56 |
| 5.  | Ambienti i Jashtëm.....                                   | 57 |
| PËRFUNDIMET.....                                  |   | 59 |
| 1.  | Angazhimi Civil .....                                     | 59 |
| 2.  | Niveli i Organizimit.....                                 | 60 |
| 3.  | Ndikimi i Perceptuar .....                                | 60 |
| 4.  | Praktikimi i Vlerave .....                                | 61 |
| 5.  | Ambienti i Jashtëm.....                                   | 61 |
| SHTOJCAT .....                                    |   | 63 |
| BIBLIOGRAFIA.....                                 |   | 71 |

**LISTA E TABELAVE**

*Tabela 1: Lista e vendeve implementuese të ISHC-së 2008-2011* ..... 13

*Tabela 2: Angazhimi Civil – Rezultatet e nën-dimensioneve*..... 23

*Tabela 3: Niveli i Organizimit – Rezultatet e nën-dimensioneve*..... 27

*Tabela 4: Praktikimi i Vlerave Rezultatet e nën-dimensioneve*..... 32

*Tabela 5: Ndikimi i Perceptuar – Rezultatet e nën-dimensioneve* ..... 36

*Tabela 6: Ambienti i Jashtëm – Rezultatet e nën-dimensioneve*..... 41

*Tabela 7: Rezultatet e indikatorëve të kontekstit socio-politik*..... 42

*Tabela 8: Përqindja e qytetarëve që mendojnë që veprime të caktuara kurrë nuk mund të arsyetohen* ..... 45

**LISTA E FIGURAVE**

*Figura 1: Diamanti i Indeksit të Shoqërisë Civile* ..... 15

*Figura 2: Procesi i Implementimit të Indeksit të Shoqërisë Civile*..... 16

*Figura 3: Shtrirja e angazhimit shoqëror* ..... 23

*Figura 4: Antarësimi në organizatat shoqërore dhe politike* ..... 25

*Figura 5: Si do ta vlerësonit qasjen e OSHC-ve kur aplikojnë për fonde te donatorët?* ..... 27

*Figura 6: Të ardhurat dhe Shpenzimet e OSHC-ve të hulumtuara, krahasuar me vitin paraprak* ..... 30

*Figura 7: Burimet e financimit të fondeve për shoqërinë civile në Kosovë* ..... 30

*Figura 8: Kush i merr vendimet kryesore në organizatën tuaj?* ..... 32

*Figura 9: A mendoni se rastet e korrupsionit në shoqëri civile janë*..... 34

*Figura 10: Ndikimi i shoqërisë civile në zhvillimin ekonomik dhe sundimit e ligjit (perceptimi i brendshëm)* ..... 36

*Figura 11: Krahasimi i perceptimit të brendshëm dhe të jashtëm në ndikimin e shoqërisë civile në politikë-bërje në përgjithësi* ..... 38

*Figura 12: Niveli i besimit në sektorë të ndryshëm të OSHC-ve* ..... 39

*Figura 13: Rregulloret dhe ligjet kosovare për shoqëri civile besoni që janë*..... 43

*Figura 14: Kontaktet e OSHC-ve me Departamentin për Regjistrim dhe Ndërlidhje me OJQ* ..... 43

*Figura 15: Grupet me distancë sociale në popullësinë e Kosovës – nuk do të dëshironim ti kenë fqinjë* ..... 45




## LISTA E SHKURTESAVE

|              |   |
|--------------|---|
| <b>KK</b>    | – Komiteti Këshillues   |
| <b>BTD</b>   | – Trusti Ballkanik për Demokraci                                |
| <b>OSHC</b>  | – Organizata të shoqërisë civile                                |
| <b>KE</b>    | – Komisioni Europian (Zyra Ndërlidhëse e KE-së në Kosovë)       |
| <b>BE</b>    | – Bashkimi Europian   |
| <b>EULEX</b> | – Misioni Europian për Sundim të Ligjit në Kosovë               |
| <b>GF</b>    | – Grupet e Fokusit  |
| <b>BPV</b>   | – Bruto Produkti Vendor   |
| <b>PCN</b>   | – Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar                               |
| <b>GJNKJ</b> | – Gjykatën Ndërkombëtare për Krime Lufte në ish Jugosllavi      |
| <b>OJQN</b>  | – Organizatat jo-qeveritare ndërkombëtare                       |
| <b>KCSF</b>  | – Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile                         |
| <b>KGJK</b>  | – Këshilli Gjyqësor i Kosovës                                   |
| <b>RrGK</b>  | – Rrjeti i Grave të Kosovës                                     |
| <b>NATO</b>  | – Organizata e Traktatit veri-atlantik                          |
| <b>OJQ</b>   | – Organizata jo-qeveritare                                      |
| <b>NIT</b>   | – Ekipi Implementues Kombëtar                                   |
| <b>PK</b>    | – Punëtorja Kombëtare   |
| <b>IPVQ</b>  | – Institucionet e Përkohëshme të Vet-qeverisjes                 |
| <b>PSSP</b>  | – Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (të OKB-së) |
| <b>UNMIK</b> | – Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë         |

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Indeksi i Shoqërisë Civile (ISHC) është një hulumtim i bazuar në veprim që ka për qëllim vlerësimin e gjendjes së shoqërisë civile nëpër shtetet e mbarë botës. Projekti koordinohet ndërkombëtarisht nga Aleanca Botërore për Pjesëmarrjen e Qytetarëve CIVICUS dhe zbatohet nga organizatat vendore nëpër shtete të ndryshme. Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në fund të vitit 2008 filloi me zbatimin e ISHC-së së parë për Kosovë, duke pasur për qëllim vlerësimin e gjendjes së shoqërisë civile dhe krijimin e një agjende të veprimit të bazuar në dije për avansimin e këtij sektori në Kosovë. Metodologjia përfshin rishikimin, mbledhjen, validimin dhe analizimin e një spektri të gjerë të informatave, duke përfshirë edhe rishikimin e të dhënave dytësore, organizimin e hulumtimeve parësore sasiore dhe cilësore dhe diskutimin dhe validimin e të dhënave nëpërmjet forumeve të shumta pjesëmarrëse. Kjo metodologji pjesëmarrëse dhe gjithëpërfshirëse ia mundësoi ekipit kosovar të ISHC-së t'i tejkalojë një sërë pengesash me të cilat u ballafaqua gjatë projektit, siq janë mungesa e të dhënave dytësore; krahasueshmëria globale kundrejt çështjeve specifike të vendit; mungesa e mjeteve për verifikim; dhe zhvillimet dinamike në Kosovë.

Duke e definuar shoqërinë civile si *hapësira shoqërore, jashtë familjes, shtetit dhe tregut, e cila është krijuar nga veprimet individuale dhe kolektive, organizatat dhe institucionet jo për përfitim, që nuk hyjnë në garë për pushtet, por për të avancuar interesat e përbashkëta* – ISHC-ja e ka analizuar shoqërinë civile aktualisht aktive në Kosovë, por gjithashtu ka marrë parasysh historinë e shoqërisë civile kosovare, veçanërisht fazat e saj kryesore të zhvillimit para dhe pas 1999. E pozicionuar si një pjesë shumë e rëndësishme e gjithë sistemit paralel dhe rezistencës civile gjatë viteve 1990, fundi i luftës në vitin 1999 qe një kthesë për zhvillimin e gjithëmbarshtëm të shoqërisë civile në Kosovë. Shkalla e lartë e mbështetjes financiare dhe teknike nga ana e donatorëve ndërkombëtarë rezultoi me një rritje masive të numrit të OSHC-ve, që nuk u përcoll domosdoshmërisht edhe me ngritjen e cilësisë së punës së tyre. Pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008, shoqëria civile e Kosovës tani është duke u përshtatur me rolin e saj të ri në procesin gjithëpërfshirës të shtet-ndërtimit.



Rezultatet kryesore të ISHC-së përqëndrohen në pesë dimensione kryesore dhe një numër të madh të nën-dimensioneve dhe indikatorëve, duke dhënë në këtë mënyrë një prezantim gjithëpërfshirës mbi gjendjen e përgjithshme të shoqërisë civile në Kosovë. **Angazhimi civil** doli si rezultati i dytë më i ulët i ISHC-së, gjë që tregon një shkallë shumë të lartë të mosinteresimit të qytetarëve ndaj jetës publike në përgjithësi. Shkalla e ulët e anëtarësimit dhe vullnetarizmit në iniciativat qytetare e

konfirmon hendekun në mes të qytetarëve dhe OSHC-ve, të cilat ende nuk e shfrytëzojnë potencialin që vërehet nga rezultatet më të larta të aktivizimit jo-formal dhe individual. **Niveli i Organizimit** doli si dimension i më i lartë në ISHC, gjë që tregon se shoqëria civile kosovare karakterizohet me një shkallë të fortë të institucionalizimit. Sistemet e qeverisjes formale dhe menaxhimit janë tashmë të vendosura, megjithatë, me shumë nevojë për zbatimin e tyre më të mirë në praktikë. Ngjashëm me këtë, niveli i lartë i komunikimit brenda për brenda sektorit tregon një potencial shumë të madh për punë në rrjet, e që përsëri është më shumë formale se sa funksionale. Derisa OSHC-të aktive e kanë arritur një shkallë solide të qëndrueshmërisë financiare, ekziston një perceptim i përgjithshëm se shumica e përgjithshme e fondeve për shoqërinë civile është në rënie dhe se shoqëria civile duhet që gradualisht të fillojë të gjejë mënyra alternative të financimit në mënyrë që ta minimizojë varshmërinë e saj nga donatorët ndërkombëtarë. Të gjeturat rreth burimeve njerëzore në kuadër të

shoqërisë civile tregojnë vështirësi të mëdha në mobilizimin e një stafi profesional dhe kompetent. Rezultatet në **Praktikimin e Vlerave** tregojnë se derisa qeverisja e vendim-marrjes demokratike theksohet në mënyrë të fuqishme nëpër dokumentet e brendshme të sektorit të shoqërisë civile në Kosovë, kjo nuk transmetohet gjithmonë në zbatimin e këtyre parimeve në praktikë. Gati gjysma e OSHC-ve deklarojnë që kanë rregullore të ndryshme me shkrim, por zbatimi i tyre konsiderohet si jo i kënaqshëm. Në fund, ISHC-ja e konfirmon perceptimin e kahmotshëm se shoqëria civile kosovare është tepër tolerante, paqedashëse dhe jo-e dhunshme. Megjithatë, e njëjta nuk qëndron edhe për promovimin e vendim-marrjes demokratike në kuadër të organizatave dhe grupeve të veta. Rezultatet tregojnë se shoqëria civile është ende vetëm në gjysmë të rrugës drejt kësaj, dhe me nivelin relativisht të lartë të perceptimit të rasteve të korrupsionit brenda shoqërisë civile, ky rezultat nuk është befasues. **Ndikimi i Perceptuar** doli si dimension i rezultatin më të ulët, edhe pse me dallime të dukshme në mes të ndikimit shoqëror dhe ndikimit në politika, ku kjo e fundit doli më e ulët. Ndikimi i shoqërisë civile mbi çështjet më prioritare për shoqërinë kosovare është dukshëm i ulët, gjë që konfirmon se shoqëria civile nuk i është përgjigjur mjaftueshëm nevojave të vërteta të shoqërisë dhe përfaqësuesëve të saj. I ngjashëm me këtë është edhe ndikimi i shoqërisë civile mbi qëndrimin e njerëzve. Po ashtu niveli shumë i ulët i besimit ndërpersonal në mes të anëtarëve të shoqërisë civile nuk jep ndonjë rezultat inkurajues. Në fund, niveli i besimit të cilin njerëzit e kanë në shoqërinë civile ndryshon varësisht nga sektorët e shoqërisë civile, ku organizatat humanitare dhe bëmirëse e gëzojnë shkallën më të lartë të besimit në mesin e qytetarëve dhe organizatat për avokim dhe demokratizim janë në fund të kësaj liste. **Ambienti i Jashtëm** nuk paraqet ndonjë perspektivë shumë inkurajuese për veprimin e shoqërisë civile në Kosovë. Duke qenë një prej shteteve më të varfëra në Evropë me pothuajse gjysmën e popullsisë të papunë, ekonomia e Kosovës karakterizohet me një sektor shumë të madh joformal, dhe edhe më tutje mbetet në masë të madhe e varur nga dërgesat nga diaspora dhe ndihmat e donatorëve. Ngjashëm me këtë, konteksti socio-politik ofron një hapësirë të kufizuar për zhvillimin e shoqërisë civile. Përderisa shumë standarde demokratike ekzistojnë në letër, zbatimi i vërtetë i të drejtave dhe lirive politike si dhe sundimi i ligjit mbetet në një shkallë jo të kënaqshme. Një situatë paksa më pozitive ka të bëjë me të drejtat e shoqatave dhe organizatave dhe përvojën e kornizës ligjore për shoqërinë civile. Me standardet themelore për regjistrimin dhe veprimin e OJQ-ve, ambienti i favorshëm për shoqërinë civile ende ka nevojë për reforma substanciale ligjore dhe politike. Në fund, konteksti socio-kulturor qëndron më lartë në vlerësimin e tij të përgjithshëm, por me vlera të skajshme përbrenda tij. Derisa niveli jashtëzakonisht i ulët i besimit ndërpersonal në mes të qytetarëve kosovarë është rezultati më brengosës i ISHC-së, nivelet e larta të ndjeshmërisë publike e prezantojnë shoqërinë kosovare si shoqëri model nga aspekti etik.

Shoqëria civile është e vetëdijshme për dobësitë e veta dhe kjo është një pikënisje shumë pozitive nëse ka për qëllim t'i adresojë ato në të ardhmen. Disa nga dobësitë më të rëndësishme të identifikuar përfshijnë mungesën e motivimit dhe informimit mbi angazhimin e qytetarëve, probleme në ballafaqimin me nevojat kryesore të qytetarëve, imazhi publik jo i konsoliduar i sektorit, dhe niveli i dobët i funksionimit të sundimit të ligjit. Në anën tjetër, përparësitë kryesore përfshijnë ekzistimin në letër të standardeve të qeverisjes së mirë, shkallën e lartë të solidaritetit në mes të njerëzve, prezencën ndërkombëtare në Kosovë dhe një nivel të lartë të vetëdijes për vlerat që duhen respektuar dhe promovuar.

Rekomandimet kryesore përqëndrohen në përmirësimin e lidhjes në mes të shoqërisë civile dhe qytetarëve; krijimin e strukturave të brendshme për qeverisje më të mirë; dhe krijimin e mekanizmave formal për bashkëpunim me autoritetet publike.

## HYRJE

Indeksi i Shoqërisë Civile (ISHC) është një hulumtim i bazuar në veprim që ka për qëllim vlerësimin e gjendjes së shoqërisë civile nëpër shtetet e mbarë botës. Projekti koordinohet ndërkombëtarisht nga CIVICUS: Aleanca Botërore për Pjesëmarrjen e Qytetarëve dhe zbatohet nga organizatat lokale nëpër shtete të ndryshme. Në mes të viteve 2003 dhe 2006 ISHC është zbatuar në më tepër se 50 vende në mbarë botën, ndërsa prej vitit 2007 deri 2008 është zbatuar një fazë e ndërmjetme që është përqëndruar veçanërisht në vendet afrikane. Në fillim të vitit 2008 metodologjia e projektit është rishikuar, bazuar në rezultatet e vlerësimeve dhe komenteve të ndryshme të grupeve të interesit dhe ekspertëve. Metodologjia e re është përcjellur nga një fazë e re e ISHC-së në vende të ndryshme në mbarë botën. Metodologjia globale është konstruktuar për të nxjerrë informata specifike dhe të dobishme në nivel vendi, si dhe informata krahasuese në mes të vendeve dhe regjioneve të ndryshme. Shumica e të dhënave sasiore është e njëjtë për të gjitha vendet që masin ISHC-në dhe prandaj janë lehtë të krahasueshme, ndërsa të dhënat cilësore dhe analizat kanë për qëllim të ofrojnë informata për situatën specifike të shoqërisë civile në secilin vend.

Pas shpalljes së pavarësisë, me 17 shkurt 2008, Kosova ka hyrë në një periudhë shumë dinamike të zhvillimeve. Shoqëria civile është dashur ta përcjellë zhvillimin shoqëror dhe t'i përshtatet rolit të saj të ri në kuadër të kornizës së përgjithshme të shtet-ndërtimit. Ky zhvillim mund të jetë i suksesshëm vetëm nëse bazohet në informata të azhurnuara mbi situatën aktuale të sektorit, si dhe veprimet konkrete të dala nga këto informata.

Në këtë kontekst, Fondacioni Kosovar i Shoqërisë Civile (KCSF) në fund të vitit 2008 ka filluar ta zbatojë ISHC-në e parë për Kosovë, me qëllim të vlerësimit të gjendjes së shoqërisë civile dhe krijimit të agjendës vepruese të bazuar në dije, për avancimin e këtij sektori në Kosovë. Metodologjia përfshin rishikimin, mbledhjen, validimin, dhe analizimin e një spektri të gjerë të informatave, duke përfshirë edhe rishikimin e të dhënave dytësore, organizimin e hulumtimeve parësore sasiore dhe cilësore dhe diskutimin dhe validimin e të dhënave në kuadër të forumeve të shumta pjesëmarrëse, duke përfshirë një Komitet Këshillues, Grupet e Fokosit dhe një Punëtor Kombëtar.

Procesi ka filluar me një rishikim gjithëpërfshirës të të dhënave dytësore. Për shkak të mungesës së statistikave dhe studimeve relevante për të, Kosova është përballur me vështirësi të mëdha në gjetjen dhe shfrytëzimin e të dhënave dytësore dhe është dashur t'i nënshtrohet hulumtimeve shtesë në kuadër të zbatimit të projektit. Është krijuar një Komitet Këshillues (KK) i përbërë nga individë me përvojë nga shoqëria civile, autoritetet publike, mediat, biznesi dhe qarqet akademike me qëllim të diskutimit të çështjeve kryesore metodologjike në fillim të zbatimit të projektit dhe gjetjet kryesore të grumbulluara gjatë projektit, në fund të tij.

Tri hulumtime kryesore sasiore janë bërë për këtë projekt. Përmes një Hulumtimi Kombëtar të Popullsisë me 1,300 respondentë janë mbledhur informata mbi mendimet kryesore dhe qëndrimet e qytetarëve kosovarë lidhur me një numër të çështjeve që kanë të bëjnë me angazhimin e qytetarëve, si dhe me kontekstin politik dhe shoqëror në vend. Përmes një Hulumtimi të Organizatave me 100 OSHC aktive janë mbledhur informata mbi çështjet kryesore lidhur me strukturën e sektorit, qeverisjen e brendshme, burimet njerëzore dhe financiare dhe perceptimin e ndikimit të shoqërisë civile nga vetë OSHC-të. Përmes një Hulumtimi të Perceptimit të Jashtëm me 40 individë të dalluar jashtë shoqërisë civile (siç janë politikanët, shërbyesit civil, gjykatësit, akademikët, mediat, bizneset dhe misionet ndërkombëtare në Kosovë) janë mbledhur informata mbi pikëpamjet e tyre lidhur shoqërinë civile dhe perceptimin e tyre për ndikimin e saj në zhvillimet më të rëndësishme në shoqërinë e Kosovës. Përmes të gjitha këtyre hulumtimeve janë mbledhur informata mbi pesë dimensionet e ISHC-së, dhe drejtpërdrejtë kanë furnizuar Diamantin e Shoqërisë

Civile. Një numër i fushave të rëndësishme që nuk janë trajtuar në mënyrë të mjaftueshme përmes hulumtimeve, janë studiuar më thellë në rastet e studimit, duke përfshirë secilin nga dimensionet.

Pas mbledhjes së këtyre informatave, pesë grupe të fokusit janë organizuar në regjione të ndryshme të Kosovës, ku përfaqësuesit e OSHC-ve dhe sektorët tjerë kanë diskutuar dhe vërtetuar gjetjet kryesore, dhe kanë nxjerrë një numër të rekomandimeve për të ardhmen. Ngjashëm, në një Punëtori Kombëtar janë mbledhur rreth 60 përfaqësues të shoqërisë civile dhe të tjerë të cilët kanë kaluar përmes dimensioneve, nën-dimensioneve dhe indikatorëve, ku si rrjedhojë është arritur vlerësimi i fundit i gjetjeve dhe rekomandimeve për avancimin e mëtejshëm të shoqërisë civile në Kosovë.

Kjo metodologji pjesëmarrëse i ka ofruar projektit një mori të të dhënave shumë të dobishme, përvoja dhe perceptime nga grupet e ndryshme të interesit, që tani janë përdorur për ta përpiluar këtë raport.

## PROJEKTI DHE QASJA E INDEKSIT TË SHOQËRISË CIVILE

Shoqëria civile është duke luajtur një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në qeverisje dhe zhvillim në tërë botën. Mirëpo, në shumicën e vendeve njohuria rreth gjendjes dhe formës së shoqërisë civile është e kufizuar. Për më tepër, mundësitë për grupet e ndryshme të shoqërisë civile për tu takuar në mënyrë që të diskutojnë, reflektojnë dhe veprojnë bashkërisht mbi fuqitë, dobësitë, sfidat dhe mundësitë gjithashtu mbesin të kufizuara.

Indeksi i Shoqërisë Civile (ISHC), një projekt veprimi-hulumtimi me mundësi pjesëmarrëse të gjërë, e që mat gjendjen e shoqërisë civile në vendet e mbarë botës dhe kontribuon në trajtimin e këtyre kufizimeve. Ai ka për qëllim krijimin e një baze të njohurive dhe momentum për fuqizimin e shoqërisë civile. ISHC-ja inicohet dhe zbatohet nga dhe për organizatat e shoqërisë civile në nivel vendi, në partneritet me CIVICUS. Zbatimi i ISHC-së në mënyrë aktive i përfshinë dhe ua shpërndanë gjetjet e tij një vargu të gjerë të grupeve të interesit përfshirë shoqërinë civile, qeverinë, mediat, donatorët, qarqet akademike dhe opinionin publik në përgjithësi.

Në nivel vendi, hapat kryesorë që janë ndërmarrë në zbatimin e ISHC-së janë si në vijim:

1. **Vlerësimi:** ISHC-ja përdor një kombinim inovativ të metodave pjesëmarrëse të hulumtimit, burimeve të të dhënave dhe rasteve të studimit për vlerësimin gjithëpërfshirës të gjendjes së shoqërisë civile, duke përdorur pesë dimensione: Angazhimin Civil, Nivelin e Organizimit, Praktikimin e Vlerave, Ndikimin e Perceptuar dhe Ambientin e Jashtëm.
2. **Pasqyrimi kolektiv:** zbatimi i ISHC-së përfshinë dialogun e strukturuar në mes të grupeve të ndryshme të interesit nga shoqëria civile që mundëson identifikimin e fuqive dhe dobësie specifike të shoqërisë civile.
3. **Veprimi i përbashkët:** akterët e përfshirë përdorin një proces pjesëmarrës dhe konsultativ për zhvillimin dhe zbatimin e një agjende konkrete të veprimit për fuqizimin e shoqërisë civile në një vend.

Katër pjesët vijuese ofrojnë një historik të ISHC-së, parimet dhe qasjet e tij kryesore, si dhe një përmbledhje të metodologjisë së përdorur në përpilimin e këtij raporti në Kosovë dhe kufizimet e tij.

## 1. HISTORIKU I PROJEKTIT

ISHC-ja së pari është shfaqur si një koncept para më tepër se një dekade si një vazhdimësi e publikimit të *Atlasit të Ri Civil* të vitit 1997 nga CIVICUS, që përmbante profilet e shoqërisë civile në 60 vende në mbarë botën (Heinrich dhe Naidoo (2001)). Verzioni i parë i metodologjisë së ISHC-së, i krijuar nga CIVICUS me ndihmën e Helmut Anheier, është zbuluar në vitin 1999. Një pilot-model i metodologjisë është zbatuar në vitin 2000 në 13 vende.<sup>1</sup> Procesi dhe rezultatet e zbatimit të pilot-modelit janë vlerësuar, dukëgritur nevojën për rishikimin e metodologjisë. Rrjedhimisht, CIVICUS ka zbatuar me sukses fazën e parë të plotë të ISHC-së në mes të viteve 2003 dhe 2006 në 53 vende në mbarë botën. Ky zbatim në mënyrë të drejtpërdrejtë ka përfshirë më tepër se 7000 grupe të interesit të shoqërisë civile (Heinrich 2008).

Me qëllim të vazhimit në përmirësimin e orientimit hulumtues-veprues të metodologjisë, CIVICUS punoi me Qendrën për Investim Shoqëror në Universitetin e Heidelbergut, si dhe me partnerët dhe grupet tjera të interesit, me qëllim të vlerësimit dhe rishikimit rigoroz të metodologjisë së ISHC-së për herë të dytë para fillimit të kësaj faze aktuale të ISHC-së. Me vendosjen e kësaj metodologjie të re dhe efektive, CIVICUS lansoi fazën aktuale të ISHC-së në vitin 2008 dhe përzgjedhi vendet partnere, përfshirë implementuesit e mëhershëm dhe ata të rinj nga e mbarë bota për të marrë pjesë në projekt. Tabela 1 më poshtë përfshinë një listë të vendeve implementuese në fazën aktuale të ISHC-së.

Tabela 1: Lista e vendeve implementuese të ISHC-së 2008-2011<sup>2</sup>

|                 |                 |                   |
|-----------------|-----------------|-------------------|
| 1. Shqipëria    | 15. Italia      | 29. Nigeri        |
| 2. Argjentina   | 16. Japonia     | 30. Filipinet     |
| 3. Armenia      | 17. Jordania    | 31. Rusia         |
| 4. Bahraini     | 18. Kazakistani | 32. Serbia        |
| 5. Bjellorusia  | 19. Kosova      | 33. Sllovenia     |
| 6. Bullgaria    | 20. Libani      | 34. Korea e Jugut |
| 7. Burkina Faso | 21. Liberia     | 35. Sudani        |
| 8. Kili         | 22. Maqedonia   | 36. Togo          |
| 9. Kroacia      | 23. Madagaskari | 37. Turqia        |
| 10. Qipro       | 24. Mali        | 38. Uganda        |
| 11. Gjibuti     | 25. Malta       | 39. Ukraina       |
| 12. R.D. Kongo  | 26. Meksika     | 40. Uruguai       |
| 13. Gjeorgjia   | 27. Maroku      | 41. Venecuela     |
| 14. Gana        | 28. Nikaragua   | 42. Zambia        |

<sup>1</sup> Vendet modele ishin Bjellorusia, Kanadaja, Kroacia, Estonia, Indonezia, Meksiko, Zelanda e Re, Pakistani, Rumania, Afrika Jugore, Ukraina, Uruguaji, dhe Uells.

<sup>2</sup> Kjo listë ka qenë e saktë në momentin e publikimit të këtij raporti, mirëpo mund të ketë ndryshuar në ndërkohë



## 2. QASJA E PROJEKTIT

Qasja aktuale e projektit ISHC (2008-2011) vazhdon të bashkojë vlerësimin dhe dëshmitë me reflektimet dhe veprimet. Kjo qasje ofron një pikë të rëndësishme referuese për gjithë punën e kryer në kuadër të kornizës së ISHC-së. Si e tillë, ISHC-ja nuk prodhon njohuri për hir të vetvetes por përkundrazi kërkon të aplikojë drejtpërdrejtë njohurinë e nxjerrë për t'i stimuluar strategjitë që përmirësojnë efektshmërinë dhe rolin e shoqërisë civile. Marrë këtë parasysh, bazat themelore metodologjike të ISHC-së, që në masë të madhe kanë ndikuar zbatimin e këtij raporti, përfshijnë si në vijim:<sup>3</sup>

**Përfshirja:** Korniza e ISHC-së përqipet të inkorporojë një shumëllojshmëri të pikëpamjeve teorike, si dhe gjithëpërfshirjen në aspektin e indikatorëve, akterëve dhe proceseve të shoqërisë civile.

**Gjithanshmëria:** Pasi që ISHC-ja është një projekt global, metodologjia e saj kërkon të akomodojë në kuadër të kornizës së saj variacionet kombëtare në kontekst dhe koncepte.

**Krahasueshmëria:** ISHC-ja synon që mos t'i klasifikojë por në mënyrë krahasuese t'i mas aspektet e ndryshme të shoqërisë civile në mbarë botën. Mundësia për krahasime ekziston si në mes të vendeve ose regjioneve të ndryshme brenda një faze të zbatimit të ISHC-së ashtu edhe në mes të fazave të ndryshme të ISHC-së.

**Shkathtësia:** ISHC-ja në mënyrë specifike është e konstruktuar të arrijë një baraspeshë të duhur në mes të krahasueshmërisë ndërkombëtare dhe fleksibilitetit kombëtar në zbatimin e projektit.

**Dialogu:** Një nga elementet kryesore të ISHC-së është qasja e saj pjesëmarrëse, që përfshinë një varg të gjerë të grupeve të interesit të cilët në mënyrë kolektive udhëheqin dhe kanë pronësi mbi projektin, në vendet e tyre përkatëse.

**Zhvillimi i kapaciteteve:** Vendet partnere së pari trajnohen mbi metodologjinë e ISHC-së gjatë një punëtorie regjionale tre ditore. Pas trajnimit, partnerët përkrahen përmes ciklit implementues nga ekipi i ISHC-së në CIVICUS. Partnerët që marrin pjesë në projekt gjithashtu fitojnë aftësi substanciale në hulumtim, trajnim dhe lehtësim në zbatimin e ISHC-së në vend.

**Rrjeti:** Natyra pjesëmarrëse dhe përfshirëse e mjeteve të ndryshme të ISHC-së (p.sh. grupet e fokusit, Komiteti Këshillues, Punëtoritë Nacionale) duhet t'i krijojnë hapësirat e reja ku akterë shumë të ndryshëm mund t'i zbulojnë sinergjitë dhe krijojnë aleanca të reja, përfshirë nivelin ndër-sektorial. Disa vende në fazën e fundit (2003-2005) gjithashtu kanë marrë pjesë në konferenca rajonale për të diskutuar gjetjet e ISHC-së si dhe çështjet ndër-nacionale të shoqërisë civile.

**Ndryshimi:** Synimi kryesor i ISHC-së është të nxjerrë informata që janë të përdorimit praktik për aktivistët e shoqërisë civile dhe grupet e tjera kryesore të interesit. Prandaj, korniza e ISHC-së kërkon t'i identifikojë aspektet e shoqërisë civile që mund të ndryshohen dhe të nxjerrë informata dhe njohuri që janë relevante për qëllimet e orientuara në veprime.

<sup>3</sup> Për shpjegime më të hollësishme të këtyre parimeve shih Mati, Silva dhe Anderson (2010), Vlerësimi dhe Fuqizimi i Shoqërisë Civile në mbarë botën: Një përshkrim i azhurnuar i programit të CIVICUS Faza e Indeksit të Shoqërisë Civile 2008-2010. CIVICUS, Johannesburg.

Me bazën e lartpërmendur, metodologjia e ISHC-së përdor një kombinim të metodave pjesëmarrëse dhe shkencore të hulumtimit për të bërë një vlerësim të gjendjes së shoqërisë civile në nivel kombëtar. ISHC-ja mat dimensionet kryesore vijuese:

- (1) Angazhimin Civil
- (2) Nivelin e Organizimit
- (3) Praktikimin e Vlerave
- (4) Ndikimin e Perceptuar
- (5) Ambientin e Jashtëm

Këto dimensione ilustrohen vizuelisht përmes Diamantit të Shoqërisë Civile (shikoni Figurën 1 më poshtë), që është një nga komponentet më thelbësore dhe të njohura të projektit të ISHC-së. Për të formuar një Diamant të Shoqërisë Civile, 67 indikatorë sasior grumbullohen në 28 nën-dimensione që pastaj grumbullohen në pesë dimensione përfundimtare përgjatë një shkalle të përqindjes prej 0-100. Madhësia e Diamantit kërkon të portretizojë një pikturë empirike të gjendjes së shoqërisë civile, kushtet që përkrahin ose pengojnë zhvillimin e shoqërisë civile, si dhe pasojat e aktiviteteve të shoqërisë civile për shoqërinë në tërësi. Konteksti ose ambienti përfaqësohet vizuelisht përmes një rrethi përreth akseve të Diamantit të Shoqërisë Civile, rreth ky që nuk konsiderohet si pjesë e gjendjes së shoqërisë civile por si diçka e jashtme por që mbetet një element vendimtar për mirëqenien e saj.




Figura 1: Diamanti i Indeksit të Shoqërisë Civile

### 3. ZBATIMI I ISHC-SË

Ekzistojnë disa aktivitete kryesore të zbatimit të programit të ISHC-së si dhe disa struktura të përfshira, ashtu siç është përmbledhur përmes ilustrimit të mëposhtëm:<sup>4</sup>




Figura 2: Procesi i Implementimit të Indeksit të Shoqërisë Civile

Mjetet dhe elementet kryesore të zbatimit të ISHC-së në nivel kombëtar përfshijnë:

- Hulumtimet e shumëfishta, përfshirë: (i) një **Hulumtim të Popullsisë**, duke mbledhur pikëpamjet e qytetarëve mbi shoqërinë civile dhe duke matur përfshirjen e tyre në grupe dhe shoqata, me 1,300 respondentë nga mbarë Kosova; (ii) një **Hulumtim të Organizatave** duke matur nivelin mesatar të shoqërisë civile dhe karakteristikat përkufizuese të OSHC-ve, me 100 OSHC aktive kosovare; dhe (iii) një **Hulumtim të Perceptimeve të Jashtme** që synon matjen e perceptimit që grupet e interesit, ekspertët dhe bërësit e politikave në sektorët kryesore e kanë lidhur me ndikimin e shoqërisë civile, me 40 individë të dalluar nga të gjitha sektorët e shoqërisë.
- **Rastet e Studimit** të përshtatura që të përqëndrohen në çështjet e rëndësishme për kontekstin specifik të shoqërisë civile në vend. ISHC-ja në Kosovë ka ndërmarrë gjashtë raste studimi, që synojnë hulumtimin e thellë të çështjeve vijuese: Lëvizjet Civile dhe Qytetarinë Aktive; Bashkëpunimin në mes të OSHC-ve – Ligjin mbi OJQ-të 2010; Vullnetarizmin – Organizata Humanitare dhe Bamirëse “Nëna Tereze”; Marrëdhëniet në mes të Kuvendit të Kosovës dhe Shoqërisë Civile; Departamentin për Regjistrim dhe Ndërlidhje me OJQ; dhe Trendet e Fondeve të Donatorëve për Shoqërinë Civile.
- Takimet e **Komitetit Këshillues (KK)** që përbëhen nga ekspertë të shoqërisë civile për të këshilluar mbi projekin dhe zbatimin e tij në nivel vendi
- **Grupet e fokusit** (regjionale dhe tematike) ku grupet e interesit të shoqërisë civile pasqyrojnë dhe ndajnë pikëpamjet mbi rolin e shoqërisë civile në shoqëri. Takimet një-ditore të Grupeve regjionale të Fokusit janë mbajtur në Prizren, Mitrovicë, Prishtinë dhe Graçanicë, si dhe një Grupe tematik me donatorët e shoqërisë civile të pranishëm në Kosovë.

<sup>4</sup> Për një diskutim më të hollësishëm mbi secilin nga këta hapa në proces, shikoni Mati dhe të tjerët (në fusnotën 3).

Pas këtij hulumtimi të hollësishëm dhe mbledhjes gjithëpërfshirëse të informatave, gjetjet janë prezantuar dhe debatuar në një **Punëtori Kombëtare**, ku janë mbledhur bashkërisht një grup i madh i palëve të interesit nga shoqëria civile dhe jashtë saj, dhe kanë diskutuar dhe zhvilluar veprimet konkrete për adresimin e çështjeve prioritare të identifikuar.

Ky Raport Analitik Vendor është një nga rezultatet madhore të procesit të ISHC-së në Kosovë, dhe paraqet të arriturat kryesore nga hulumtimi i bërë, përfshirë përmbledhjen e përparësive dhe dobësive të shoqërisë civile si dhe rekomandimeve për fuqizimin e shoqërisë civile në vend. Ai shoqërohet me një Dokument të Politikave, që ofron rekomandime për fuqizimin e sektorit.

### 4. KUFIZIMET E STUDIMIT ISHC

Përfshirja e Kosovës në metodologjinë globale të ISHC-së për herën e parë ka pasur si aspekte pozitive ashtu edhe negative për zbatimin e saj në vend. Aspekti më pozitiv është shfrytëzimi i metodologjisë së avancuar, që ka rezultuar pas vlerësimit konstant të metodologjisë së ISHC-së nga fazat e mëparshme globale dhe regionale. Një numër i vështirësive të raportuara nga zbatuesit e mëparshëm janë adresuar në metodologjinë e re, duke përmirësuar cilësinë e përgjithshme në zbatimin e ISHC-së në Kosovë. Mirëpo, një numër i kufizimeve ka qenë megjithatë i pranishëm edhe në metodologjinë aktuale në përgjithësi, si dhe në lidhje me situatën specifike të Kosovës në veçanti.

**Mungesa e të dhënave dytësore** – Vështirësia më e madhe në ndërmarrjen e ISHC-së në Kosovë është sasia tepër e ulët e të dhënave dytësore, si për kushtet e shoqërisë në përgjithësi ashtu edhe për aspektet e veçanta të shoqërisë civile. Kosova është një vend ku regjistrimi i fundit i popullsisë është mbajtur në vitin 1981, dhe ku shumica e fushave nuk janë të mbuluara as nga Enti i Statistikave të Kosovës e as nga raportet dhe indekset e ndryshme ndërkombëtare. Mungesa e të dhënave dytësore ka pasur një ndikim direkt posaçërisht në kërkimin e të dhënave referente për një numër të indikatorëve për të cilët është nevojitur një analizë e thellë. Për shembull, kuptimi i arsyes për nivelet shumë të larta të ndjeshmërisë publike dhe për nivelet shumë të ulëta të besimit ndër-personal dhe ndërlidhja e tyre me kontekstin e përgjithshëm të shoqërisë kosovare ka qenë një detyrë e vështirë pa të dhënat shtesë dhe materialet nga profesionistët tjerë.

**Krahasueshmëria globale kundrejt çështjeve specifike të vendit** – edhe pse është menduar të baraspeshohet krahasueshmëria globale me specifikat e vendit, gjatë përdorimit të metodologjisë së ISHC-së na janë shfaqur sfida shtesë, gjatë adresimit të një numri të çështjeve që janë të zakonshme për shoqërinë civile në Kosovë. Kjo është vërejtur posaçërisht në analizimin e të dhënave nga hulumtimet sasiore, të cilat kanë mundur të përshtaten vetëm në një shkallë shumë të vogël. Për shembull, ndërsa një numër relativisht i lartë i OSHC-ve aktive udhëhiqen nga gratë, mungesa e rregulloreve me shkrim për barazinë gjinore mund të tregojë një rezultat të kundërt në këtë fushë. Ekipi i ISHC-së ka bërë përpjekje shtesë për t'i diskutuar këto çështje në forume të ndryshme të projektit dhe për të zgjeruar interpretimin e gjetjeve të ndryshme, dhe gjithashtu ka përfshirë pyetje plotësuese dhe raste studimi për të hulumtuar një numër të çështjeve të rëndësishme për gjendjen aktuale të shoqërisë civile në Kosovë.

**Mungesa e mjeteve verifikuese** – ngjashëm me hulumtimet tjera të bëra në këtë lëmi, metodologjia e ISHC-së dhe hulumtuesit tanë nuk kanë pasur ndonjë mjet specifik për të verifikuar përgjigjet nga organizatat dhe individët. Edhe pse janë përdorur teknika të ndryshme për të minimizuar rrezikun nga përgjigjet jo të sakta, përfshirë pyetjet tërthore, përgjigjet që nuk pasqyrojnë situatën e saktë në terren mund të jenë pjesë e studimit. Për shembull, përgjigjet që kanë deklaruar se bordi udhëheqës/kuvendi i OSHC-ve ose rregulloret me shkrim ekzistojnë, në raport me funksionalizimin e tyre në praktikë në disa raste kanë qenë larg njëra tjetrës. Prapë, projekti është mbështetur shumë në përvojën që KCSF ka përmes punës së përditshme me OSHC-të, si dhe përqëndrimin e

diskutimeve në këto çështje. Këto i kanë mundësuar ekipit të ISHC-së të nxjerrin komente dhe interpretime plotësuese për një numër të indikatorëve.

**Zhvillimet dinamike në Kosovë** – E fundit por jo më pak e rëndësishme, situata shumë specifike e vendit gjatë viteve të fundit ka qenë një vështirësi shtesë në ruajtjen e vazhdimsisë së studimit dhe gjetjeve të tij. Që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008, Kosova ka kaluar nëpër një periudhë shumë dinamike ku jo-qëndrueshmëria politike dhe zhvillimet kanë ndryshuar rolin dhe pushtetin e grupeve të ndryshme brenda një periudhe shumë të shkurtër. Për këtë shkak ISHC-ja në Kosovë është dashur ta anulojë një pjesë të metodologjisë së ISHC-së, e që është Analiza e Forcave Shoqërore – që ka për qëllim të krijojë një pasqyrë të forcave kryesore të shoqërisë dhe marrëdhënieve në mes tyre, si dhe pozicionimin dhe pushtetin e secilës prej tyre. Në këtë situatë shumë të ndërlikuar ku përqëndrimi i pushteteit real ndryshon vazhdimisht, një analizë e tillë do të bëhej e vjetër dhe e padobishme brenda një periudhe shumë të shkurtër.

Mirëpo, kufizimet e lartpërmendura nuk e ulin besueshmërinë e studimit. Përpjekjet për t'i adresuar të gjitha kufizimet kanë rezultuar në një grup shumë të vlefshëm të gjetjeve dhe rekomandimeve të bazuara në dije për veprimet e ardhshme. Të gjitha palët e interesuara për të punuar me shoqërinë civile tani kanë në duart e tyre një analizë të thellë të gjendjes aktuale të sektorit, rekomandimet konkrete për agjendën vepruese të shoqërisë civile dhe një grup të të dhënave cilësore që mund të shfrytëzohen nga praktikuesit e tjerë të shoqërisë civile.

## SHOQËRIA CIVILE NË KOSOVË

### 1. KONCEPTI I SHOQËRISË CIVILE

Shoqëria civile është një koncept i gjerë që në mbarë botën kuptohet në mënyra të ndryshme, sipas zhvillimeve specifike historike dhe aktuale në vendet dhe regjionet e ndryshme. Mirëpo, në kuptimin e saj modern ajo ka një numër të karakteristikave që mund të zbatohen në shumicën e vendeve në mbarë botën. Në këtë aspekt, CIVICUS ka dhënë një përkufizim bazik të shoqërisë civile në mënyrë që të ofrohet një bazë për diskutim për secilin vend specifik që zbaton ISHC-në.

Përkufizimi i propozuar nga CIVICUS përkufizon shoqërinë civile si:

***Arena, jashtë familjes, shtetit, dhe tregut, që krijohet përmes veprimeve individuale dhe kolektive, organizatave dhe institucioneve për avancimin e interesave të përbashkëta.***

KK, në takimin e tij të parë, ka diskutuar për shoqërinë civile në Kosovë dhe e ka përshtatur dhe propozuar përkufizimin e saj si në vijim:

***Hapësira shoqërore, jashtë familjes, shtetit, dhe tregut, e cila është krijuar nga veprimet individuale dhe kolektive, organizatat dhe institucionet jo për përfitim, që nuk hyjnë në garë për pushtet, por për të avancuar interesat e përbashkëta.***

Disa nga karakteristikat kryesore që e përkufizojnë shoqërinë civile në Kosovë, përmes këtij përkufizimi, renditen më poshtë:

- Shoqëria civile, edhe pse nganjëherë nuk përkufizohet në një mënyrë të prerë, është e ndarë nga familja, shteti dhe tregu/biznesi;
- Shoqëria civile ekziston në format e organizatave dhe institucioneve, si një mënyrë e organizuar për avancimin e interesave të përbashkëta;
- Megjithatë, përveç formave të organizuara, shoqëria civile përfshin edhe veprimet (individuale ose kolektive), që janë në harmoni me kriteret tjera të këtij përkufizimi;
- Avancimi i interesave të përbashkëta (qoftë interes i një grupi të caktuar të njerëzve ose interes i shoqërisë si tërësi) është synimi që e dallon sektorin e shoqërisë civile nga sektoret tjera (siç janë iniciativat për avancimin e interesit personal të ndokujt).

Fjalët ‘jo për përfitim’ dhe ‘që nuk hyjnë në garë për pushtet’ janë shtuar në përkufizimin e propozuar, me qëllim të vënies së theksit në çështjet vijuese:

- Parimi jo-për-përfitim është një nga parimet kryesore që e dallojnë shoqërinë civile nga sektorët tjerë (siç është sektori privat);
- Mos hyrja në garë për pushtet është një parim shumë i rëndësishëm që e dallon shoqërinë civile nga sektorët tjerë (siç janë partitë politike).

Në aspekte konkrete, shoqëria civile në Kosovë përbëhet kryesisht nga organizatat e regjistruara jo-qeveritare (OJQ-të), ndërsa format tjera të shoqërisë civile nuk janë shumë të shpeshta. Mund të gjenden vetëm disa shembuj të iniciativave të pa regjistruara, dhe shumica e tyre shfaqen në bazën ad-hoc dhe nuk vazhdojnë të jenë aktive pasi që çështja/problemi konkret të zgjidhet. Përveç kësaj, edhe pse formalisht brenda sferës së përkufizimit të shoqërisë civile, sindikatat rrallë shihen si të



tilla, dhe bashkëpunimi në mes të sindikatave të ndryshme dhe pjesëve të ndryshme të shoqërisë civile është i kufizuar, ku sindikatat rrallë janë pjesë e iniciativave dhe forumeve të shoqërisë civile.

Mediat mbeten si brenda ashtu edhe jashtë shoqërisë civile. Pasi që shumica e mediave zyrtarisht janë të regjistruara si biznese private, ato mund të shihen si pjesë e sektorit privat. Mirëpo, roli i tyre në shoqëri në përgjithësi dhe në avancimin e interesit publik në veçanti shpesh i vendosë mediat në arenën e njëjtë me shoqërinë civile. Përrjashtim bëjnë një numër i mediave (kryesisht lokale) që janë të regjistruara si OJQ.

Komunitetet fetare<sup>5</sup> organizohen sipas sistemit të tyre tradicional të normave dhe vlerave, dhe nuk konsiderohen si pjesë e shoqërisë civile. Mirëpo, një numër i iniciativave të tyre – në veçanti ndihmat bamirëse dhe humanitare – mund të konsiderohen si një kontribut për qytetarinë aktive, ndërsa këto organizata formalisht regjistrohen si organizata jo-qeveritare.

## 2. PASQYRA HISTORIKE E SHOQËRISË CIVILE

Në kuptimin modern të shoqërisë civile, iniciativat dhe organizatat e para të shoqërisë civile në Kosovë datojnë nga fundi i viteve të 80-ta dhe fillimi i viteve të 90-ta, pas rënies së komunizmit në Evropën Qendrore dhe Lindore dhe fillimit të një forme të re të shtypjes politike dhe jetës paralele në Kosovë. Për shkak të situatës shumë specifike në Kosovë në atë kohë, shoqëria civile është zhvilluar si një pjesë e rëndësishme e një sistemi tërësisht paralel dhe rezistencës civile ndaj regjimit serb, që ishte ndërtuar nga nevojat bazë dhe kishte trajtuar çështjet e mbijetesës së popullsisë. Ndiham humanitare dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut, të plotësuara me lëvizjet e ndryshme civile me përkrahjen e madhe nga shoqëria në përgjithësi, kanë qenë fushat më të rëndësishme të aktiviteteve të shoqërisë civile. Ndarja etnike gjithashtu ishte shprehur edhe brenda shoqërisë civile, me vetëm disa përjashtime.

Pas bojkotit të institucioneve serbe nga e gjithë popullsia shqiptare në Kosovë<sup>6</sup> dhe përjashtimit të saj nga shërbimet e ndryshme shoqërore dhe shëndetësore, shoqëria civile u shndërrua në furnizues kryesor të këtyre shërbimeve. Për 10 vite, organizata humanitare bamirëse Nëna Tereze mblodhi ndihma brenda dhe jashtë Kosovës dhe themeloi një sistem për shpërndarjen e ndihmave dhe shërbimeve shëndetësore për familjet e varfëra në tërë Kosovën. Më tepër se 7,200 vullnetarë janë angazhuar në këtë iniciativë në mënyrë aktive. Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut gjatë periudhës së njëjtë ka monitoruar, identifikuar dhe ngritur vetëdijen për shkeljet e të drejtave të njeriut, duke kontribuar drejtpërdrejtë në informimin e komunitetit ndërkombëtar për shtypjen sistematike të popullsisë shqiptare nga regjimi serb. I përbërë nga avokatët më të dalluar në Kosovë, Këshilli ka bashkëpunuar me Gjykatën Ndërkombëtare për Krime Luftë në ish Jugosllavi (GJNKJ) për mbledhjen e dëshmive mbi krimet e luftës në Kosovë.

Intervenimi i NATO-s dhe krijimi i Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) në vitin 1999 ka qenë pikë kthyesë për zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë civile në Kosovë. Nevojat shumë të mëdha për ndihmë emergjente dhe rindërtim, si dhe për pajtim ndëretnik, bënë që shoqëria civile të transformojë aktivitetin e saj dhe t'i adaptohet realitetit të ri. Përkrahja e madhe financiare dhe teknike nga donatorët ndërkombëtarë ka rezultuar në rritjen masive të numrit të OSHC-ve, që jo domosdoshmërisht është përcjellë me cilësinë e rritur të punës së tyre. Fondet 'lehtë të arritshme',

<sup>5</sup> Feja kryesore në Kosovë është Myslimane (rreth 80%), ndërsa ajo Katolike (rreth 6%) dhe Ortodokse (rreth 5 %) janë komunitetet tjera kryesore fetare.

<sup>6</sup> Regjistrimi i fundit i popullsisë është bërë në vitin 1981. Sipas vlerësimeve nga Zyra Statistikore e Kosovës, popullsia e Kosovës në vitin 2006 përbëhej nga shumica Shqiptare (92 %) dhe pakicat e ndryshme etnike (Serbe 5.3 %, Rome 1.1%, Turke 0.4% dhe të tjera 1.2%)

të kombinuara me varësinë nga donacionet e huaja, krijuan shumë OJQ të nxitura nga donatorët, si dhe OJQ “pasive” që aktivizohen vetëm kur ka fonde në dispozicion.<sup>7</sup> Nga më tepër se 6,000 OJQ të regjistruara në vitin 2010,<sup>8</sup> më pak se 10% janë vlerësuar të jenë ende aktive ose pjesërisht aktive. Pasi që Ligji mbi OJQ-të nuk parasheh ndonjë kusht për çregjistrimin e OJQ-ve pasive, numri i OJQ-ve të regjistruara vazhdimisht është rritur që nga viti 1999.

Megjithatë, një numër i OSHC-ve vazhdimisht është ngritur drejt formësimit dhe profilizimit të tyre. Disa iniciativa dhe fushata të suksesshme kanë ndikuar në politika dhe në zhvillime specifike, dhe si të tilla kanë pozicionuar shoqërinë civile si një sektor të rëndësishëm në ndërtimin e shtetit dhe procesin e demokratizimit.

Pas nëntë viteve të bashkë-ekzistimit të UNMIK-ut dhe IPVQ-ve në vendim-marrje dhe një situatë ku “sistem i dyfishtë i qeverisjes do bënte aftësinë e grupeve të qytetarëve për të ndikuar në vendimet publike që duhej se ndërmerreshin në interesin e tyre”,<sup>9</sup> si dhe pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, tani është krijuar një sistem i ri i qeverisjes dhe qasje të reja në vendim-marrje janë duke u vendosur në Kosovë.

Shoqëria civile prapë është duke iu përshtatur situatës së re, në veçanti përmes rritjes së aktiviteteve dhe kapaciteteve të saj për të ndikuar në politikat publike dhe vendim-marrje, duke avokuar për dobi të anëtarëve të saj, duke synuar që të mbajë qeverinë përgjegjëse, dhe veçanërisht për t’i kontribuar procesit të antarësimit të Kosovës në Bashkimin Europian.

### **3. PËRSHKRIMI I SHOQËRISË CIVILE**

Nga një situatë ku “shoqëria civile është konsideruar e dobët”,<sup>10</sup> dhe pa arritur ndonjë ngritje substanciale, raportet mbi shoqërinë civile, siç janë Raportet e Progresit të Komisionit Europian, tani janë duke vënë theksin në “ambientin në të cilin OJQ-të operojnë, që duhet të përmirësohet në masë të madhe.”<sup>11</sup>

Duke e pranuar një përshkrim të tillë si të vërtetë, aktualisht shoqëria civile në Kosovë është duke përjetuar një numër të zhvillimeve por që ende përballet me sfida të mëdha. Edhe pse disa OSHC janë duke ngritur kapacitetet e tyre njerëzore dhe financiare, pjesa më e madhe e sektorit mbetet shumë e varur nga financimi ndërkombëtar. Përveç kësaj, rritja e vazhdueshme e proporcionit të Bashkimit Europian në fondet e shoqërisë civile, procedurat burokratike të aplikimit dhe shumat mjaft të mëdha minimale të granteve të BE-së përjashtojnë shumë organizata nga përfitimi i këtyre fondeve, pasi që shumica e organizatave janë shumë të vogla për t’i zbatuar ose absorbuar shumat e tilla,<sup>12</sup> duke rritur kështu ndarjen në mes të OSHC-ve ‘të mëdha’ dhe të ‘vogla’. Në përpjekje për të mbijetuar në këtë situatë, prioritetet e shoqërisë civile në shumicën e rasteve kanë pasqyruar prioritetet e donatorëve,<sup>13</sup> që do të thotë se shumë iniciativa të shoqërisë civile nuk janë nxitur nga interesi i komunitetit. Kjo ka dobësuar lidhjen në mes të OSHC-ve dhe anëtarëve të tyre, duke vënë në pyetje legjitimitetin e veprimeve të tyre. Përveç kësaj, për shkak të mungesës së koordinimit në mes të donatorëve dhe OJQ-ve, kost-benefiti i fondeve të dhëna dhe ndikimi i arritur në terren nuk ka qenë gjithmone aq i fuqishëm sa ka mundur të jetë. Ky boshllëk në mes të OSHC-ve (në veçanti organizatat e antarësisë) dhe antarëve të tyre ka zvogëluar mundësitë për fuqizimin e

<sup>7</sup> Raporti i Zhvillimit Njerëzor i UNDP-së 2008 – faqe.42.

<sup>8</sup> Sipas numrit të paraqitur nga Zyra për Regjistrim dhe Ndërlidhje me OJQ e Qeverisë së Kosovës, 2010.

<sup>9</sup> Analizat planifikuese të shoqërisë civile në Kosovë, KCSF 2005.

<sup>10</sup> Raporti i Progresit i KE 2008 – faqe.19.

<sup>11</sup> Raporti i Progresit i KE 2010 – faqe.17.

<sup>12</sup> Shoqëria civile përgjatë Ballkanit faqe. 19 – Rrjeti EUCLID 2009.

<sup>13</sup> Raporti i Zhvillimit Njerëzor i UNDP-së 2008 – Tabela 5.2.

qëndrueshmërisë së tyre nga burimet vendore dhe i bën ato të cenueshme ndaj zvogëlimit të ardhshëm të fondeve ndërkombëtare për shoqërinë civile. Në fund, “kuptimi i publikut për rolin e shoqërisë civile mbetet i ulët”<sup>14</sup> duke e bërë këtë sfidë edhe më të vështirë për tu tejkaluar.

OSHC-të në Kosovë, me aktivitetet e tyre mbulojnë një varg të gjerë të fushave të veprimit. Një numër i fushave vazhdimisht janë duke tërhequr më tepër OSHC ndërsa disa fusha tjera janë duke përjetuar ulje si në cilësinë ashtu edhe në numrin e OSHC-ve të përfshira. Fushat e mëparshme të aktivitetit që ishin ‘atraktive për donatorët’, siç janë çështjet e minoriteteve dhe rinisë janë fusha ku numri i OSHC-ve është zvogëluar vazhdimisht si reflektim i ndryshimit të prioritetëve të financimit. Për dallim nga këto, për shkak që institucionet e pavarura të Kosovëstanië më kanë marrë përsipër përgjegjësinë kryesore të shtetësisë, OSHC-të që punojnë në sundimin e ligjit në përgjithësi janë duke e ngritur praninë e tyre, si përmes numrave ashtu edhe përmes cilësisë së punës. Ndërkohë, OSHC-të tjera janë duke punuar në disa fusha të tjera: sektori i instituteve hulmuese është duke synuar të kontribuojë në bërjen e politikave publike dhe të ndikojë në zhvillimet kryesore në vendim-marrje; OSHC-të për zhvillimin e shoqërisë civile janë duke u përpjekur ta rrisin kuptimin e rolit të shoqërisë civile në një shoqëri demokratike në opinionin publik dhe autoritetet publike dhe të lehtësojnë koordinimin dhe rrjetet brenda sektorit, si dhe të rregullojnë bashkëpunimin në mes të shoqërisë civile dhe autoriteteve publike, përfshirë promovimin e mekanizmave pjesëmarrëse për shoqërinë civile; OJQ-të e grave mbesin aktive në luftën për një shoqëri të balancuar nga aspekti gjinor dhe rrjeti i tyre ende është një nga rrjetet më aktive; të drejtat e njeriut ende janë një fushë e domosdoshme ku një numër i OSHC-ve janë duke kontribuar; ndërsa OSHC-të që punojnë me njerëzit nga komunitetet e marginalizuara janë aktive për të siguruar standardet minimale për anëtarët e tyre. Fushat e tjera ku shoqëria civile është aktive përfshijnë ambientin, procesin e integritimit European, rindërtimin, çështjet sociale dhe politikën e jashtme.

Përveç kësaj, krahas rolit të tyre kryesor si donatorë, OJQ-të ndërkombëtare ende janë akterë të rëndësishëm në skenën e përgjithshme të shoqërisë civile në Kosovë.

Për sa i përket rrjeteve të shoqërisë civile, vetëm disa rrjete formale kanë mbijetuar një kohë më të gjatë dhe vazhdojnë të luajnë rolin e tyre fillestar. Rrjeti i Grave të Kosovës dhe koalicioni i OSHC-ve që monitoron zgjedhjet, Demokracia në Veprim, janë dy shembuj, ku të dyja gjithashtu kanë pasur ngritjet dhe rëniet e tyre. Ekziston një përshtypje e përgjithshme që rrjetet e nxitura nga donatorët kanë qenë ato që nuk kanë mbijetuar, ndërsa gara në mes të OSHC-ve për burime të financimit dhe mungesa e organeve të përbashkëta për koordinimin e një rrjeti mund të jenë arsye tjera për shuarjen e tyre. Megjithatë, koalicionet ad-hoc dhe grupet jo formale të OSHC-ve në mënyrë shumë të suksesshme kanë ndërmarrë një numër të iniciativave. Reagimi i shoqërisë civile ndaj amendamentimit të Ligjit mbi OJQ-të dhe kontributi i tyre aktiv në këtë proces është një nga sukseset e arritura, duke ofruar një shembull që kur ekziston një çështje konkrete e interesit të përbashkët dhe arrihet të bëhet ndarja e qartë të përgjegjësisë në mes tyre, OSHC-të mund të ndikojnë në proceset e rëndësishme të shoqërisë.

<sup>14</sup> Raporti i Progresit i KE 2010 – faqe.17.

## ANALIZA E SHOQËRISË CIVILE

### 1. ANGAZHIMI CIVIL

Angazhimi Civil është dimension i parë i matur nga ISHC-ja, që synon hulumtimin e shkallës së angazhimit të individëve në iniciativat shoqërore dhe ato të ndërlidhura me politikat. Ai përbëhet nga gjashtë nën-dimensione që dalin nga 13 indikatorë specifik. Të dhënat për këtë dimension kryesisht janë mbledhur nga Hulumtimi i Popullsisë.


Edhe pse shumica e nën-dimensioneve që e përbëjnë këtë dimension rezultojnë në vlerat në mes 20 dhe 30, rezultati kumulativ i Angazhimit Civil është 44.0%.

Tabela 2: Angazhimi Civil – Rezultatet e nën-dimensioneve

| 1   | Angazhimi Civil                   | 44.0 |
|-----|-----------------------------------|------|
| 1.1 | Shtrirja e angazhimit shoqëror    | 21.6 |
| 1.2 | Thellësia e angazhimit shoqëror   | 40.5 |
| 1.3 | Diversiteti i angazhimit shoqëror | 80.9 |
| 1.4 | Shtrirja e angazhimit politik     | 21.6 |
| 1.5 | Thellësia e angazhimit politik    | 32.5 |
| 1.6 | Diversiteti i angazhimit politik  | 67.1 |

#### 1.1. Shtrirja e angazhimit shoqëror

Shtrirja e angazhimit shoqëror, përmes matjes së përqindjes së njerëzve që në mënyrë aktive angazhohen në aktivitetet shoqërore të shoqërisë civile, tregon se një numër shumë i kufizuar i popullsisë së Kosovës aktualisht është aktiv në iniciativat e ndryshme në komunitet. Sipas Hulumtimit të Popullsisë, vetëm 21.6 % të njerëzve në Kosovë janë të përfshirë në veprime të ndryshme shoqërore. Ky rezultat del nga tre indikatorë specifik, e që janë anëtarësia shoqërore, vullnetarizmi shoqëror dhe angazhimi në komunitet. Këta indikatorë tregojnë se vetëm disa kosovarë (15.5 %) janë anëtarë aktiv të organizatave shoqërore, përfshirë ato fetare, sportive dhe kulturore. Ngjashëm me këtë, vetëm 14.0% e popullsisë bën punë vullnetare për një organizatë të



tillë, ku përqindja substanciale e punës vullnetare bëhet për organizatat fetare. Në këtë aspekt, njerëzit që angazhohen në vullnetarizëm të orientuar kah feja mund të konsiderohen si aktivistë. Mirëpo, 35.3% e popullsisë përfshihet në aktivitete në komunitet përmes mënyrave më jo formale, për shembull përmes kalimit të kohës në shoqëri me njerëzit tjerë në klube sportive ose organizata vullnetare/shërbyese.

Figura 3: Shtrirja e angazhimit shoqëror

Arsye të ndryshme mund të jenë para këtyre rezultateve të ulëta. Një nga to mund të jetë standardi i ulët jetësor i popullsisë në përgjithësi, që drejtpërdrejtë mund të shkaktojë mosinteresimin e

njerëzve me të ardhura të ulëta ndaj përfshirjes në iniciativat në komunitet. Në një vend ku gati gjysma e popullsisë është e varfër, është e vështirë të pritët përfshirja e tyre në aktivitete tjera, përveç atyre që sigurojnë mjete themelore financiare të jetesës. Arsyeja tjetër pas kësaj, e që është përmendur nga shumë pjesëmarrës të grupeve të fokusit, ishte e tërë dekada e solidaritetit shoqëror dhe vullnetarizmit gjatë periudhës së okupimit në Kosovë. Motivi i lartë politik i asaj kohe më nuk ekziston pas çlirimit dhe pavarësisë, ndërsa burimet dhe energjia e asaj kohe tanimë janë shpenzuar. I fundit por jo më pak i rëndësishëm, është besimi shumë i ulët i qytetarëve në parti politike dhe institucione politike, e që drejtpërdrejtë ndikon në qëndrimin e njerëzve ndaj përfshirjes në aktivitetet shoqërore.

## 1.2. Thellësia e angazhimit shoqëror

Thellësia e angazhimit shoqëror synon vlerësimin e shpeshhtësisë ose intenzitetit të pjesëmarrjes nga ata që u identifikuan më lart që angazhohen në aktivitete. Respondentët që marrin pjesë në aktivitete në komunitet kanë tendencë ta bëjnë një gjë të tillë së paku një herë në muaj (64.3 %), dhe kjo është një shifër shumë më e lartë sesa përqindja e atyre që janë aktiv në OSHC të cilët bëjnë punë vullnetare për më tepër se një organizatë (30.8 %), ose janë të anëtarësuar në më tepër se një organizatë (26.4 %). Në përgjithësi, rezultati i thellësisë së angazhimit shoqëror, që qëndron në 40.5 %, tregon një potencial për një angazhim mjaft të lartë shoqëror, posaçërisht marrë parasysh kapitalin e ulët shoqëror ku vetëm 9.1 % e respondentëve mendojnë se mund t'i besohet shumicës së njerëzve.

Kjo i dërgon një porosi të fuqishme OSHC-ve të cilat duhet t'i forcojnë përpjekjet e tyre për shfrytëzimin e këtij potenciali dhe përfshirjen e më tepër qytetarëve në një llojlojshmëri më të madhe të formave të organizuara të pjesëmarrjes.

## 1.3. Diversiteti i angazhimit shoqëror

Ky nën-dimension mat diversitetin në kuadër të shoqërisë civile, e që është përfaqësimi i grupeve të ndryshme shoqërore në mesin e atyre që janë aktiv në aktivitetet dhe organizatat e shoqërore. Me 80.9 %, indikator tregon një nivel shumë të lartë të diversitetit në mesin e anëtarëve të organizatave civile sqë mirren me çështje shoqërore. Edhe pse kjo vlerë është konsideruar të jetë një vlerësim i lartë nga Grupet e Fokusit dhe Punëtorja Kombëtare, në përgjithësi ajo tregon se shoqëria civile nuk dominohet nga ndonjë grup i caktuar shoqëror.

Megjithatë, është interesant të theksohet dallimi në etnicitet dhe gjini për sa i përket anëtarësisë së njerëzve në aktivitete shoqërore: serbët e Kosovës dhe meshkujt në masë të madhe janë më aktiv sesa shqiptarët e Kosovës dhe femrat. Derisa dallimi në mes gjinive mund të kuptohet në një shoqëri tradicionale, qasja pasive nga shumica shqiptare është brengosëse. Institucionet shtetërore, krijimi i të cilave për kohë të gjatë ka qenë shkaku i përpjekjeve të shqiptarëve të Kosovës, mund të shihen si organe kompetente për trajtimin e problemeve të tyre. Tani që këto institucione janë krijuar, angazhimi i qytetarëve mund të shihet si rezistencë ndaj këtyre institucioneve më shumë se sa kontribut aktiv drejt shtet-ndërtimit dhe zhvillimit shoqëror.

## 1.4. Shtrirja e angazhimit politik

Ky nën-dimension, me një rezultat prej 21.6%, tregon përqindjen e njerëzve që janë të përfshirë në mënyrë aktive në aktivitetet që mund të konsiderohen të natyrës politike. Në këtë kategori, ISHC-ja përfshinë partitë politike, sindikatat, OSHC-të mjedisore, profesionale dhe humanitare dhe format tjera të shoqërisë civile që kryesisht merren me politikën dhe politikë-bërjen. Niveli i përgjithshëm i angazhimit politik është i ngjashëm me nivelin e angazhimit shoqëror. Megjithatë, nivelet e ulëta të të dy nën-dimensioneve konfirmojnë mosinteresimin e qytetarëve ndaj aktiviteteve civile në përgjithësi. Vetëm 12.9% e respondentëve janë përgjegjur se ata janë anëtarë aktiv të organizatave politike, ndërsa 15.3% e respondentëve raportojnë se bëjnë punë vullnetare për organizatat politike.




Figura 4: Antarësimi në organizatat shoqërore dhe politike

Në të dy këta indikatorë – niveli i angazhimit shoqëror dhe politik – organizatat humanitare dhe bamirëse dhe partitë politike tërheqin më shumë anëtarë dhe vullnetarë. Kjo përparësi e angazhimit në organizatat humanitare/bamirëse dhe partitë politike e jo angazhimit në format tjera të OSHC-ve të natyrës shoqërore dhe politike mund të jetë për shkak të asaj se çfarë presin ata prej këtyre aktiviteteve. Organizatat bamirëse dhe partitë politike mund të demonstrojnë një ndikim më të menjëhershëm, që mund të supozohet të jetë më i dëshirueshëm nga qytetarët në krahasim me ndikimin afatgjatë të organizatave tjera, siç janë të drejtat e njeriut ose avokimi dhe demokratizimi i OSHC-ve. Mirëpo, 36.7% e respondentëve raportojnë të kenë marrë pjesë në veprimet e ndryshme politike individuale, siç është nënshkrimi i peticionit ose pjesëmarrja në bojkot ose demonstrata paqësore në pesë vitet e fundit. Sipas Hulumtimit të Popullsisë, një përqindje e ngritur e pjesëmarrjes në veprimet e ndryshme politike individuale është evidente në popullsinë serbe të Kosovës krahasuar me popullsinë shqiptare të Kosovës.

Rezultati i ulët i nën-dimensionit të angazhimit politik gjithashtu pasqyron gjetjet e Hulumtimit të Popullsisë mbi besimin e publikut në organizatat politike dhe partitë politike, e që është i ulët. Ky trend ekziston në Kosovë sidomos viteve të fundit, marrë parasysh sfidat dhe mangësitë e institucioneve politike për t’i adresuar nevojat e përgjithshme të qytetarëve, ashtu siç vazhdimisht raportohet në shumë raporte vendore dhe ndërkombëtare, si dhe në diskutimet e Grupeve të Fokusit në kuadër të ISHC-së.

### 1.5. Thellësia e angazhimit politik

Thellësia e nën-dimensionit të angazhimit politik tregon pjesën e popullsisë aktive që janë të përfshirë në më tepër se një organizatë politike ose të angazhuar në më tepër se një aktivitet politik. Nga respondentët aktiv, 32.5 % deklarojnë se ata janë aktiv në më tepër se një organizatë ose



aktivitet politik. Rezultati i përgjithshëm i nën-dimensionit rezulton nga tre indikatorë specifik: anëtarësia e shumëfishtë, që qëndron në 26.3 %, 28.3 % që raportojnë aktivitete të shumëfishta vullnetare politike, dhe 42.9% që raportojnë veprime të shumëfishta të aktivitetit politik individual.

### 1.6. Diversiteti i angazhimit politik

Nën-dimensioni i fundit i dimensionit të Angazhimit Civil tregon diversitetin e pjesës së popullsisë që merr pjesë në mënyrë aktive në format e ndryshme të angazhimit politik. Me fjalë të tjera, ai shtron pyetjen nëse femrat, minoritetet etnike, dhe njerëzit nga zonat rurale dhe të largëta janë të angazhuar në organizatat me orientim politik. Me 67.1%, ky rezultat tregon një përqindje relativisht të lartë të diversitetit të njerëzve politikisht aktiv.

### 1.7. Përfundimet

Në përgjithësi, grupet e fokusit, KK dhe pjesëmarrësit në Punëtorinë Kombëtare kanë vërtetuar gjetjet dhe rezultatet e këtij dimensionit, me diskutime të vogla për vlerat e larta të të dyja nën-dimensioneve të diversitetit.

Angazhimi Civil, pas Ndikimit të Perceptuar, del të jetë dimensionit i dytë më i dobët i shoqërisë civile të Kosovës. Anëtarësia e ulët në iniciativat politike dhe ato shoqërore, si dhe nivelet e ngjashme të vullnetarizmit në të dyja këto fusha, e karakterizojnë shoqërinë kosovare si një shoqëri shumë indiferente me një nivel të lartë të mosinteresimit të qytetarëve ndaj jetës publike në përgjithësi. Megjithatë, nivelet më të larta të aktivizimit jo-formal dhe individual, siç janë angazhimi në komunitet dhe pjesëmarrja në veprime të ndryshme politike individuale tregojnë se potenciali është i pranishëm, ndërsa i mbetet OSHC-ve dhe të tjerëve ta aktivizojnë këtë potencial. Kjo konfirmon perceptimet e një hendeku në mes të OSHC-ve dhe qytetarëve, që gjithashtu pasqyrohet në nivelin e besimit ndaj OSHC-ve dhe partive politike të paraqitur në Hulumtimin e Popullsisë. Në fund, mungesa e dallimit në mes të grupeve të ndryshme shoqërore dhe demografike lidhur me aktivizimin e tyre tregon një grup shumë të llojlojshëm të qytetarëve aktiv dhe një ekzistencë të ulët të pengesave në mes të grupeve të ndryshme si në angazhimet shoqërore ashtu edhe në ato politike, megjithëse këtu nuk merret parasysh dallimi ndër etnik.

## 2. NIVELI I ORGANIZIMIT

Dimensioni i Nivelit të Organizimit të ISHC-së hulumton ekzistimin e kushteve organizative që mundësojnë një shoqëri civile funksionale në Kosovë. Një vlerësim i infrastrukturës së brendshme të OSHC-ve bëhet në aspektin e qeverisjes, vetë-rregullimit, burimeve financiare, njerëzore, dhe teknologjike, komunikimit brenda sektorit dhe bashkëpunimit me OSHC-të tjera dhe lidhjet ndërkombëtare, duke synuar të ofrojë një pasqyrë të qartë për atë se çka e karakterizon shoqërinë civile. Rezultati e ISHC-së mbi shkallën e institucionalizimit që e karakterizon shoqërinë civile në Kosovë është 70.7%, një rezultat ky i lartë krahasuar me vendet tjera.

ISHC-ja vlerëson gjashtë nën-dimensione (shikoni tabelën 3), ku pesë të parat rezultojnë nga Hulumtimi i Organizatave dhe i fundit nga i Databaza e Unionit të Shoqatave Ndërkombëtar. Pasi që Kosova nuk është e përfshirë në këtë databazë, nën-dimensioni i fundit nuk është llogaritur.

Tabela 3: Niveli i Organizimit – Rezultatet e nën-dimensioneve

| 2   | Niveli i Organizimit                | 70.7 |
|-----|-------------------------------------|------|
| 2.1 | Qeverisja e brendshme               | 89.9 |
| 2.2 | Infrastruktura                      | 69.7 |
| 2.3 | Komunikimi sektoral                 | 88.4 |
| 2.4 | Burimet njerëzore                   | 18.3 |
| 2.5 | Burimet financiare dhe teknologjike | 87.4 |
| 2.6 | Lidhjet ndërkombëtare               | -    |

### 2.1. Qeverisja e brendshme




Figura 5: Si do ta vlerësonit qasjen e OSHC-ve kur aplikojnë për fonde te donatorët?

regjistrimit të OSHC-së, ndërsa nuk ka mekanizma për sigurimin e funksionalitetit të tyre në praktikë. Sipas të gjitha diskutimeve, ky indikator do të ishte substancialisht më i vogël nëse funksionaliteti i bordit të drejtorëve dhe/ose kuvendit ekzaminohet.

Rezultatet e pyetjeve plotësuese që synonin vlerësimin nëse projektet e OSHC-ve bien brenda misioneve të tyre kanë demonstruar nivelin shumë të ulët të korrelacionit në mes të misioneve

Nën-dimensioni i parë i Nivelit të Organizimit e tregon menaxhimin e OSHC-ve përmes ekzaminimit të përqindjes së OSHC-ve që kanë një sistem të qeverisjes dhe menaxhimit, siç është bordi i drejtorëve ose kuvendi. Qeverisja e brendshme së OSHC-ve rezulton në 89.9%, dhe raportohet si një nga indikatorët më të lartë në tërë studimin. Mirëpo, të gjitha forumet e ISHC-së e kanë konsideruar këtë vlerë si çorientuese sepse ekzistimi formal i organeve të tilla kërkohet me ligj si pjesë e

zyrtare të OSHC-ve dhe fushave të punës në të cilat janë të përfshira. 71.7 % të OSHC-ve të hulumtuara mendojnë se shumica e OSHC-ve aplikojnë për fonde jashtë fushës së misionit të tyre, duke konfirmuar se fondet në dispozicion janë forca nxitëse prapa aktiviteteve të shoqërisë civile, shumë më tepër se misionet e tyre që synojnë pasqyrimin e nevojave të anëtarëve të tyre.

## 2.2. Infrastruktura

Kur janë pyetur nëse organizata e tyre është anëtare formale e ndonjë federate, grupi ombrellë, ose rrjeti mbështetës, 69.7% e OSHC-ve kanë dhënë përgjigje pozitive. Ngjashëm me nën-dimensionin e mëparshëm, formalisht ky rezultat është i fuqishëm. Megjithatë, në praktikë numri i rrjeteve aktive është shumë i ulët dhe OSHC-të e njëjta i përkasin rrjeteve të shumta. Kjo është diskutuar dhe paraqitur si në Grupet e Fokusit të ISHC-së ashtu edhe në rastet e studimit. Megjithatë, disa rrjete formale kanë vazhduar të ekzistojnë për një kohë më të gjatë dhe kanë vazhduar të luajnë rolin e tyre fillestar. Rrjeti Kosovar i Grave dhe koalicioni i OSHC-ve që monitorojnë zgjedhjet “Demokracia në Veprim” janë dy shembuj konkretë, ku të dyja i kanë ngritjet dhe rëniet e tyre. Është një përshtypje e përgjithshme, e diskutuar gjithashtu edhe në Grupet e Fokusit, se rrjetet e nxitura nga donatorët kanë qenë ato të cilat nuk kanë mbijetuar, ndërsa konkurrenca në mes të OSHC-ve për burime financiare dhe mungesa e organeve të përbashkëta për koordinimin e rrjetit mund të jenë arsye tjera për shuarjen e tyre. Mirëpo, koalicionet ad-hoc dhe grupet jo formale të OSHC-ve në mënyrë të suksesshme kanë ndërmarrë një numër të iniciativave, posaçërisht gjatë vitit 2010, në fushat e sundimit të ligjit, anti-korrupsionit, avokimit ndërkombëtar, dhe parandalimit të amendamenteve restriktive të Ligjit mbi OJQ-të (shikoni më poshtë). Prandaj, këto iniciativa e kanë ngritur potencialin për një ndikim efektiv të strukturave të tilla mbështetëse.

## 2.3. Komunikimi sektoral

Indikatorët e komunikimit sektoral tregojnë nivelin në të cilin akterët e ndryshëm të shoqërisë civile komunikojnë dhe bashkëpunojnë me njëri tjetrin, në veçanti përmes takimeve të drejtpërdrejta dhe shkëmbimit të informatave në mes të OSHC-ve. Të pyetur nëse kanë takuar OSHC të tjera në tre muajt e fundit, 89.9% të organizatave kanë janë përgjigjur pozitivisht. Një përqindje e ngjashme (86.9%) gjithashtu ka raportuar se ata kishin pasur shkëmbim të informatave dhe dokumenteve gjatë tre muajve të fundit.

Niveli i lartë i këtij nën-dimensioni mund të shpjegohet në mënyra të ndryshme. Sikurse është diskutuar në Grupet e Fokusit, madhësia e vogël e Kosovës dhe numri relativisht i ulët i OSHC-ve aktive e ndihmon komunikimin, përfshirë komunikimin jo formal dhe spontan. Është një çështje tjetër nëse ky komunikim dhe shkëmbimi i informatave prodhon aktivitete të përbashkëta dhe e bën këtë bashkëpunim me të vërtetë efektiv.

Gjatë dy viteve të fundit, në kuadër të ‘një grupi jo formal të OSHC-ve për avokim’, një fushatë e përbashkët e avokimit ka grumbulluar shumë OSHC aktive dhe mund të merret si një praktikë e mirë e bashkëpunimit në çështjet e interesit të përbashkët. Me një numër të masave restriktive të propozuara dhe një përpjekjeje për t’i ndryshuar parimet themelore të sektorit jo për përfitim, propozimi i qeverisë për amendamente të Ligjit mbi OJQ-të ka rrezikuar ardhmërinë e sektorit. Reagimi në kohë dhe i bazuar në ekspertizë, një kombinim i metodave të ndryshme të presionit, lobimit dhe avokimit dhe përpjekjet e përbashkëta, bazuar në një interes dhe respekt të përbashkët, kanë rezultuar në ndërprerjen e tentimit të qeverisë për të ndryshuar Ligjin mbi OJQ-të në vitin 2010.

## 2.4. Burimet njerëzore

Nën-dimensioni për vlerësimin e qëndrueshmërisë së burimeve njerëzore në sektorin e shoqërisë civile, duke hulumtuar proporcionin në mes të stafit që paguhet dhe vullnetarëve, rezultoi në një nga nën-dimensionet më të ulëta në përgjithësi me një rezultat total prej 18.3%. Pyetja specifike

prapa këtij indikatorit është bazuar në nocionin se OSHC-të kanë një bazë të stafit të qëndrueshëm kur ky staf përbëhet prej jo më tepër se 25% prej vullnetarëve. Arsyet prapa kësaj shifre të ulët, sikurse është diskutuar në Punëtorinë Kombëtare, mund të gjenden në përkrahjen e bazuar në projekt nga shumica e donatorëve dhe pamundësia e OSHC-ve për sigurimin e fondeve alternative që do t'ju mundësonte ta ruajnë stafin e kualifikuar dhe kompetent në periudhat në mes të projekteve. Përveç kësaj, ekziston një nivel përgjithësisht i ulët i burimeve njerëzore në Kosovë që drejtpërdrejtë pasqyrohet edhe në sektorin e shoqërisë civile. Sipas një diskutuesi të një Grupi të Fokusit, "...nëse burimet e qëndrueshme njerëzore të OSHC-ve aktive janë 18.3%, a mund të imagjinoni se sa do të ishte rezultati nëse do të përfshiheshin edhe ato pasive?" Kjo ilustron më së miri situatën kur është fjala për stafin kompetent dhe profesional të sektorit.

Situata bëhet edhe më problematike kur merret parasysh trendi në rënie i punës vullnetare në shoqërinë civile. Sipas Hulumtimit të Organizatave, 48.3% e OSHC-ve të hulumtuara mendojnë se puna vullnetare është duke rënë, dhe shumica e tyre e shohin mungesën e kornizës së duhur ligjore mbi punën vullnetare si një nga arsyet për këtë. Deri më tani, nuk është bërë ndonjë përpjekje për zhvillimin e një kornize të tillë, përveç disa dispozitave në Ligjin mbi Rininë.

Nëse adresohet në mënyrë të suksesshme, kjo çështje do të shpinte në rritjen e kompetencës dhe profesionalizmit të sektorit, dhe kështu do të mundësonte shërbime më të mira dhe më shumë përfitues nga aktivitetet e OSHC-ve. Për ta adresuar këtë çështje, akterët relevantë duhet të ndër marrin hapa specifik.

## **2.5. Burimet financiare dhe teknologjike**

Ky nën-dimension tregon burimet financiare dhe teknologjike të përdorura nga shoqëria civile në Kosovë, duke hulumtuar trendet e viteve të fundit në të hyra dhe shpenzime nga OSHC-të e hulumtuara, si dhe qasjen në telefon, internet dhe paisje tjera teknologjike. Rezultati i përgjithshëm i këtij nën-dimensioni qëndron në 87.4%, me indikatorin e qëndrueshmërisë financiare në 83.8% dhe burimet teknologjike në 90.9%. Qëndrueshmëria financiare është matur përmes krahasimit të ndryshimeve në të ardhurat dhe shpenzimet e OSHC-së gjatë dy viteve të fundit, ndërsa burimet teknologjike janë bazuar në posedimin e pajisjeve themelore teknologjike të OSHC-ve të hulumtuara. Derisa kjo e fundit është e kuptueshme kur jetohet në një epokë të teknologjisë së lirë dhe lehtë për tu gjetur, situata lidhur me burimet financiare është më e ndërlikuar. Pas një dekade të financimit të madh ndërkombëtar për shoqërinë civile, shumë donatorë kanë filluar ta zhvendosin fokusin e tyre gjeografik dhe të tërhiqen nga Kosova. Diskutimet në forumet e ndryshme të ISHC-së, si dhe gjetjet e rasteve të studimit, tregojnë se shumica totale e fondeve në dispozicion për shoqëri civile është duke rënë. Megjithatë, rezultati i këtij indikator vërtetohet duke marrë parasysh faktin se studimi ka përfshirë vetëm OSHC-të aktive, që automatikisht janë aktive sepse ato kanë qenë në gjendje të vazhdojnë ngritjen e fondeve për aktivitetet e tyre, dhe si të tilla kanë burime të qëndrueshme financiare. Mirëpo, shumica e pjesëmarrësve në Grupet e Fokusit janë të mendimit se numri i OSHC-ve aktive në krahasim me numrin e atyre të regjistruara është në rënie. Tërheqja e shumë donatorëve të vegjël nga Kosova – dhe si rrjedhojë e një shume të konsiderueshme të fondeve – mund të jetë një nga arsyet kryesore për këtë.




Figura 6: Të ardhurat dhe Shpenzimet e OSHC-ve të hulumtuara, krahasuar me vitin paraprak

Kur flasim për burimin e fondeve për sektorin, rezultatet qartë tregojnë një varshmëri të lartë nga donatorët ndërkombëtarë, që kontribuojnë 70.17% nga i tërë financimi për shoqërinë civile. Duke u shtuar këtyre edhe donacionet private nga të huajt (siç është Fondacioni Soros), burimet lokale nuk tejkalojnë 20% të të hyrave të përgjithshme. Nga të gjitha burimet, më e ulëta është ajo nga shërbimet, që është vetëm 0.53% nga të gjitha të hyrat e sektorit. Nëse synohet një sektor i qëndrueshëm, ky është një nga burimet që duhet të rritet në masë të madhe.




Figura 7: Burimet e financimit të fondeve për shoqërinë civile në Kosovë

## 2.6. Lidhjet ndërkombëtare

Kur flitet për lidhjet ndërkombëtare, metodologjia e ISHC-së përdor të dhënat zyrtare të Databazës së Unionit të Shoqatave Ndërkombëtare. Pasi që Kosova nuk është e regjistruar në këtë databazë, ky nën-dimension nuk ka një rezultat dhe nuk është përfshirë në llogaritjet e përgjithshme të dimensionit.

Megjithatë, është një përshtypje e përgjithshme se pas luftës së vitit 1999, Kosova ka qenë në vëmendjen e shumë OJQ-ve ndërkombëtare (OJQN), në veçanti të atyre që trajtojnë çështjet e pas konfliktit, siç janë rindërtimi dhe emergjenca, pajtimi ndëretnik dhe çështjet e minoriteteve. Kohëve të fundit, shumica e këtyre OJQN-ve janë tërhequr nga Kosova, ndërsa të tjera (edhe pse në një

numër më të vogël dhe në veçanti ato që trajtojnë sundimin e ligjit, transparencën dhe anti-korrupsionin) së fundmi e kanë përfshirë Kosovën në sferën e tyre të punës. Kjo është vërejtur veçanërisht pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008. Problemet me njohjen ndërkombëtare të Kosovës gjithashtu ndikojnë drejtpërdrejtë në lidhjet ndërkombëtare të shoqërisë civile në Kosovë. Një numër i rrjeteve ndërkombëtare dhe atyre të BE-së nuk i pranojnë anëtarët nga Kosova për shkak të faktit se Kosova nuk është pjesë e OKB-së, respektivisht, nuk është njohur nga të gjitha vendet anëtare të BE-së. Megjithatë, këto probleme formale nuk e kanë ndaluar shoqërinë civile të Kosovës që të përfaqësohet në platforma dhe forume të ndryshme regjionale dhe Europiane. Në këtë aspekt, shoqëria civile është sektori më i ekspozuar në arenën ndërkombëtare, si në sasi ashtu edhe në cilësi.

### 2.7. Përfundimet

Në përgjithësi, grupet e fokusit, KK dhe pjesëmarrësit e Punëtorisë Kombëtare kanë vërtetuar gjetjet dhe rezultatet e këtij dimensionit, me një numër të komenteve për indikatorët e qeverisjes së brendshme dhe burimeve financiare.

Niveli i Organizimit ka rezultuar si dimensionit më i lartë i ISHC-së, duke treguar se shoqëria civile kosovare karakterizohet me një shkallë solide të institucionalizimit.

Shumica e OSHC-ve të hulumtuara kanë një sistem të qeverisjes formale dhe menaxhimit, siç është bordi i drejtorëve ose kuvendi, edhe pse diskutimet brenda forumeve të ndryshme të ISHC-së kanë theksuar dallimin në mes të ekzistimit të tyre në letër dhe në praktikë. Një pyetje e ngjashme ngritet rreth rrjeteve. Me vetëm disa rrjete aktive, anëtarësimi i OSHC-ve në këto struktura është më shumë i një natyre formale sesa aktive. Megjithatë, niveli i lartë i komunikimit sektoral dhe disa shembuj të suksesshëm të aktiviteteve të përbashkëta të kohëve të fundit tregojnë një potencial të madh për bashkëpunim në çështjet e interesit të përbashkët.

Derisa burimet teknologjike janë shumë të mëdha, situata lidhur me burimet financiare duket të jetë më e ndërlikuar. Me OSHC-të aktive që kanë arritur një shkallë solide të qëndrueshmërisë financiare, ekziston një perceptim i përgjithshëm se shuma totale e fondeve për shoqërinë civile është në rënie dhe shoqëria civile duhet gradualisht të gjejë mënyra alternative të financimit në mënyrë që të minimizohet varshmëria nga donatorët ndërkombëtarë.

Ndryshe nga indikatorët e lartpërmendur, gjetjet e ISHC-së tregojnë se burimet njerëzore janë një nga pikat më të dobëta të tërë sektorit. Mbështetja e bazuar në projekte dhe pamundësia për ngritjen e fondeve institucionale nga burimet financiare i bëjnë OSHC-të të cënueshme ndaj largimit të stafit nga puna, si dhe iu shkakton vështirësi në mobilizimin e stafit profesional dhe kompetent.

Në fund, edhe pse ballafaqohet me problemet e dala nga njohja e pjesshme e shtetit të pavarur të Kosovës nga komuniteti ndërkombëtar, shoqëria civile ka gjetur mënyrat për tu përfaqësuar në platforma dhe forume të ndryshme regjionale dhe Europiane.



### 3. PRAKTIKIMI I VLERAVE

Shkalla në të cilën shoqëria civile praktikon disa nga vlerat themelore është në fokus të këtij dimensionit, që ka rezultuar në rezultatin e dytë më të lartë prej 59.4%. Ky dimension është i bazuar në pesë nën-dimensione, ku të dhënat kryesisht janë marrë nga Hulumtimi i Organizatave. Katër të parat nxirren nga përgjigjet e OSHC-ve individuale, ndërsa ajo e fundit i kombinon përgjigjet dhe paraqet rezultatet kumulative për shoqërinë civile si një tërësi. Sikurse mund të shihni në tabelën 4, nën-dimensioni më i lartë i Praktikimit të Vlerave është ekzistimi i një kodi të mirësjelljes dhe transparencës (74.2%) ndërsa ai më i ulëti është Rregullorja e Punës (42.3 %).

Tabela 4: Praktikimi i Vlerave Rezultatet e nën-dimensioneve

| 3   | Praktikimi i Vlerave                               | 59.4 |
|-----|--|------|
| 3.1 | Qeverisja me vendim-marrje demokratike             | 61.6 |
| 3.2 | Rregulloret e punës                                | 42.3 |
| 3.3 | Kodi i mirësjelljes dhe transparenca               | 74.2 |
| 3.4 | Standardet mjedisore                               | 57.7 |
| 3.5 | Perceptimi i vlerave në shoqërinë civile si tërësi | 61.4 |

#### 3.1. Qeverisja me vendim-marrje demokratike

Ky nën-dimension, me një rezultat prej 61.6%, përqipet të zbulojë se kush i merr vendimet në OSHC. Ai është një kombinim i përgjigjeve ndaj kësaj pyetjeje, duke hulumtuar nëse vendimet merren nga anëtarët, stafi, udhëheqësit e emëruar ose të zgjedhur, bordet e emëruara ose të zgjedhura, etj.




Figura 8: Kush i merr vendimet kryesore në organizatën tuaj?

Sikurse shihet në figurën 8, përgjigjet e OSHC-ve të hulumtuara tregojnë se bordi (i zgjedhur ose i emëruar) është përgjegjës për vendimet kryesore të një organizate, ndërsa një udhëheqës duket të ketë më pak autoritet vendim-marrës. Sipas diskutimeve të Grupit të Fokusit, rezultatet nuk tregojnë pushtetin real të udhëheqësve, pasi që shumica e bordeve shërbejnë si një forum formal për vërtetimin e

vendimeve tanimë të marra. Si duket OSHC-të më tepër i janë përgjigjur kësaj pyetjeje sipas rregullave të tyre të brendshme të procedurës, sesa raportimit të praktikës reale. Përveç kësaj, një diskutim në kuadër të KK-së ka ngritur çështjen e vendim-marrjes së vërtetë demokratike në OSHC. Nëse përgjegjësia e fundit ligjore dhe morale për ndonjë nga vendimet e rëndësishme i përket Drejtorit Ekzekutiv, a është e drejtë të ndahet autoriteti vendim-marrës me stafit, përderisa përgjegjësia që del nga këto vendime nuk ndahet?

### 3.2. Rregulloret e punës

Ky nën-dimension rrjedh nga katër indikatorë, e që janë mundësitë e barabarta, anëtarësimi në sindikatat e punës, trajnimet mbi të drejtat në punë dhe politika për standardet e punës që janë në dispozicion të publikut. Rezultati qëndron në 42.3%.

Më tepër se gjysma e OSHC-ve të hulumtuara kanë deklaruar se posedojnë politikat e shkruara lidhur me mundësitë e barabarta/pagës së barabartë për gratë (55.6%), ndërsa 68% e tyre deklarojnë t'i kenë politikat e shkruara mbi standardet e punës. Mirëpo, vetëm 35.7% e OSHC-ve thonë se ata mbajnë trajnime për të drejtat në punë për stafin e tyre të ri. Ashtu siç ishte përmendur në diskutimet e Grupit të Fokusit, është e rëndësishme të theksohet se ISHC-ja ka mbledhur dëshmitë nga përgjigjet e 100 OSHC-ve aktive, por nuk ka pasur ndonjë mjet shtesë për të kontrolluar nëse këto dokumente ekzistojnë në praktikë. Mirëpo, edhe pse nuk është hulumtuar më tej, është një perceptim i përgjithshëm se rregullat e punës që janë standarde në këto organizata e që përdoren nga shumica e OSHC-ve aktive, përfshijnë dispozita të veçanta mbi mundësitë e barabarta dhe standardet e punës.

Indikatori më i ulët i këtij nën-dimensioni dhe një nga më të ulët në përgjithësi është ai që pasqyron përqindjen e stafit të paguar që janë anëtarë të sindikatave. Ky indikatorë ka rezultuar vetëm 9.9%, duke konfirmuar perceptimet e KK dhe Grupet e Fokusit në nivelin e ulët të zhvillimit të sindikatave në Kosovë. Trendi i ulët i sindikalizmit ka vazhduar në Kosovë që nga viti 1999, pas përfundimit të luftës.

### 3.3. Kodi i mirësjelljes dhe transparenca

Nën-dimensioni që hulumton nëse OSHC-të kanë kod të mirësjelljes dhe raporte financiare në dispozicion të publikut, vendos shoqërinë civile në Kosovë si një sektor shumë transparent. Rezultati i përgjithshëm i këtij nën-dimensioni qëndron në 74.2%, ku 73.7 % e organizatave kanë deklaruar se posedojnë kodin e mirësjelljes në dispozicion të publikut dhe 74.7% posedojnë informata financiare në dispozicion të publikut. Mirëpo, kur janë pyetur se ku mund të gjenden këto informata, një numër i madh i OSHC-ve që kanë deklaruar se të dy këto dokumente janë në dispozicion të publikut thonë se dokumentet mund të gjenden në zyrat e tyre. Kjo informatë, si dhe komentet nga KK dhe Punëtorja Kombëtare, tregojnë se kjo përqindje relativisht e lartë e përgjigjeve pozitive mund të mos pasqyrojë situatën reale. Një fakt shtesë është se ende vetëm një numër i kufizuar i OSHC-ve kanë uebfaqe aktive, ku do të mund t'i vendosnin këto informata në dispozicion të publikut më të gjerë.

Një trend inkurajues nga këto gjetje është se shumica e organizatave që ende nuk kanë politika të tilla të shkruara thonë se janë duke marrë parasysh krijimin e tyre.

### 3.4. Standardet mjedisore

Nëse OSHC-të shihen si një pjesë shtytëse e avancimit të shoqërisë, atëherë do të duhej të prisnim një nivel të lartë të trajtimit të çështjeve mjedisore brenda vet organizatave të shoqërisë civile. Mirëpo, nëse gjykohet nga përqindja e OSHC-ve që kanë një politikë të shkruar për standarde ambientaliste e që është në dispozicion të publikut, kjo nuk duket të jetë e saktë. Me 57.7%, ky nën-dimension tregon se pak më tepër se gjysma e OSHC-ve kanë standarde publike për mjedis, edhe pse 69% e atyre që nuk i kanë ato kanë menduar t'i krijojnë ato. Ngjashëm me indikatorët e mëparshëm, ISHC-ja nuk ka pasur ndonjë mjet plotësues për të kontrolluar nëse këto dokumente ekzistojnë në praktikë. Gjithashtu, ekzistojnë të dhëna shumë të pakta në dispozicion për grupet që në mënyrë specifike janë të përqëndruara në çështjet e mjedisit. Një Memorandum Mirëkuptimi në mes të Ministrisë së Mjedisit dhe një numri të OJQ-ve mjedisore është nënshkruar në vitin 2009, por deri më tani nuk duket të ketë ndonjë shenjë për zbatimin e tij. Lëvizja mjedisore në Kosovë, nëse ekziston një e tillë, mbetet e kufizuar në një numër shumë të kufizuar të OSHC-ve dhe individëve.

### 3.5. Perceptimet e vlerave në shoqërinë civile si tërësi

A është shoqëria civile duke e vendosur veten në ballë të kërkesave për llogaridhënie, transparencë dhe vendim-marrje demokratike nga sektorët tjerë? A janë duke u praktikuar këto vlera themelore brenda vet sektorit? Sa tolerante dhe paqësore është shoqëria civile? A ka raste të korrupsionit brenda shoqërisë civile? Këto janë disa pyetje që ky nën-dimension përpiqet t’iu përgjigjet, përmes gjashtë indikatorëve specifik.

Rezultati i përgjithshëm i nën-dimensionit qëndron në 61.4%, duke treguar se shoqëria civile në masë të madhe është tolerante dhe paqësore dhe në mënyrë aktive promovon paqen dhe angazhohet kundër dhunës. Indikatorët që konfirmojnë këtë arrijnë shifrat 88.9%, 67.5% dhe 78.8%. Duke iu përgjigjur Hulumtimit të Organizatave, 86.9% e OSHC-ve të hulumtuara kanë deklaruar se nuk ka forca brenda shoqërisë civile që përdorin dhunën. Brenda pjesës së mbetur prej 13% të OSHC-ve që mendojnë se dhuna përdoret brenda shoqërisë civile, 57.1% e tyre mendojnë se përdorimi i dhunës nga shoqëria civile është jashtëzakonisht i rrallë, ndërsa vetëm 7.1% thonë se forcat brenda shoqërisë civile që përdorin dhunën përfaqësojnë një numër domethënës të masës.

Ndërsa qëndron në ballë të kërkesave për llogaridhënie, transparencë dhe vendim-marrje demokratike nga sektorët tjerë, shoqëria civile ende është në gjysmë të rrugës për t’i praktikuar këto vlera si duhet brenda vetes. Kjo konfirmohet përmes rezultateve mbi perceptimin e demokracisë e brendshme, rezultati i së cilës është 49.5% për rolin aktual të shoqërisë civile në promovimin e vendim-marrjes demokratike brenda organizatave dhe grupeve të saj. Në mënyrë specifike, gati 79.8% e OSHC-ve të hulumtuara mendojnë se shoqëria civile luan një rol të kufizuar ose mesatar në këtë aspekt.

Një nga arsyet për këtë rezultat mund të ndërlidhet me perceptimin e korrupsionit brenda shoqërisë civile. Me një rezultat prej 26.3% për indikatorin që mat “jo-korrupsionin”, ky indikator është shumë i ulët dhe tregon se praktikatat e korrupsionit nuk janë një fjalë e panjohur për këtë sektor. Derisa vetëm 26.3% e OSHC-ve të hulumtuara konsiderojnë se praktikatat e korrupsionit brenda sektorit janë shumë të rralla, pjesa e mbetur deklarojnë perceptimet e tyre se korrupsioni në shoqërinë civile është kohë pas kohëshëm (51.5%) ose i shpeshtë (20.2%). Si një nga nivelet më të ulëta të këtij dimensionit, ky rezultat është shqetësues dhe duhet të adresohet në mënyrë serioze nga shoqëria civile.




Figura 9: A mendoni se rastet e korrupsionit në shoqëri civile janë...

### 3.6. Përfundimet

Në përgjithësi, grupet e fokusit, KK dhe pjesëmarrësit e Punëtorisë Kombëtare kanë vërtetuar gjetjet dhe rezultatet e këtij dimensionit, por duke theksuar se ISHC-ja nuk ka mjete specifike për verifikimin e ekzistimit të numrit të dokumenteve të shkruara dhe rregulloreve që OSHC-të i kanë deklaruar.

Ndërsa qeverisja me vendim-marrje demokratike fuqimisht theksohet në dokumentet e brendshme të sektorit të shoqërisë civile në Kosovë, kjo nuk transmetohet në zbatimin e duhur të këtyre parimeve në praktikë.

Shoqëria civile në Kosovë nuk është entuziaste për rregulloret e punës, pasi që ky nën-dimension ka qenë rezultati më i ulët në Praktikimin e Vlerave. Më tepër se gjysma e OSHC-ve deklarojnë t'i kenë rregulloret e shkruara për mundësitë e barabarta dhe pagat e barabarta për gratë, si dhe standardet e punës. Mirëpo, vetëm një e treta e tyre bëjnë trajnime për stafin e tyre të ri. Stafi i paguar i OSHC-ve qartësisht nuk ndihet rehat për t'u anëtarësuar në sindikata, pasi që më pak se 10% nga ta janë anëtarë të sindikatave.

Shumica e OSHC-ve thonë se ata kanë kod të mirësjelljes dhe informata financiare në dispozicion të publikut. Prapë, edhe pse ekzistimi i tyre nuk ka mundur të verifikohet, shumica kanë deklaruar se këto dokumente janë në dispozicion në zyrat e tyre, me një shkallë të ulët të publikimit në uebfaqe.

Komentet e ngjashme janë të vlefshme gjithashtu kur shikohet në standardet mjedisore, ku pak më tepër se gjysma e OSHC-ve kanë standarde mjedisore të shkruara dhe publike. Një trend pozitiv për të gjitha pyetjet mbi politikat dhe rregulloret e shkruara është se shumica e OSHC-ve që kanë deklaruar mos t'i kenë ato kanë thënë se janë duke menduar për hartimin e rregulloreve të tilla.

Në fund, ISHC-ja konfirmon perceptimin e kahmotshëm se shoqëria civile kosovare është shumë tolerante, paqësore dhe jo e dhunshme. Për më tepër, ajo i promovon këto vlera në shoqëri. Megjithatë, e njëjta nuk qëndron edhe për promovimin e vendim-marrjes demokratike përbrenda organizatave dhe grupeve të saj. Rezultatet tregojnë se shoqëria civile është ende në gjysmë të rrugës për të arritur këtë, dhe me perceptime të kohë pas kohshme ose të shpeshta të rasteve të korrupsionit në shoqëri civile, edhe rezultati nuk është befasues.

## 4. NDIKIMI I PERCEPTUAR

Motivi fillestar i njerëzve për tu mbledhur, dhe qëllimi i fundit i shoqërisë civile – në kuptimin e tij të gjerë – është përmirësimi i kushteve jetësore në komunitetin dhe shoqërinë e tyre. Megjithatë, matja e një ndikimi të tillë në kushte konkrete është shumë e vështirë. Kjo varet nga shumë faktorë, dhe për këtë arsye metodologjia e ISHC-së këtu përpiqet ta masë **Ndikimin e Perceptuar**, më shumë se sa vet ndikimin.


Matja e ndikimit të perceptuar bazohet në dy grupe specifike të të dhënave: perceptimi i brendshëm, e që është ndikimi i perceptuar i shoqërisë civile nga vetë OSHC-të, i matur përmes Hulumtimit të Organizatave; dhe perceptimi i jashtëm, i matur përmes një hulumtimi të veçantë mbi ndikimin e perceptuar të shoqërisë civile nga akterët të jashtëm, që përfshijnë popullsinë në përgjithësi dhe përfaqësuesit e përzgjedhur me kujdes nga sektorët tjerë siç është qeveria, Parlamenti, komunat, gjykatësit, bizneset, mediat, qarqet akademike dhe organizatat ndërkombëtare në Kosovë. Kombinimet e këtyre të dhënave, përmes shtatë nën-dimensioneve dhe 17 indikatorëve, kanë rezultuar në një perceptim të përgjithshëm të rezultatit të ndikimit prej vetëm 31.8%. Si rezultati më i ulët nga të gjitha dimensionet e ISHC-së, ndikimi i shoqërisë civile duket të jetë çështja më problematike e sektorit.

Tabela 5: Ndikimi i Perceptuar – Rezultatet e nën-dimensioneve

| 4   | Ndikimi i perceptuar                         | 31.8 |
|-----|--|------|
| 4.1 | Reagueshmëria (perceptimi i brendshëm)       | 26.8 |
| 4.2 | Ndikimi shoqëror (perceptimi i brendshëm)    | 47.6 |
| 4.3 | Ndikimi në politika (perceptimi i brendshëm) | 39.4 |
| 4.4 | Reagueshmëria (perceptimi i jashtëm)         | 23.8 |
| 4.5 | Ndikimi shoqëror (perceptimi i jashtëm)      | 41.5 |
| 4.6 | Ndikimi në politika (perceptimi i jashtëm)   | 31.7 |
| 4.7 | Ndikimi i Shoqërisë Civile në qëndrime       | 12.2 |

### 4.1. Reagueshmëria (perceptimi i brendshëm)

Duke i marrë zhvillimin ekonomik dhe sundimin e ligjit si dy brengat kryesore të shoqërisë kosovare, ky nën-dimension ekzaminon perceptimin e organizatave të hulumtuara mbi ndikimin e shoqërisë civile në këto fusha. Rezultati tregon se perceptimi i OSHC-ve për ndikimin e tyre në këto çështje në



masë të madhe është i ulët me një përqindje prej 26.8%. OSHC-të mendojnë se sektori kishte një ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik vetëm deri në shkallën prej 21.2 %. 52.5% e OSHC-ve të hulumtuara mendojnë se ndikimi këtu ka qenë shumë i kufizuar, ndërsa 26.3% e tyre thonë se sektori nuk ka pasur fare ndikim.

Figura 10: Ndikimi i shoqërisë civile në zhvillimin ekonomik dhe sundimit e ligjit (perceptimi i brendshëm)

Indikatori i dytë është pak më i lartë. Me një përqindje prej 32.3% në përgjithësi, ndikimi në sundimin e ligjit perceptohet si shumë i kufizuar nga 51.5% e OSHC-ve, ndërsa 25.3% e tyre thonë se ka pasur një ndikim të prekshëm. Rezultati i përgjithshëm i këtij nën-dimensioni është relativisht i ngjashëm me perceptimin e akterëve të jashtëm për të njëjtën çështje (shikoni nën-dimensionin 4.4 më poshtë), ku ndikimi në sundimin e ligjit nga ta shihet si më i lartë në krahasim edhe me vetë shoqërinë civile.

### 4.2. Ndikimi shoqëror (perceptimi i brendshëm)

Ky nën-dimension vlerëson ndikimin e perceptuar të shoqërisë civile për çështjet kryesore shoqërore ashtu siç përzgjedhen nga vet OSHC-të e hulumtuara, dhe rezultati i tij i përgjithshëm është 47.6%. Kur janë pyetur për nivelin e ndikimit në çështje shoqërore nga shoqëria civile si një tërësi, rezultati ishte 43.8%, ku arsimit dhe përkrahja e të varfërve ishin si fusha sociale me ndikimin më të madh të perceptuar. Më pozitiv është perceptimi i OSHC-ve të hulumtuara ku janë pyetur për ndikimin e vetë OSHC-ve individualisht. Rezultati i përgjithshëm i këtij indikatori është 51.4%. Prapë, një arsye për këtë dallim mund të jetë se kur janë pyetur për shoqërinë civile në përgjithësi, OSHC-të e hulumtuara marrin parasysh tërë shoqërinë civile përfshirë OSHC-të pasive dhe gjysmë pasive, ndërsa OSHC-të e hulumtuara, kur janë pyetur të mendojnë për vetveten, kanë qenë vetëm ato aktivet.

Viteve të fundit, një numër i iniciativave që kanë dalur nga shoqëria civile mund të shihen të kenë rezultuar në përmirësime solide në ambientin ligjor për disa kategori të grupeve të marginalizuara, siç janë njerëzit me nevoja të veçanta, të cilët kanë arritur të avokojnë në mënyrë të suksesshme për miratimin e disa strategjive e planeve të veprimit. Edhe pse këto dokumente janë miratuar, ende mbetet për t'u parë çështja e zbatimit të tyre të duhur në praktikë.

Krahasuar me perceptimin e jashtëm mbi ndikimin shoqëror të shoqërisë civile (shikoni 4.4 më poshtë) vlerat nuk janë larg njëra tjetrës, dhe ky nivel i vet-vlerësimit tregon se sektori si një tërësi është i vetëdijshëm se është në gjysmë të rrugës drejt përmbushjes së pritjeve.

### 4.3. Ndikimi në politika (perceptimi i brendshëm)

Ky nën-dimension tenton ta vlerësojë ndikimin e shoqërisë civile në fushën e politikave, ose në kushte konkrete, se sa aktive dhe e suksesshme është shoqëria civile për të ndikuar në politikat publike në Kosovë, sikurse perceptohet nga OSHC-të e hulumtuara. Rezultati i nën-dimensionit prej 39.4% nxirret nga tre indikatorë specifik, e që janë: ndikimi i shoqërisë civile në përgjithësi në politika, aktiviteti i ndërlidhur me politika i vet organizatës, dhe ndikimi në politika i vet organizatës.

Sikurse shihet nga rezultatet, ndikimi i përgjithshëm i shoqërisë civile si tërësi në politika shihet si i pakënaqshëm (21.2%), edhe pse gjatë dy viteve të fundit OSHC-të e hulumtuara mendojnë se organizatat e tyre kanë qenë mjaft aktive në ofrimin e alternativave specifike të politikave (59.6%). Mirëpo, kur janë pyetur për suksesin e organizatave të tyre lidhur me çështjet e përzgjedhura të politikave në të cilat ato kanë qenë aktive, sukcesi shihet si i kufizuar (37.4%). Diskutimet e Grupit të Fokusit kanë përmendur një numër të iniciativave të ndërlidhura me politika që kanë dalur nga shoqëria civile, siç është fushata mjedisore për ndërprerjen e ndërtimit të termocentralit të ri të njohur si 'Kosova C', e cila është bazuar në analizat e hollësishme dhe në përdorimin e mjeteve alternative për ngritjen e vetëdijess së qytetarëve lidhur me këtë çështje. Mirëpo, për shkak të ndërlidhshmërisë së bërjes së politikave publike në Kosovë dhe akterëve që ndikojnë në të, shoqëria civile mund të kontribuojë por jo edhe të jetë faktori vendimtar në presionin për ndonjë alternativë të politikave. Për më tepër, rastet e studimit tregojnë se bërja e politikave në Kosovë kryesisht kufizohet në ligjënie, për shkak të faktit se institucionet publike mezi hartojnë ndonjë politikë në kuptimin e vërtetë të fjalës, ndërsa pjesëmarrja e shoqërisë civile në atë proces është ashtu se ashtu i kufizuar.

#### 4.4. Reagueshmëria (perceptimi i jashtëm)

Perceptimi i akterëve të jashtëm mbi ndikimin e shoqërisë civile në zhvillimin ekonomik dhe sundimin e ligjit si dy brengat kryesore të shoqërisë kosovare është i ngjashëm me vet-perceptimin e OSHC-ve të hulumtuara. Një dallim i vogël në mes të perceptimeve të akterëve të jashtëm dhe vet-perceptimit të shoqërisë civile është se derisa shoqëria civile mendon se ndikimi në zhvillimin ekonomik ka qenë më i ulët, grupet e jashtme të interesit mendojnë të kundërtën. Me 23.8%, ky nën-dimension konfirmon se shoqëria civile nuk është mjaft reaguese ndaj nevojave reale të shoqërisë dhe anëtarëve të saj.

#### 4.5. Ndikimi Shoqëror (perceptimi i jashtëm)


Ky nën-dimension shikon ndikimin e shoqërisë civile si tërësi në çështjet kryesore shoqërore ashtu siç perceptohet nga akterët shoqëror, dhe rezultati i tij arrin përqindjen prej 41.5%. Përkrahja për të varfërit dhe grupet e marginalizuara, arsimit dhe ndihma humanitare janë përsëri fushat ku shoqëria civile shihet të ketë pasur më së shumti ndikim. Ndikimi në këto fusha – i përzgjedhur nga vetë respondentët e Hulumtimit të Perceptimeve të Jashtme – shihet si shumë i kufizuar nga më tepër se gjysma e tyre, dhe me një ndikim të prekshëm nga 40.5% e tyre.

Kur janë pyetur për ndikimin e shoqërisë civile në kontekstin shoqëror në përgjithësi, 52.5% e akterëve të jashtëm e shohin atë si shumë të kufizuar, ndërsa 42.5% e tyre mendojnë se ajo ka pak ndikim të prekshëm.

#### 4.6. Ndikimi në Politika (perceptimi i jashtëm)

Ky nën-dimension tenton ta mas aktivitetin e shoqërisë civile në fushën e politikave dhe ndikimin e saj në politikat publike në Kosovë, ashtu siç perceptohet nga akterët e jashtëm. Me përqindje prej 31.7%, rezultati tregon një ndikim të kufizuar të sektorit në bërjen e politikave publike.

Kur janë pyetur për fushat specifike të politikave në të cilat shoqëria ka qenë më së shumti aktive, akterët e jashtëm e kanë renditur ekonominë, çështjet sociale, arsimin dhe anti-korrupsionin. Mirëpo, ata shohin një rezultat të kufizuar nga ky aktivizim, me vetëm 14.1% të këtyre politikave të aprovuara dhe më shumë se gjysma ende në fazën e diskutimit. Një gjetje interesante mund të përmendet nëse krahasohet me gjetjet e reagueshmërisë nga brenda shoqërisë civile. Ndërsa gjetjet tregojnë se shoqëria civile ka pasur ndikim të vogël në zhvillimin ekonomik, ekonomia është fusha në të cilën akterët e jashtëm e shohin një aktivizim më të lartë nga shoqëria civile. Një shpjegim për këtë mund të jetë mungesa e politikave të vërteta nga institucionet publike në këtë fushë, ndërsa një



tjetër ka të bëjë me faktin se shumë politika/ligje/strategji edhe pse të aprovuara, nuk janë duke u zbatuar në praktikë. Në këtë aspekt, ky është një indikator i qartë se puna në nivelin e politikave nuk është e mjaftueshme për përmirësimin e situatës reale në terren, nëse politika nuk përcjellet nga kontributi për zbatimin në praktikë të dokumenteve të miratuara.

Figura 11: Krahasimi i perceptimit të brendshëm dhe të jashtëm në ndikimin e shoqërisë civile në politikë-bërje në përgjithësi



Mirëpo, është interesante të shihet se akterët e jashtëm kanë një perceptim më pozitiv të ndikimit të shoqërisë civile në bërjen e politikave në përgjithësi në Kosovë, krahasuar me vet-perceptimin e OSHC-ve të hulumtuara. Me 32.5%, ky indikator është më i lartë sesa ndikimi i perceptuar nga vetë OSHC-të, e që është 21.2%.

Për më tepër, rasti i studimit mbi përfshirjen e shoqërisë civile në procesin e bërjes së politikave në Kosovë paraqet disa gjetje interesante që qartë tregojnë mungesën e mekanizmave konkrete për këtë përfshirje. Mirëpo, dispozitat ligjore tanimë ekzistuese – që ofrojnë një ‘rrugë të hapur’ solide – nuk janë përdorur mjaft as nga shoqëria civile as nga autoritetet publike.


#### **4.7. Ndikimi i shoqërisë civile në qëndrime**

ISHC-ja synon t’i hulumtojë qëndrimet e njerëzve lidhur me një numër vlerash, siç janë besimi midis njerëzve, toleranca dhe ndjeshmëria publike. Përveç kësaj, ajo gjithashtu hulumton ndikimin e shoqërisë civile në qëndrimet e njerëzve përmes krahasimit të dallimit në vlera në mes qytetarëve që janë anëtarë të OSHC-së dhe atyre që nuk janë. Konkretisht, pyetjet që adresohen në këtë nën-dimension janë nëse anëtarët e OSHC-së kanë nivele më të larta të besimit, tolerancës dhe ndjeshmërisë publike krahasuar me ata të cilët nuk janë anëtarë të OSHC-ve.

Për më tepër, ky nën-dimension vlerëson besimin e qytetarëve në grupet e veçanta të shoqërisë civile.

Në këtë aspekt, ndikimi i përgjithshëm i shoqërisë civile në qëndrimet e njerëzve në Kosovë është mjaft i ulët, me një përqindje prej 12.0%. Duke i shikuar indikatorët specifik, dallimi në mes të anëtarëve të OSHC-së dhe jo-anëtarëve në besimin ndërpersonal është vetëm 2.7%; në nivelin e tolerancës dhe në nivelin e ndjeshmërisë publike nuk ka fare dallim. Është e rëndësishme të përmendet se derisa niveli i besimit ndërpersonal është shumë i ulët midis anëtarëve të OSHC-së dhe jo-anëtarëve, ndjeshmëria publike është në skajin tjetër, me një vlerë të lartë për të dyja. Ekzaminimi i hollësishëm i qëndrimeve të përgjithshme të qytetarëve në këto fusha bëhet në nën-dimensionin e fundit të ISHC-së, më poshtë.

Kur bëhet fjalë për nivelin e besimit që qytetarët e kanë në organizatat e shoqërisë civile, rezultati kumulativ është 45.4%. Mirëpo, ekzistojnë dallime të dukshme në mes të grupeve të ndryshme të OSHC-ve. Organizatat humanitare ose bamirëse gëzojnë nivelin më të lartë të besimit midis qytetarëve, me 57.4%, pasuar me organizatat rinore, ato të artit, muzikore dhe arsimore dhe organizatat që merren me të drejtat e njeriut, të gjitha me një përqindje prej diku 35%. Sindikatat



kanë vetëm 20.6% besim, ndërsa organizatat e avokimit dhe demokratizimit janë OSHC-të më së paku të besueshme me vetëm 14%. Është interesante të përmendet se gati në të gjitha kategoritë, niveli i besimit në OSHC është dukshëm më i lartë nga serbët e Kosovës se sa nga shqiptarët e Kosovës dhe minoritetet tjera etnike.

Figura 12: Niveli i besimit në sektorë të ndryshëm të OSHC-ve

#### 4.8. Përfundimet

Në përgjithësi, grupet e fokusit, KK dhe pjesëmarrësit e Punëtorisë Kombëtare kanë vërtetuar gjetjet dhe rezultatet e këtij dimensionit, me një nivel të befasisë për gjetjet e hulumtimeve lidhur me ndjeshmërinë publike.

Së pari, zhvillimi ekonomik dhe sundimi i ligjit janë konsideruar nga KK si brengat kryesore të shoqërisë kosovare. Si OSHC-të ashtu edhe akterët e jashtëm vlerësojnë ndikimin e shoqërisë civile në këto dy çështje si mjaft të ulët, me dallime të vogla në mes të perceptimeve të akterëve të jashtëm dhe vet-perceptimeve të shoqërisë civile, ku kjo e fundit mendon se ndikimi në zhvillimin ekonomik ka qenë më i ulët, dhe akterët e jashtëm mendojnë të kundërtën. Gjetjet e ISHC-së konfirmojnë se shoqëria civile nuk i është përgjigjur mjaftueshëm nevojave reale të shoqërisë dhe anëtarëve të saj.

Një situatë e ngjashme shihet në fushën e politikave. Kur hulumtohet aktiviteti i shoqërisë civile në fushën e politikave dhe ndikimin e tyre në politikat publike në Kosovë, rezultatet tregojnë një pajtim në mes të shoqërisë civile dhe akterëve të jashtëm në vlerësimin e këtij ndikimi si të kufizuar. Rastet e studimit tregojnë mungesën e mekanizmave konkrete për këtë përfshirje, por gjithashtu tregojnë se dispozitat ligjore tanimë ekzistuese nuk përdoren mjaft as nga shoqëria civile e as nga autoritetet publike. Dallimi në mes të aktivitetit dhe ndikimit në çështjet ekonomike tregon një mungesë të politikave publike në këtë fushë dhe problemet në zbatimin e tyre, ku paraqitet nevoja për rritjen e përfshirjes së shoqërisë civile në zbatimin e politikave/ligjit dhe mbikqyrjen e tyre.

Situata duket më pozitive për sa i përket ndikimit shoqëror, ku shoqëria civile vlerësohet të ketë ndikim pak më të madh, si nga vetë OSHC-të ashtu edhe nga akterët e jashtëm, ku përkrahja e të varfërve, grupet e marginalizuara, arsimit dhe ndihma humanitare janë fusha sociale në të cilat shoqëria civile ka pasur më tepër ndikim. Vet-vlerësimi nga OSHC-të e hulumtuara tregon se sektori si tërësi është i vetëdijshëm se është ende në gjysmë të rrugës drejt përmbushjes së pritjeve.

Kur hulumtohet ndikimi i shoqërisë civile në qëndrimet e njerëzve për sa i përket besimit ndërpersonal, tolerancës dhe ndjeshmërisë publike, rezultatet nuk janë inkurajuese. Ky ndikim është tepër i ulët. Në veçanti rezultati është shqetësues për sa i përket besimit ndërpersonal, që duket të jetë tepër i ulët edhe në mes të vet anëtarëve të OSHC-ve. Besimi në njerëzit përreth nesh është një kusht për iniciativat e përbashkëta, dhe këto rezultate nuk janë fare premtuese.

Në fund, niveli i besimit që qytetarët e kanë në shoqërinë civile dallon, varësisht nga disa kategori të OSHC-ve. Organizatat humanitare ose bamirëse gëzojnë nivelin më të lartë të besimit midis publikut të gjërë, pasuar nga organizatat rinore, ato të artit, muzikore dhe arsimore dhe organizatat që merren me të drejtat e njeriut, duke sugjeruar mundësinë për mobilizimin e qytetarëve në organizata të tilla.

## 5. AMBIENTI I JASHTËM

Gjatë vlerësimit të gjendjes së shoqërisë civile është vendimtare të merret parasysh ambienti i jashtëm në të cilin shoqëria civile ekziston dhe zhvillohet. Disa tipare të këtij ambienti mund të mundësojnë zhvillimin e shoqërisë civile, ndërsa të tjerat pengojnë zhvillimin e sektorit.

Ambienti social, politik dhe ekonomik në të cilin shoqëria civile e Kosovës operon është në fokus të këtij dimensionit. Tre nën-dimensione specifike që i adresojnë këto çështje nxirren kryesisht nga studimet dhe raportet tjera, përveç gjetjeve të ISHC-së. Konteksti socio-ekonomik dhe socio-politik në mbarë botën janë fokus i raporteve të rregullta të lëshuara nga organizatat e tilla si Social Éatch, Transparency International, Banka Botërore dhe Freedom House, dhe ISHC-ja nxjerrë shumë nga indikatorët e mëposhtëm nga këto rezultate. Mirëpo, pasi që Kosova ende nuk është e përfshirë në shumë hulumtime dhe raporte ndërkombëtare, të dhënat e nën-dimensionit të parë për kontekstin socio-ekonomik nuk janë në dispozicion, dhe prandaj nuk përfshihen në të dhënat sasiore që formojnë Diamantin e ISHC-së.

Me matjen e dy nën-dimensioneve, rezultati i përgjithshëm i Ambientit të Jashtëm është me një përqindje prej 51.3.

Tabela 6: Ambienti i Jashtëm – Rezultatet e nën-dimensioneve

| 5   | Ambienti i Jashtëm       | 51.3 |
|-----|--------------------------|------|
| 5.1 | Konteksti socio-ekonomik | -    |
| 5.2 | Konteksti socio-politik  | 46.6 |
| 5.3 | Konteksti socio-kulturor | 56.1 |

### 5.1. Konteksti socio-ekonomik

Edhe pse ISHC-ja nuk posedon të dhëna konkrete për këtë nën-dimension, një numër i kufizuar i të dhënave në dispozicion nga burimet tjera mund të përdoren për të përshkruar gjendjen e përgjithshme socio-ekonomike të Kosovës.

Kosova ka një popullësi prej diku rreth 2 milion banorësh dhe është një nga vendet më të varfëra në Evropë. Sipas Bankës Botërore, me një bruto produkt vendor (BPV) për kokë banori prej €1,760, varfëria mbetet e qëndrueshme dhe e gjerësisht e përhapur. 45% e popullsisë vlerësohet të jetojë nën nivelin kombëtar të varfërisë, ndërsa 17% jetojnë në varfëri të skajshëme, sipas të dhënave të fundit në dispozicion nga viti 2006. Me një shkallë të papunësisë prej 48% dhe një shkallë shumë të ulët të punësimit (26%), Kosova rezultatet më të dobëta të punësimit në Evropë. Mirëpo, ekonomia e Kosovës karakterizohet me një sektor të gjerë jo formal, që nënkupton punësim pak më të lartë sesa shënimet zyrtare. Sidoqoftë, papunësia është shumë e lartë sipas standardeve regjionale. Për më tepër, ekonomia mbetet e varur nga dërgesat nga diaspora dhe ndihmat e donatorëve.

Ekonomia e Kosovës është dëmtuar gjatë një dekade të regjimit okupues në vitet e 90-ta, dhe ka vuajtur nga pasiguritë e pas luftës, lidhjet e shkëputura tregtare dhe investime të pamjaftueshme në infrastrukturë. Pas një periudhe emergjence dhe rindërtimi të udhëhequr nga ndihma e donatorëve ndërkombëtarë, rritja ekonomike ishte në shifra dyshifrore në vitet e para të mileniumit të ri. Mirëpo, për shkak të një deficiti jashtëzakonisht të lartë tregëtar dhe mungesës së investimeve direkte të huaja (IDH), qëndrueshmëria e ekonomisë kosovare mbetet një problem. Ekonomia bazohet në sektorin e shërbimeve (68%), ndërsa fushat tjera janë industria (20%), prodhimi (16%) dhe bujqësia (12%). Edhe pse kriza globale financiare dhe ekonomike ka pasur ndikim relativisht të vogël në ekonominë e saj për shkak të integritetit të kufizuar ndërkombëtar të Kosovës, efektet e saj negative janë transmetuar kryesisht përmes rënies së dërgesave nga diaspora, eksporteve dhe nga IDH-së.

Përveç kësaj, korrupsioni mbetet shumë i përhapur dhe konsiderohet një nga problemet më të rëndësishme të vendit. Në Indeksin e Perceptimeve të Korrupsionit të Transparency International, Kosova renditet e 110-ta, e vlerësuar si një nga vendet më të korruptuara në Europë.

Të gjitha nga faktet e lartpërmendura nuk përfaqësojnë një ambient inkurajues ekonomik për zhvillimin e shoqërisë civile. Në kohën kur kërkohet një zvogëlim i varësisë nga donacionet e huaja për sektorin, ne jemi të vetëdijshëm për burimet shumë të kufizuara vendore. Nuk është vetëm buxheti shtetëror, por edhe sektori privat dhe të hyrat familjare që kanë probleme financiare të mbijetesës. Këtu qëndron edhe sfida e shoqërisë civile ndërsa tenton ta gjejë hapësirën e saj në mobilizimin e burimeve që do ta sigurojnë qëndrueshmërinë e saj.

## 5.2. Konteksti socio-politik

Ky nën-dimension, duke vlerësuar kontekstin socio-politik në të cilin shoqëria civile operon, trajton të drejtat dhe liritë politike, sundimin e ligjit dhe liritë personale, të drejtat e shoqatave dhe organizatave dhe kornizën ligjore. Rezultati i nxjerrë nga të dhënat prej burimeve të ndryshme ka përqindjen 46.6%.

Tabela 7: Rezultatet e indikatorëve të kontekstit socio-politik

| Konteksti socio-politik                   | 46.6 |
|---|------|
| Të drejtat dhe liritë politike            | 27.5 |
| Sundimi i ligjit dhe liritë personale     | 35.4 |
| Të drejtat e organizimit dhe pjesëmarrjes | 50.0 |
| Përvoja nga korniza ligjore               | 77.3 |
| Efektiviteti i shteti                     | 43.0 |


Të drejtat dhe liritë politike, sipas Indeksit të të Drejtave Politike të Freedom House, kanë një përqindje prej 27.5%, që do të thotë se Kosova është e kategorizuar si një vend pjesërisht i lirë. Sipas këtij indeksi, Kosova ende nuk është një demokraci elektorale. Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (PCN) ende mban autoritetin për shqfyzimin e legjislacionit dhe vendimeve që konsiderohen në kundërshtim me Planin e Ahtisaarit. Përveç kësaj, zgjedhjet e fundit kombëtare të vitit 2010 në masë të madhe janë akuzuar si të padrejta dhe kanë rezultuar me probleme serioze të legjitimitetit me të cilat janë përballur institucionet kryesore dhe përkrahjes nga akterët e ndryshëm të spektrit shoqëror dhe politik. Këto zgjedhje të jashtëzakonshme kanë pasuar një periudhë të krizës politike dhe institucionale në të cilën ka hyrë Kosova pas dorëheqjes së Presidentit dhe Qeverisë si dhe pas shpërbërjes së Parlamentit.

Sundimi i ligjit dhe liritë personale, të bazuara në Indeksin e Freedom House për Liritë Civile, kanë një përqindje prej 35.4%. Kushtetuta e vitit 2008, e miratuar pas shpalljes së pavarësisë, mbron lirinë e shprehjes dhe shtypit, me përjashtim të fjalimeve që provokojnë armiqësi etnike. Edhe pse një varg i gjerë i mediave të shtypit dhe ato elektronike operojnë në Kosovë, gazetaria hulumtuese është e rrallë për shkak të frikës së ndëshkimit. Kushtetuta gjithashtu thërret për një gjyqësor të pavarur, por gjykatat e të gjitha niveleve i nënshtrohen ndikimit politik, kërcënimeve, dhe korrupsionit. Për shembull, një raport nga shtatori i vitit 2009 nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) ka shprehur alarmim për numrin e madh të rasteve të vjetruara dhe buxhetit dhe stafit të pamjaftueshëm. Zbatimi i vendimeve të gjykatave është i dobët. Sipas raportit të njëjtë, në komunën e Ferizajt, për shembull, nga 6,050 raste të proceduara në vitin 2008, vendimet për to janë zbatuar në më pak se 10 % të rasteve. Që nga viti 2009, Misioni i Bashkimit Europian për Sundimin e Ligjit (EULEX) është vendosur në Kosovë, për t'i asistuar dhe mbështetur autoritetet kosovare në fushën e sundimit të ligjit, në mënyrë specifike në shtyllat e policisë, gjyqësorit dhe doganave. Fillimisht i parë si një kontribues për përmirësimin e këtij sektori, në praktikë EULEX-i kryesisht merret me rastet e nivelit

të lartë të korrupsionit dhe krimeve të luftës, dhe deri më tani nuk i ka përmbushur në tërësi pritjet e qytetarëve.

Indikatori i të drejtave të shoqatave dhe organizatave, sipas Indeksit Freedom House për të Drejtat Civile, rezulton në 50%. Liria e shoqatave garantohej me kushtetutë, dhe Ligji mbi Lirinë e Asociimit në OJQ është miratuar në shkurt të vitit 2009. Sikurse u diskutua më herët, procesi i amendamentimit të këtij ligji, i inicuar nga qeveria në vitin 2010, rrezikonte parimet themelore të qeverisjes së sektorit jo për përfitim, por një reagim i përbashkët i shoqërisë civile ka qenë i suksesshëm në ndërprerjen e kësaj qasjeje. Liria e tubimit nganjëherë është kufizuar për arsye sigurie, në veçanti për shkak të ndarjeve ndëretnike në pjesën veriore të Kosovës, kurse Kushtetuta e vitit 2008 përfshinë mbrojtjen e rendit publik dhe sigurinë kombëtare.

Sa i përket përvojës së kornizës ligjore mbi shoqërinë civile, situata duket më pozitive, ku indikatori rezulton në 77.3%. Kur janë pyetur për rregulloret dhe ligjet kosovare për shoqërinë civile në Hulumtimin e Organizatave, 68.7% e OSHC-ve të hulumtuara i shohin ato si mesatarisht të



favorshme, ndërsa 19.2% si mjaft të kufizuara. Ligji themelor mbi OJQ-të mundëson një procedurë të shpejtë dhe të lehtë të regjistrimit dhe siguron parimet kryesore për themelimin, operimin dhe shuarjen e OJQ-ve.

Figura 13: Rregulloret dhe ligjet kosovare për shoqëri civile besoni që janë...

Megjithatë, njësi qeveritare që është përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji – në të njëjtën kohë njësi e vetme qendrore qeveritare që merret me OJQ-të – duket të ketë kapacitet dhe kompetenca të kufizuara për të siguruar zbatimin e tij të plotë në praktikë. Edhe pse me emrin Departamenti për Regjistrim dhe Ndërlidhje me OJQ, një rast studimi i ISHC-së tregon se marrëdhëniet në mes të këtij departamenti dhe vetë OJQ-ve mbetet e pamjaftueshme në aspektin e bashkëpunimit. 34.3% e OSHC-ve të hulumtuara nuk kanë fare kontakt me këtë njësi, dhe 81.8% e OSHC-ve që janë në kontakt me Departamentin për OJQ raportojnë se ky kontakt është vetëm për arsye zyrtare, siç është për shembull regjistrimi dhe raportimi.




Figura 14: Kontaktet e OSHC-ve me Departamentin për Regjistrim dhe Ndërlidhje me OJQ

Situata është më e keqe për sa i përket kornizës plotësuese ligjore për shoqërinë civile. Organizatat për përfitim publik kanë përfitime shumë të kufizuara; ekzistojnë vetëm disa lirime nga tatimet për donatorët potencial, ndërsa proceset e dialogut shoqëror ende nuk janë të formalizuara. Shoqëria civile e konsideron veten të lirë të angazhohet për ta kritikuar qeverinë, ku vetëm 18.2% të OSHC-ve të hulumtuara në Hulumtimin e Organizatave raportojnë kufizimet jo legjitime ose sulme nga qeveria lokale ose qendore. Mirëpo, një fushatë intensive e kohëve të fundit nga mediat e afërta me qeverinë ku u sulmua një iniciativë e shoqërisë civile dhe individë të caktuar që kritikonin qeverinë tregon se sa të brishta janë marrëdhëniet në mes të këtyre dy sektoreve.

Lidhur me kontekstin e përgjithshëm socio-politik, Punëtorja Kombëtare mendon se rezultati prej 46.6% është shumë i lartë. Është një perceptim i përgjithshëm – gjithashtu i komentuar në forume të ndryshme të ISHC-së – se proceset nëpër të cilat Kosova ka kaluar në vitet e fundit e kanë dëmtoar kulturën e kritikës dhe pjesëmarrjes në vendim-marrje, mbi bazën se çdo reagim do ta dëmtojë procesin e shtet ndërtimit dhe njohjen ndërkombëtare. Pranitë ndërkombëtare dhe donatorët nuk i kanë mbështetur organizatat të cilat i kanë zbatuar qasjet jo konvencionale ndaj proceseve. Mbi të gjitha, shoqëria civile ka bërë vet-cenzurë nga frika e humbjes së fondeve. Disa pjesëmarrës të grupeve të fokusit mendojnë se OSHC-të shpesh nuk përfaqësojnë interesat e komunitetit sepse krijimi fillestar i sektorit pas luftës së vitit 1999 ka qenë një produkt i donatorëve e jo një iniciativë origjinale që ka buruar nga vet qytetarët.

### 5.3. Konteksti socio-kulturor

Ky nën-dimension hulumton kontekstin socio-kulturor në të cilin shoqëria civile e Kosovës operon. Rezultati prej 56.1% është një rezultat i tre indikatorëve specifik që vlerësojnë besimin ndërpersonal, tolerancën dhe ndjeshmërinë publike.

Me vetëm 9.1%, niveli i besimit ndërpersonal midis qytetarëve të Kosovës është gjetja më shqetësuese e tërë ISHC-së. Edhe pse konsiderohet nga disa pjesëmarrës të Punëtorisë Kombëtare si paksa i ulët, ky nivel tepër i ulët i besimit midis njerëzve mund të jetë një nga arsyet për vështirësitë në fillimin dhe/ose mbajtjen e veprimeve të përbashkëta, në mes të qytetarëve por edhe OSHC-ve. Një nga arsyet potenciale të përmendura për këtë ka të bëjë me dallimin në mes të pritjeve dhe realitetit gjatë dekadës së fundit, ku njerëzit kanë përjetuar zhgënjime si pasojë e stagnimit të përgjithshëm ekonomik dhe politik të viteve të fundit. Megjithatë, diskutimet e shumta nuk kanë arritur të gjejnë ndonjë arsye tjetër konkrete që do të shpjegonte këtë rezultat.

Hulumtimi se sa tolerantë janë qytetarët ndaj njerëzve që u takojnë grupeve të ndryshme nga ta ka dhënë një indikator mbi tolerancën me përqindje 62.6%. Me një popullsi me shumicë shqiptare – e njohur për tolerancën fetare – qytetarët kosovarë kanë nivelet më të larta të tolerancës për njerëzit e feve të ndryshme, me vetëm 18.2 % të qytetarëve që nuk dëshirojnë t'i kenë fqinjë njerëzit e feve të ndryshme. Megjithatë, shoqëria kosovare nuk është aspak tolerante ndaj personave të varur nga droga (83.1%), homoseksualëve (69.4%), alkoolistëve të rëndë (68.4%), dhe njerëzve me HIV/AIDS (65.2%). Vetëm një dekadë pas luftës dhe me problemet e vazhdueshme politike që nga atëherë, shqiptarët dhe serbët e Kosovës ende kanë distanca të dukshme nga njëri tjetri. Shqiptarët nuk do të donin t'i kenë serbët fqinjë në 46.3% të rasteve, ndërsa 53.3% e serbëve kanë të njëjtat ndjenja për shqiptarët. Kur flitet për marrëdhëniet në mes grupeve etnike, është e rëndësishme të përmendet se pakica rome vendoset në listën pozitive të grupeve të pranueshme, me vetëm 23.4% të qytetarëve që nuk do të donin t'i kenë ata fqinjë.




Figura 15: Grupet me distancë sociale në popullësinë e Kosovës – nuk do të dëshironim ti kenë fqinjë

Krejtësisht e kundërt nga nivelet e ulëta të besimit ndërpersonal, ndjeshmëria publike është raportuar në nivele shumë të larta, me një rezultat prej 96.5%. Kur është bërë pyetja nëse disa veprime gjithmonë mund të arsyetohen ose kurrë nuk mund të arsyetohen, veprimi më së paku i arsyetuar ka qenë vetëvraska, për të cilën 97% të respondentëve mendojnë se kurrë nuk është e arsyeshme, pasuar me prostitucionin (96%) dhe mashtrimin në tatime (95%). Në anën tjetër 64% e respondentëve kanë menduar se shkurorëzimi kurrë nuk arsyetohet. Nëse lihen mënjanë çështjet kulturore siç janë vetëvraska, prostitucioni dhe shkurorëzimi, rezultatet për veprimet që mund të cilësohen politike kanë dalur ngjashëm si veprime që nuk mund të arsyetohen asnjëherë: mashtrimi në tatime (94.9% të qytetarëve kanë deklaruar se asnjëherë nuk mund të arsyetohet), pranimi i mitos (94.1%), dhe shmangia e pagesës për transport publik (91.6 %).

Tabela 8: Përqindja e qytetarëve që mendojnë që veprime të caktuara kurrë nuk mund të arsyetohen

| Kurrë nuk mund të arsyetohen            | Total |
|---|-------|
| Shmangia e pagesës për transport publik | 92%   |
| Mashtrimi në tatime                     | 95%   |
| Pranimi i mitos gjatë detyrës           | 94%   |
| Homoseksualiteti                        | 92%   |
| Prostitucioni                           | 96%   |
| Aborti                                  | 81%   |
| Divorci                                 | 64%   |
| Eutanasia                               | 86%   |
| Vetvraska                               | 97%   |
| Burri ta rrah gruan                     | 92%   |



KK, Grupet e Fokusit dhe pjesëmarrësit e Punëtorisë Kombëtare në mënyrë unanime e kanë konsideruar këtë vlerë si tepër të lartë, në veçanti lidhur me veprimet politike. Disa nga mospërputhjet e vërejtura përfshijnë krahasimin në mes të 97.6% të respondentëve që deklarojnë se mashtrimi në tatime kurrë nuk është i arsyeshëm ndërsa ekonomia jo formale në Kosovë, duke nënkuptuar evazionin fiskal, është një nga më të lartat në Europë. Ngjashëm me këtë, derisa Kosova renditet si një nga vendet më të korruptuara në botë, 94.7% e respondentëve kanë deklaruar se kurrë nuk është e arsyeshme që ndokush të pranojë mito gjatë ushtrimit të detyrës. Këto paradokse në mes të fakteve reale dhe përgjigjeve nga qytetarët mund të shpjegohen duke parë tendencën aktuale që qytetarët e Kosovës t'i përgjigjen anketuesve në mënyrën që ata mendojnë se intervistuesi dëshiron ta dëgjojë, e jo sipas mendimit të tyre real lidhur me një çështje të caktuar. Kjo posaçërisht vërehet kur shtrohen pyetjet lidhur me ndonjë çështje morale dhe etike.

#### 5.4. Përfundimet

Në përgjithësi, grupet e fokusit, KK dhe pjesëmarrësit e Punëtorisë Kombëtare kanë vërtetuar gjetjet dhe rezultatet e këtij dimension. Mirëpo, krahasuar me dimensionet tjera, rezultati i përgjithshëm për Ambientin e Jashtëm është konsideruar paksa më i lartë, për shkak të nivelit të befasisë me gjetjet nga hulumtimi lidhur me ndjeshmërinë publike dhe disa pikëpamje se duhet të ketë rezultate më të ulëta për kontekstin politik.

Edhe pse nuk posedohet me indikatorët zyrtar për vlerësimin e kontekstit socio-ekonomik, të dhënat themelore në dispozicion për Kosovë paraqesin situatën reale ekonomike të vendit. Duke qenë një nga vendet më të varfëra në Europë, gati gjysma e popullsisë vlerësohet të jetojë nën nivelin kombëtar të varfërisë, dhe prapë gjysma e popullsisë është e papunë. Edhe pse ekonomia e Kosovës karakterizohet me një sektor shumë të gjerë jo formal, ajo ende mbetet shumë e varur nga dërgesat nga diaspora dhe ndihmat e donatorëve. E renditur si një nga vendet më të korruptuara në Europë, ekonomia e Kosovës nuk përfaqëson një ambient inkurajues për veprimin e shoqërisë civile.

Ngjashëm me këtë, konteksti socio-politik ofron hapësirë të kufizuar për zhvillimin e shoqërisë civile. Derisa ekzistojnë shumë standarde ekonomike në letër, zbatimi real i të drejtave dhe lirive politike dhe sundimi i ligjit mbetin jo të kënaqshme. Periudhat e zgjatura të jo qëndrueshmërisë politike dhe një sistem shumë problematik gjyqësor – përkundër ndihmës direkte të Bashkimit Europian për këtë sektor – e pozicionojnë Kosovën si një vend pjesërisht të lirë. Një situatë më pozitive ka të bëjë me të drejtat e shoqatave dhe organizatave dhe përvojën e kornizës ligjore mbi shoqërinë civile. Me standardet themelore për regjistrimin dhe operimin e OJQ-ve, ambienti i favorshëm për shoqërinë civile ende ka nevojë për reforma substanciale ligjore dhe politike. Proceset e përgjithshme nëpër të cilat Kosova ka kaluar viteve të fundit si dhe prania ndërkombëtare dhe qasja e donatorëve kanë dëmtuar kulturën e kritikës në Kosovë.

Në fund, konteksti socio-kulturor qëndron më lartë në rezultatin e tij të përgjithshëm, por me vlera të skajshme brenda tij. Derisa niveli tepër i ulët i besimit ndërpersonal midis qytetarëve kosovar është gjetja më shqetësuese e ISHC-së, nivelet e larta të ndjeshmërisë publike paraqesin shoqërinë kosovare si një shoqëri model nga aspekti etik. Ndërsa rezultati i fundit konsiderohet si i dyshimtë për shkak të tendencës së respondentëve të japin përgjigje moralisht të pranueshme, nivelet e ulëta të besimit ndërpersonal mund të jenë një nga arsytet për vështirësitë në inicimin dhe/ose mbajtjen e veprimeve të përbashkëta, në mes të qytetarëve si dhe OSHC-ve. Toleranca qëndron diku në mes, duke e paraqitur shoqërinë kosovare si mesatarisht tolerante, në veçanti ndaj grupeve të ndryshme fetare dhe etnike, përveç në mes të shqiptarëve etnik dhe serbëve etnik. Disa çështje tabu, siç është homoseksualiteti dhe HIV/AIDS konfirmohen të jenë ende shumë të papranueshme për pjesën më të madhe të shoqërisë.

## PËRPARËSITË DHE DOBËSITË E SHOQËRISË CIVILE

Grupet e fokusit regjionale dhe tematike kanë diskutuar dhe kanë dalur me një numër të përparësive dhe dobësive të sektorit të shoqërisë civile në Kosovë, bazuar në gjetjet e ISHC-së si dhe përvojës së drejtpërdrejtë të pjesëmarrësve. Përveç kësaj, përparësitë dhe dobësitë e identifikuara gjatë takimeve të grupeve të fokusit më tej janë diskutuar dhe validuar në takimet e KK dhe Punëtorisë Kombëtare. Ndërsa jemi të vetdijshëm se sektori ka përparësi të rëndësishme mbi të cilat veprimet e ardhshme mund të ndërtohen, kjo pjesë e diskutimit ka qenë më tepër e përqëndruar në dobësitë që duhet të adresohen. Për këtë arsye pjesa në vijim përmban më tepër dobësi sesa përparësi.

Ndërsa fillimisht është diskutuar sipas dimensioneve specifike të ISHC-së, kjo pjesë tenton të paraqesë një hyrje të shkurtër të përparësive dhe dobësive kryesore të shoqërisë civile kosovare në përgjithësi. Diskutimet, ashtu siç pasqyrohen në listën e mëposhtme, janë përqëndruar kryesisht në angazhimin e ulët qytetar, mungesën e zbatimit të duhur të parimeve të qeverisjes së mirë, nivelit të ulët të ndikimit të iniciativave të shoqërisë civile dhe problemet kryesore të ambientit të jashtëm që ndikojnë në rezultatet që burojnë nga iniciativat qytetare.

### 1. PËRPARËSITË

Edhe pse kjo përparësi është duke rënë në mënyrë konstante, shoqëria kosovare ende ka një nivel të lartë të solidaritetit midis njerëzve, në veçanti për sa i përket nevojave themelore siç është ushqimi, strehimi dhe shëndeti;

Si një vend dhe komunitet i vogël, njerëzit njohin njëri tjetrin dhe idealisht kjo do të mund të ishte një bazë për vendosjen dhe përmirësimin e komunikimit dhe rrjeteve;

Si një vend i vogël, informatat direkte janë në dispozicion në shumicën e rasteve, dhe kështu nevojat e komunitetit mund të identifikohen lehtë;

Ekzistimi i standardeve të qeverisjes së mirë në letër mund të shërbejë si një bazë për përmirësimin e nivelit të tyre të zbatimit në praktikë, duke përmirësuar drejtpërdrejtë nivelin e organizimit të shoqërisë civile;

Prania e madhe ndërkombëtare në Kosovë në shumë raste iu ka dhënë OSHC-ve kosovare informata burimore lidhur me një numër të parimeve të qeverisjes së mirë dhe aftësive të menaxhimit. Krahasuar me vendet tjera, ku prania ndërkombëtare është e kufizuar, kosovarët u janë ekspozuar praktikave dhe sistemeve të ndryshme të menaxhimit;

Një numër i OSHC-ve, në veçanti në nivel kombëtar, kanë arritur një nivel solid të profilizimit të organizatave të tyre në fusha specifike të punës. Përveç kësaj, këto përbëjnë shumicën e OSHC-ve që kanë arritur një nivel solid të qëndrueshmërisë, si në burimet njerëzore ashtu edhe ato financiare. Këta shembuj mund të përdoren si nxitje për OSHC-të tjera që ta ndjekin një rrugë të ngjashme të zhvillimit;

Kryesisht në nivel komunal, pjesëmarrja e komunitetit/bashkë-financimi i projekteve të ndryshme komunale konsiderohet një shembull i shkëlqyer i përpjekjeve të përbashkëta të akterëve shtetëror dhe qytetarëve për përmirësimin e kushteve jetësore në komunitetet e tyre;

OSHC-të me sukses kanë arritur të krijojnë koalicione ad hoc që kanë synuar çështjet e interesit të përbashkët, por vetëm në rastet kur janë pajtuar për ta bërë ndarjen e qartë të përgjegjësisë dhe për të avokuar bashkërisht për zgjidhje;

Shoqëria civile në Kosovë është e vetëdijshme për vlerat që duhet të respektohen dhe promovohen, dhe ka arritur një sukses domethënës në këtë aspekt. Kjo është një bazë e mirë për shpërndarjen e mëtejme të vlerave pozitive për pjesën tjetër të shoqërisë;

OSHC-të kanë qenë në ballë të ideve dhe vlerave zhvillimore avantgarde, duke e pozicionuar veten si iniciator dhe përkrahës të ideve cilësore;

Shoqëria civile ka një depërtim më të madh sesa aparati shtetëror tek komunitetet e ndryshme, në veçanti te grupet e margjinalizuara;

Prania ndërkombëtare në Kosovë në shumë raste mund të shfrytëzohet si një mjet shtesë i presionit ndaj autoriteteve publike për avokimin e çështjeve të ndryshme të demokracisë, të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit;

Kushtetuta e Kosovës garanton standarde të avancuara për pjesëmarrjen e qytetarëve, lirinë e tubimit dhe lirinë e fjalës. Së bashku me Ligjin mbi Lirinë e Asociimit në OJQ, ajo mund të shërbejë si një bazë e shkëlqyeshme për avancimin e mëtejme të kornizës ligjore në këto fusha;

Ligji mbi Vetë-Qeverisjen Lokale ofron dispozita të avancuara ligjore mbi pjesëmarrjen e qytetarëve dhe demokracinë direkte. Edhe pse vetëm në letër, sikurse është rasti edhe me shumë ligje tjera, ai mund t'i shërbejë shoqërisë civile dhe qytetarëve si një bazë e avokimit për të siguruar mekanizmat dhe mjetet konkrete të zbatimit.

## 2. DOBËSITË

Mungesa e besimit në suksesin e iniciativave qytetare shkakton mungesën e iniciativave në komunitet dhe perceptimin se trajtimi i 'çështjeve të vogla' nuk e arsyeton energjinë dhe burimet që duhet të shpenzohen;

Mungesa e informatave rreth mundësive për të bërë ndryshime, në veçanti në nivelin bazë dhe në komunitetet e margjinalizuara;

Mungesa e kulturës kolektive në shkolla dhe familje, ku angazhimi në iniciativa që synojnë ndryshime në shoqëri rrallë promovohet dhe përkrahet;

Sistemi arsimor, posaçërisht arsimi publik, nuk ofron hapësirë dhe informata të mjaftueshme për mendim kritik, hulumtim dhe iniciativa qytetare;

Edhe pse relativisht të avancuara nga aspekti i kornizës ligjore, autoriteteve publike u mungon vullneti politik për të zbatuar obligimet formale për pjesëmarrjen e qytetarëve;

Konteksti i vështirë socio-ekonomik parandalon ndërmarrjen e iniciativave qytetare;

Angazhimi qytetar, dhe në veçanti iniciativat e shoqërisë civile, shpesh keqkuptohen, shumë qytetarë e perceptojnë shoqërinë civile si një burim të përfitimeve financiare dhe nuk e lidhin atë me problemet dhe zgjidhjet konkrete për komunitet;

OSHC-të përballen me probleme serioze në caktimin e prioriteeve rreth çështjeve që duhet të adresohen. Nevojat më aktuale të shoqërisë nuk janë duke u përmbushur nga reagimi përkatës i shoqërisë civile;

Shoqëria civile nuk ka arritur të ndikojë shoqërinë dhe institucionet në krijimin dhe promovimin e një vizioni për zhvillimin e Kosovës. Ajo kryesisht reagon ndaj çështjeve politike dhe shoqërore që dalin aty për aty;

Përkundër avancimit krahasuar me sektorët tjerë, angazhimi qytetar i grave ende është duke vuajtur nga pasojat e shoqërisë tradicionale patriarkale;

Shumë OSHC nuk kanë rregullore të brendshme të shkruara, dhe ato që i kanë, nuk izbatojnë në mënyrë të duhur në praktikë;

Shumë OSHC kanë misione që janë të paqarta dhe shumë të përgjithshme, dhe kështu nuk i mundësojnë vetes të krijojnë një profil specifik në fushat e veçanta të punës;

Organet qeverisëse të OSHC-ve, siç janë bordet ose kuvendet, janë kryesisht formale dhe jo funksionale në praktikë. Kjo dëmton qeverisjen e mirë të OSHC-ve, llogaridhënien dhe reagueshmërinë ndaj nevojave të qytetarëve;

Burimet njerëzore në shoqëri civile bazohen në projektet afatshkurtra dhe janë të ndjeshme ndaj problemeve financiare të OSHC-ve. Shkalla e lartë e ndryshimeve në staf, që nënkupton një mungesë të burimeve të qëndrueshme njerëzore, drejtpërdrejtë ndikon në kapacitetet dhe rezultatet e OSHC-ve;

Shoqëria civile kosovare ende në masë të madhe varet nga donatorët e huaj, dhe kështu e zhvendosë fokusin e llogaridhënies nga qytetarët tek donatorët. Përveç kësaj, niveli i ulët i shumëllojshmërisë së donatorëve e bën këtë varshmëri edhe më të madhe;

Shumë OSHC udhëhiqen ose përbëhen nga vetëm një person, duke i bërë disa OSHC 'një personëshe';

Sistemi i dobët i arsimit në Kosovë ka ndikuar në sektorin e shoqërisë civile, ku si pasojë burimet njerëzore nuk kanë kapacitete profesionale në fushat e caktuara të punës;

Një numër i aktivistëve të shoqërisë civile kanë tendencë të tregojnë një nivel të lartë të oportunitetit ekonomik dhe politik. Në këtë aspekt, angazhimi qytetar përmes shoqërisë civile shihet si një punë mirë e paguar ose një trampolinë për një pozitë politike e jo si një kontribut për ndryshime në shoqëri. Kjo gjithashtu ka pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në imazhin publik të individëve që punojnë në sektorin e shoqërisë civile;

Ndërsa kërkojnë llogaridhënie dhe transparencë nga autoritetet publike, vetë OSHC-të janë vetëm në gjysmë të rrugës për zbatimin në praktikë të këtyre vlerave brenda vet sektorit të tyre. Mungesa e transparencës, në veçanti e asaj financiare, është një nga pikat më të dobëta të shoqërisë civile në Kosovë;

Për shkak të operimit në një shoqëri konzervative, disa iniciativa të shoqërisë civile dhe individët që synojnë t'i adresojnë disa çështje tabu njollosen nga ana e shoqërisë;

Koncepti i shoqërisë civile nuk kuptohet nga shumë individë dhe institucione nga sektore të ndryshme. Kjo bëhet edhe më shqetësuese kur kjo vërehet brenda vet shoqërisë civile;

Koncentrimi i pushtetit në 'institucionet politike dhe individë' shumë herë i vendosë iniciativat qytetare në margjinat e vendim-marrjes;

Niveli i ulët i sundimit të ligjit, si një nga problemet kryesore të shoqërisë në përgjithësi, ka një ndikim të drejtpërdrejtë edhe në shoqërinë civile. Ai drejtpërdrejtë dëmton qeverisjen e brendshme dhe ndikimin e shoqërisë civile në shoqëri;

Dominimi i përkrahjes së projekteve afatshkurtëra në krahasim me përkrahjen institucionale afatgjatë e bën qëndrueshmërinë financiare dhe të burimeve njerëzore të OSHC-ve një detyrë shumë të vështirë për tu zbatuar;

Bashkëpunimi brenda shoqërisë civile është i kufizuar në vetëm disa rrjete aktive si dhe disa iniciativa jo formale. Kjo minimizon fuqinë e sektorit për t'i adresuar dhe për të ndikuar në çështjet e rëndësishme të shoqërisë;

Shumë iniciativa të shoqërisë civile, në veçanti ato që i adresojnë çështjet e rëndësishme të interesit të përgjithshëm, kanë tendencë të shihen si politikisht të ndikuara nga partitë politike dhe/ose autoritetet e ndryshme publike;

Paqëndrueshmëria e zgjatur politike gjatë dekadës së fundit drejtpërdrejtë ka ndikuar në shoqërinë civile dhe reagimin e saj ndaj problemeve kryesore të shoqërisë. Parashikimi i shkurtër i zhvillimeve të përgjithshme në Kosovë ka penguar angazhimin afatgjatë të shoqërisë civile në çështje të ndryshme të rëndësishme për qytetarët;

Ndërsa korniza ligjore konsiderohet si relativisht e avancuar, institucionet e Kosovës vazhdimisht kanë bërë ligje dhe politika që nuk kanë qenë në harmoni me kushtet dhe ambientin vendor. Ligjet 'Copy-paste' nga vendet tjera janë një nga arsytet për nivelin shumë të ulët të zbatimit të tyre në praktikë, dhe shoqëria civile nuk ka qenë në gjendje që ta adresojë këtë çështje në mënyrë të mjaftueshme.

## REKOMANDIMET

Indeksi i Shoqërisë Civile në Kosovë, përmes metodologjisë së saj të pjesëmarrjes dhe përfshirjes të më tepër se 150 OSHC-ve dhe të njëjtit numër të individëve të dalluar nga të gjitha sektoret e shoqërisë, ka diskutuar në hollësi gjetjet e studimit dhe ka përpiluar një numër të rekomandimeve konkrete për një agjendë veprimi të shoqërisë civile. Rekomandimet dalin nga diskutimet dhe analizat e ISHC-së, duke qenë të vetdijshëm se për një shoqëri të avancuar civile duhet të kontribuojnë të gjithë akterët e shoqërisë. Në këtë aspekt, disa rekomandime specifike synojnë sektorin e shoqërisë civile dhe iniciativat e tyre të brendshme, ndërsa rekomandimet tjera propozojnë iniciativa konkrete për autoritetet publike, media ose sektorë të biznesit. Mirëpo, pjesa më e madhe e rekomandimeve – nëse synohet në një zbatim të suksesshëm – duhet të qaset në shumë nivele dhe të përfshijë kuptimin, përkushtimin dhe burimet nga të gjitha sektoret e shoqërisë. Derisa kjo qasje gjithëpërfshirëse është kyçe për suksesin e tyre, një qasje e fragmentuar dhe jo e koordinuar do ta rrezikonte gjithë zhvillimin e sektorit të shoqërisë civile në Kosovë.

Në mënyrë specifike, pas hulumtimeve sasiore dhe studimeve cilësore, diskutimeve të ndryshme në grupet e fokusit dhe në Komitetin Këshillues, Punëtorja Kombëtare – që ka mbledhur rreth 60 OSHC nga e tërë Kosova – ka rezultuar në rekomandime konkrete për veprim në të gjitha pesë dimensionet e ISHC-së. Edhe pse të vendosura brenda dimensioneve specifike, një numër i propozimeve mund të jetë ngjashëm të rëndësishme për dimensionet tjera, dhe si rrjedhojë ato janë horizontale për spektrin e shoqërisë civile në Kosovë.

### 1. ANGAZHIMI CIVIL

Duke njohur faktin se qytetarët janë burimi dhe synimi i fundit i shoqërisë civile, pjesëmarrja e tyre aktive në aktivitetet e shoqërisë civile dhe përfitimi i drejtpërdrejtë nga sektori gjithmonë duhet të jetë pika kryesore e të gjithëve që përfshihen në shoqërinë civile dhe përreth saj. Për më tepër, angazhimi civil në mënyrë të qartë varet nga një varg i faktorëve dhe kushteve dhe vetëm një numër i tyre drejtpërdrejtë varet nga shoqëria civile.

Në këtë aspekt, rekomandimet që burojnë nga diskutimet gjithëpërfshirëse mund të klasifikohen në tri kategori:

- 1) Rritjen e nivelit të dijes mbi konceptin e shoqërisë civile dhe rolit të saj në shoqëri – përmes sistemit arsimor formal dhe jo formal dhe iniciativave, shkëmbimit të informatave dhe promovimit të praktikave më të mira dhe mjeteve për ngritjen e vetëdijes që synojnë sektoret/grupet specifike të shoqërisë;
- 2) Rritjen e aftësisë së sektorit për t'iu përgjigjur nevojave të qytetarëve dhe rritjen e pasqyrit të tyre adekuat në aktivitetet e shoqërisë civile – përmes komunikimit të drejtpërdrejtë me përfaqësuesit e saj, mjeteve adekuate të vlerësimit dhe planifikimit, përkrahjes së iniciativave të komunitetit dhe koordinimit dhe planifikimit strategjik më të mirë nga donatorët ndërkombëtarë;
- 3) Krijimin e mjeteve përkrahëse për inkurajimin e pjesëmarrjes civile dhe efektshmërinë e saj – përmes krijimit të mekanizmave koordinues në mes të shoqërisë civile dhe sektorëve tjerë, përmirësimit të kornizës ligjore mbi pjesëmarrjen qytetare dhe përdorimin efektiv të njohurisë dhe burimeve.

## REKOMANDIMET KONKRETE

### Për shoqërinë civile:

Të hartohet dhe avokohet për lëndët në sistemin e arsimit formal që kanë të bëjnë me shoqërinë civile, për të përgatitur një gjeneratë të qytetarëve që janë më të vetëdijshëm nga aspekti shoqëror;

Të rritet promovimi i praktikave më të mira dhe të suksesshme të shoqërisë civile, përfshirë mediat dhe teknikat tjera për ngritjen e vetëdijes, me qëllim të rritjes së besimit të qytetarëve në arritjen e ndryshimeve pozitive përmes aktivizimit qytetar;

Të identifikohen dhe të krijohen mekanizmat e brendshëm të informimit dhe komunikimit me qëllim të identifikimit dhe përgjigjes ndaj nevojave më imediate dhe më me prioritet të qytetarëve;

OSHC-të më të mëdha t'i përkrahin ato më të vogla përmes transferimit të burimeve dhe shkathtësive, për të reaguar ndaj informatave të dorës së parë dhe nevojave që dalin nga niveli bazë;

Të avokohet bashkërisht krijimi i mekanizmit të demokracisë pjesëmarrëse, si dhe të avokohet për hartimin dhe miratimin e kornizës së duhur ligjore mbi punën vullnetare.

### Për autoritetet publike:

Të bashkëpunohet me shoqërinë civile në futjen e lëndëve që ndërlidhen me shoqërinë civile në sistemin e arsimit formal;

Të rishikohen dhe avancohen mekanizmat e demokracisë pjesëmarrëse në nivelet qendrore dhe lokale;

Të fillohet me hartimin e një kornize të duhur ligjore mbi punën vullnetare, në bashkëpunim të ngushtë me shoqërinë civile dhe sektorin privat.

### Për sektorët tjerë:

Mediat duhet ta ngrisin ndikimin e tyre në krijimin e shoqërisë demokratike, duke bashkëpunuar ngushtë me shoqërinë civile dhe akterët tjerë relevantë;

Donatorët duhet të bashkëpunojnë ngushtë me shoqërinë civile dhe grupet e tjera lokale të interesit në caktimin e prioriteteve të tyre strategjike në harmoni me problemet specifike të qytetarëve;

Universitetet dhe nivelet tjera të edukimit duhet ta përdorin shoqërinë civile si një sektor të dobishëm për përvojë të punës praktike të studentëve, që në të njëjtën kohë do t'i ekspozonte ata ndaj iniciativave qytetare dhe sfidave të komunitetit.



## 2. NIVELI I ORGANIZIMIT

Marrë parasysh faktin se pjesa më e madhe e shoqërisë civile përbëhet nga organizatat jo qeveritare të regjistruara ose iniciativave që dalin nga to, korniza ligjore mbi krijimin dhe funksionimin formal të këtyre organizatave krijon një hapësirë solide për të ushtruar lirinë e asociimit dhe tubimit, edhe pse ende ka hapësirë për përmirësime. Mirëpo, mekanizmat që do të siguronin se këto dispozita ligjore janë duke u zbatuar në praktikë kanë mbetur prapa. Bazuar në këtë, shoqëria civile brenda saj si dhe në bashkëpunim me autoritetet publike duhet t'i fuqizojë përpjekjet e saj për krijimin e mjeteve konkrete për rritjen e nivelit të zbatimit të parimeve të qeverisjes së mirë brenda sektorit, gjithmonë duke pasur kujdes për ruajtjen e pavarësisë së sektorit nga presionet e jashtme. Për më tepër, një ambient favorizues për një sektor të qëndrueshëm do të jetë elementi kryesor për zhvillimin afatmesëm dhe afatgjatë të sektorit.

Në këtë aspekt, rekomandimet konkrete në këtë dimension iu adresohen tri sektoreve kryesore, ku secila prej tyre kërkon përkushtim dhe koordinim edhe me grupet e tjera të interesit:

- 1) Shoqëria civile duhet t'i krijojë mekanizmat e brendshëm për të siguruar një qeverisje të mirë dhe llogaridhënie ndaj anëtarëve të saj – përmes krijimit të platformave dhe rrjeteve dhe përmes miratimit të një Kodi të Etikës dhe mekanizmave tjerë që do t'i monitorojnë dhe ndihmojnë OSHC-të në zbatimin praktik të parimeve kryesore të sektorit jo për përfitim;
- 2) Autoritetet publike duhet ta rrisin përkrahjen shtetërore për zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e shoqërisë civile – përmes krijimit të një politike gjithëpërfshirëse qeveritare ndaj shoqërisë civile, përfshirë përgatitjet ligjore, financiare dhe institucionale për përkrahjen e iniciativave qytetare që synojnë ndryshimin pozitiv të shoqërisë;
- 3) Donatorët duhet ta konsiderojnë zhvendosjen e ndihmës së tyre për shoqërinë civile nga përkrahja afatshkurtër e bazuar në projekte në përkrahjen e afatgjatë institucionale – përmes hartimit të prioriteteve të qarta dhe afatgjata strategjike të përkrahjes që kanë për synim një sektor të qëndrueshëm dhe llogaridhënës.

### REKOMANDIMET KONKRETE

#### **Për shoqërinë civile:**

Të ngritet bashkëpunimi në mes të OSHC-ve dhe të hartohen dhe zbatohen aktivitetet e përbashkëta për krijimin e një sistemi të vet-kontrollit të brendshëm dhe të llogaridhënies;

Të hartohet dhe zbatohet Kodi i Etikës mbi shoqërinë civile, që synon sigurimin se parimet e qeverisjes së mirë brenda sektorit janë duke u zbatuar në praktikë;

Të krijohen OSHC-të e specializuara dhe profilizuara në fushat specifike të aktivitetit – përmes misionëve të tyre formale dhe aktiviteteve konkrete – që synojnë avancimin e ekspertizës dhe kompetencave të tyre në fushat e veçanta dhe si të tilla të kenë aftësi për t'iu përgjegjur nevojave të anëtarëve të tyre;

Të rritet funksionaliteti i bordeve/kuvendeve dhe të rritet pjesëmarrja e përfituesve në hartimin dhe zbatimin e aktiviteteve specifike;

Të rritet transparenca e OSHC-ve, në veçanti ajo financiare, ndaj qytetarëve në përgjithësi dhe përfituesve në veçanti.

**Për autoritetet publike:**

Të hartohet një politikë gjithëpërfshirëse për mbështetjen e shoqërisë civile, që synon njohjen e rolit të saj në shoqëri dhe lehtësimin e kontributit të këtij sektori në zhvillimet e përgjithshme shoqërore;

Të krijohen fonde publike për shoqërinë civile dhe të krijohen struktura të pavarura për menaxhimin e tyre, bashkërisht me shoqërinë civile;

Të avancohet sistemi i tatimit për shoqërinë civile, duke e dalluar sektorin nga biznesi privat dhe duke e krijuar një kornizë të ndarë për shoqërinë civile;

Të rritet bashkëpunimi me shoqërinë civile, që synon shfrytëzimin e burimeve dhe ekspertizës së sektorit në bërjen e politikave, dhënien e shërbimeve dhe fushat e tjera të interesit;

Të avancohet korniza ligjore për shoqërinë civile, duke siguruar më tepër llogaridhënie ndaj anëtarëve, por duke mos ndërhyrë në pavarësinë e nevojshme të sektorit;

Të reformohen rregullimet institucionale për bashkëpunim dhe zhvillim të politikave për shoqërinë civile, përmes ndarjes së Departamentit të Regjistrimit dhe krijimit të një njësie qendrore për ndërlidhje me OJQ mirë të pozicionuar dhe me staf profesional.

**Për donatorët:**

Me rastin e dizajnit të ndihmës për shoqërinë civile, të vihet më tepër theks në qëndrueshmërinë e sektorit si një mjet për zhvillimin afatgjatë të shoqërisë në përgjithësi dhe për përmbushjen e prioriteteve të saj.

### 3. NDIKIMI I PERCEPTUAR

Në një ambient kompleks ku shumë akterë formal kanë ndikimin e tyre substancial, shoqëria civile duhet të gjejë mënyra alternative për tu bërë përfaqësuese e nevojave të qytetarëve si dhe për të inicuar dhe avokuar ndryshimet pozitive në shoqëri. Një vështirësi e madhe në këtë aspekt është niveli i ulët i funksionimit të sundimit të ligjit, ndërsa çështjet tjera që duhet të tejkalohen përfshijnë përkrahjen e ulët publike, një imazh të pakonsoliduar publik të sektorit dhe mungesën e mekanizmave funksional për t'i kontribuar shumë proceseve të rëndësishme të shoqërisë.

Rekomandimet konkrete i adresojnë shumicën e këtyre çështjeve, ndërsa pranojnë se sundimi i ligjit është një çështje madhore për shoqërinë në përgjithësi dhe shoqëria civile mund të luaj vetëm një rol të kufizuar në përmirësimin e saj.

## REKOMANDIMET KONKRETE

### Për shoqërinë civile:

Të rriten përpjekjet për ndryshimin e imazhit të dobët publik, si përmes promovimit të rasteve të suksesshme ashtu edhe përmes vendosjes së pritjeve reale përmes iniciativave informuese për rolin e saktë të shoqërisë civile;

Të vendosen nevojat e antarëve të shoqërisë civile në krye të angazhimit të tyre, përmes komunikimit të drejtpërdrejtë me qytetarët dhe presionit të përbashkët ndaj donatorëve për harmonizimin e prioriteteve të tyre me ato të qytetarëve;

Të punohet me qytetarët në iniciativat konkrete për dobinë e komunitetit, duke synuar rritjen e përkrahjes së tyre për sektorin dhe fuqizimin e lidhjeve me anëtarët e saj;

Të themelohen platformat sektorale për të siguruar qëndrueshmëri dhe për të fuqizuar ndikimin në fushat specifike, ndërsa në të njëjtën kohë për të reaguar ndaj çështjeve të reja përmes koalicioneve ad-hoc dhe përpjekjeve të përbashkëta;

Të themelohen platformat përfaqësuese për të lehtësuar kontributin e OSHC-ve të interesuara, ndërsa në të njëjtën kohë të adresohen praktikatat e mundshme të keqpërdorimit që vijnë nga sektori;

Të vazhdohet dhe avancohet mbulimi i iniciativave ‘watch-dog’, ndërsa në të njëjtën kohë të kontribuohet në vendosjen e një sistemi të qeverisjes së mirë në Kosovë.

### Për autoritetet publike:

Të merren parasysh kritikatat dhe të shfrytëzohen rekomandimet nga shoqëria civile, duke kontribuar për një shoqëri të hapur dhe pjesëmarrje më të gjerë nga qytetarët në fushat kryesore të interesit publik;

Të avancohet niveli i informatave dhe konsultimit të institucioneve publike me publikun dhe shoqërinë civile;

Të krijohen mekanizmat konkrete, të qarta dhe funksionale për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në bërjen e politikave publike dhe procesin e ligjvënies në nivel lokal dhe nacional;

Të emërohen personat kontaktues të shoqërisë civile në secilën Ministri dhe Komunë dhe një zyrë ndërlidhëse e shoqërisë civile në Kuvendin e Kosovës, që synon rritjen e komunikimit dhe hapjen e rrugës për iniciativat që dalin nga ky sektor;

Të caktohen standardet për dhënien e shërbimeve publike nga OSHC-tëtë cilat janë më afër përfituesëve dhe do të mund t'i përmbushin standardet e larta.

### Për donatorët:

T’ia përshtasin fushat e përkrahjes dhe kushtet e financimit kontekstit dhe nevojave lokale, duke synuar një përkrahje në kohë të duhur dhe të një niveli adekuat.

## 4. PRAKTIKIMI I VLERAVE

Shumë herë e parë si pararojë e vlerave të ndryshme, shoqëria civile përballet me rrugë sfiduese për ta ruajtur këtë epitet. Derisa sektori është shumë i avancuar në promovimin e tolerancës, paqes dhe luftimin e dhunës, ajo përballet me sfida në fushat që kanë të bëjnë me qeverisjen e mirë brenda sektorit dhe me vendosjen e standardeve të punës dhe atyre mjedisore. Ekzistimi i parimeve të qeverisjes së mirë në letër është një bazë e mirë për zbatimin e tyre në praktikë. Derisa të drejtat e punës në Kosovë nuk janë garantuar për një kohë të gjatë, Ligji mbi Punën i miratuar para një kohe duhet të shfrytëzohet për avancimin e të drejtave në punë brenda sektorit dhe për presionin që duhet të bëhet drejt avancimit të këtyre të drejtave edhe në sferat tjera. Përveç kësaj, marrë parasysh ndjeshmërinë e lartë të BE-së lidhur me çështjet e mjedisit, agjenda Europiane e Kosovës duhet të përdoret si një nxitës për vënien e theksit në mbrojtjen dhe promovimin e ambientit në shoqërinë civile dhe jashtë saj.

### REKOMANDIMET KONKRETE

#### Për shoqërinë civile:

Të hartohet një Kod i Etikës dhe të sigurohen mekanizmat e brendshëm për zbatimin e tij, duke synuar zbatimin në praktikë të parimeve të qeverisjes së mirë;

OSHC-të e zhvilluara duhet t'i ndihmojnë atyre me mungesë stafi në rritjen e kapaciteteve të tyre lidhur me menaxhimin e organizatës, në veçanti menaxhimin financiar;

Të futen Sistemet për Sigurimin e Cilësisë, që synojnë promovimin e shembujve të qeverisjes së mirë si dhe garantimin e pavarësisë së sektorit përmes monitorimit dhe vlerësimit të pavarur të punës;

Të identifikohen dhe denoncohen praktikat e këqija brenda shoqërisë civile, ashtu siç OSHC-të do të bënin për rastet e ngjashme në sektorin publik;

Të rritet transparencja e aktiviteteve dhe burimeve të tyre përmes publikimit të rregullt të raporteve në uebfaqe.

#### Për autoritetet publike:

Të hartohen dispozita të qarta ligjore mbi strukturat dhe sistemet e qeverisjes për OJQ-të, në të njëjtën kohë duke autorizuar akterët jo shtetëror ose njësitë e përbashkëta që të monitorojnë dhe vlerësojnë zbatimin;

Të rritet bashkëpunimi dhe shfrytëzimi i njohurive dhe ekspertizës së shoqërisë civile në promovimin e një grupi të ndryshëm të vlerave në shoqëri, përfshirë adresimin e çështjeve të ndjeshme në shoqëri;

Gjatë përcaktimit të fondeve publike për shoqërinë civile, të konsiderohet krijimi i një 'Fondi të auditimit', që synon përkrahjen e OSHC-ve të vogla për kryerjen e auditimeve të rregullta financiare.

#### Për donatorët:

Të inkurajohet qeverisja e mirë brenda shoqërisë civile, përmes caktimit të standardeve të qarta dhe transparente të financimit, monitorimit dhe vlerësimit, si dhe ngritjes së proporcionit të përkrahjes institucionale të pranuesve të donacioneve;

Të përkrahjet krijimi i një Sistemi të pavarur për Sigurimin e Cilësisë për shoqërinë civile, përmes dhënies së burimeve financiare dhe ndihmës teknike.

## 5. AMBIENTI I JASHTËM

Gjatë adresimit të çështjeve dhe rekomandimeve të shumta për shoqërinë civile dhe ndaj saj, ne jemi të vetëdijshëm për faktin se sektori në një mënyrë është një pasqyrim i ambientit të përgjithshëm në të cilin ai vepron. Shumica e diskutimeve në forume të ndryshme të projektit kanë ngritur këtë çështje dhe janë pajtuar se shoqëria civile nuk është vetëm një prodhuese e kushteve të shoqërisë, por edhe konsumuese e të drejtave, hapësirës dhe vështirësive të saj. Në këtë aspekt, është gjithashtu përgjegjësi e sektorëve tjerë të krijojnë kushtet e favorshme për veprimin e shoqërisë civile, nëse dëshirojmë ta respektojmë konsensusin e deklaruar nga të gjithë për një sistem demokratik të qeverisjes. Rekomandimet konkrete të dala nga të dhënat e mbledhura vlejné për autoritetet publike, misionet ndërkombëtare në Kosovë dhe donatorët si dhe për vetë shoqërinë civile. Të gjitha këto synojné avancimin e ambientit të jashtëm në të cilin shoqëria civile vepron, ashtu që pritjet nga ky sektor ecin paralelisht me kushtet për veprim dhe ndikim.

### REKOMANDIMET KONKRETE

#### Për shoqërinë civile:

Të vendoset një kornizë e vlerësimit të vazhdueshëm të situatës socio-ekonomike dhe politike në Kosovë, përmes sistemeve alternative të mbledhjes, përpunimit, ndarjes dhe përcjelljes së të dhënave dhe informatave relevante;

Të avokohet për ndarjen e qartë të përgjegjësisë midis shtyllave të ndryshme të aparatit shtetëror, duke i ndihmuar secilit në ndërmarrjen e detyrave të veta dhe monitorimin e reagueshmërisë së tyre ndaj mandatit të vet;

Të përqëndrohet më shumë në ‘zhvillimin e sistemit’ sesa reagimin ndaj problemeve ad-hoc, me qëllim të minimizimit të problemeve të shkaktuara nga lëkundjet politike dhe niveli i lartë i paparashikueshmërisë së zhvillimeve politike në vend.

#### Për autoritetet publike:

Të zhvillohet një Strategji Kombëtare e Zhvillimit, ku shoqëria civile do të jetë pjesë aktive e saj, dhe menjëherë të krijohen mekanizmat konkret për zbatimin dhe mbikqyrjen e saj;

Ta përmirësojnë qasjen e përgjithshme ndaj shoqërisë civile, në veçanti përmes rritjes së nivelit të shpërndarjes së informatave dhe konsultimit, si dhe hapjes së rrugëve për monitorim dhe veprime avokuese nga sektori;

Të shtohet energjia, kapacitetet dhe burimet për të mbikqyrur zbatimin e ligjit dhe të përfshihen të gjitha grupet relevante të interesit në këtë proces;

Të përforcohet roli i agjencive/organeve të pavarura dhe të sigurohet pjesëmarrja legjitime e përfaqësuesve të shoqërisë civile në to;

Të miratohen politikat dhe masat për inkurajimin e sektorit privat dhe individëve të interesuar për të marrë pjesë dhe për t'i përkrahur iniciativat qytetare në interes të tyre.

**Për  
Bashkimin  
European:**

Të njihet kapaciteti dhe potenciali brenda shoqërisë civile në Kosovë për tu bërë një partner kyq në zbatimin e reformave që kërkohen nga agjenda Europiane.

Të vazhdohet dialogu civil dhe të kërkohet pjesëmarrje nga shoqëria civile në kuadër të dialogut për Procesin e Stabilizim Asociimit (PSA) dhe instrumenteve tjera të PSA-së.

Të përfshihen përfaqësuesit e shoqërisë civile në procesin e programimit dhe vlerësimit dhe organet monitoruese për IPA (Instrumenti për Ndihmën para Antarësimit).

Të vazhdohet me përkrahjen financiare dhe teknike të shoqërisë civile, për të shtuar më tej kapacitetet e sektorit për t'i kontribuar agjendës Europiane.

**Për sektorët  
tjerë:**

Misionet ndërkombëtare në Kosovë duhet të luajnë një rol aktiv në promovimin e modeleve demokratike nga vendet e tyre dhe asistimin e Kosovës për t'i përmbushur standardet Europiane në demokraci;

Misionet ndërkombëtare në Kosovë duhet të mundësojnë më tepër hapësirë për zërin vendor lidhur me zhvillimet e rëndësishme shoqërore, përfshirë marrjen parasysh të iniciativave dhe shqetësimeve të shoqërisë civile;

Sistemi i edukimit publik duhet ta reformojë sistemin dhe inkurajojë mendimin kritik dhe qytetarinë aktive, në të njëjtën kohë duke inkurajuar studentët që të angazhohen në mënyrë aktive në adresimin e problemeve të komunitetit.

## PËRFUNDIMET

Kombinimi i qasjeve të ndryshme mbi vlerësimin e gjendjes aktuale të shoqërisë civile ka rezultuar me një spektër të gjerë të informatave dhe dije nga dhe për shoqërinë civile. Spektri i gjerë i të dhënave të grumbulluara dhe qasja pjesëmarrëse e ISHC-së i ka pajisur të gjitha grupet e interesit me gjetje të ndryshme lidhur me aspektet kryesore të shoqërisë civile, duke ofruar kështu informata të azhurnuara për atë se ku qëndrojmë dhe cilat janë çështjet kryesore për tu adresuar në të ardhmen.

Edhe pse ndikimi konkret i ISHC-së në shoqërinë civile kosovare mbetet të vlerësohet në të ardhmen, aktivitetet tanimë të përfunduara të këtij projekti kanë ngjallur diskutime shumë interesante midis pjesëmarrësve të grupeve të fokusit regjionale dhe tematike, si dhe të Punëtorisë Kombëtare. Bazuar në fushat e tyre të aktivitetit, organizatat e ndryshme kanë shprehur interes të madh në gjetje të ndryshme të studimit. Një nga çështjet e ngritura në shumicën e diskutimeve ka qenë niveli i ulët i angazhimit qytetar, arsyet prapa saj, dhe veprimet nga shoqëria civile për adresimin e tyre. Diskutimet tjera janë fokusuar në aftësinë e shoqërisë civile për të arritur një ndikim pozitiv në shoqëri përmes rritjes së lidhjes me qytetrët dhe ngritjes së reagueshmërisë së saj ndaj problemeve kryesore të shoqërisë.

Është në duart e lexuesve dhe vendim-marrësve t'i shfrytëzojnë gjetjet e studimit dhe adresojnë rekomandimet konkrete të këtij Raporti Analitik. Vetëm përmes kuptimit të tërë kompleksitetit të punës së shoqërisë civile, grupet relevante të interesit mund të shfrytëzojnë maksimalisht informatat që ofrohen përmes këtij raporti dhe ta përshtatin aktivitetin e tyre drejt avansimit të gjendjes së këtij sektori në Kosovë.

Më poshtë janë vetëm disa nga momentet kryesore të ISHC-së që janë diskutuar në Grupet e Fokusit regjionale dhe tematike, takimeve të Komitetit Këshillues dhe Punëtorisë Kombëtare. Duke i ndarë me palët tjera të interesuara, këto momente kryesore tentojnë të shfaqin aspektet më të rëndësishme të shoqërisë civile në Kosovë dhe bazën për veprimet e ardhshme në këtë fushë.

### 1. ANGAZHIMI CIVIL

Angazhimi Civil, pas Ndikimit të Perceptuar, del të jetë dimension i dytë më i dobët i shoqërisë civile në Kosovë. Anëtarësimi i ulët në iniciativat shoqërore dhe politike, si dhe nivelet e ngjashme të vullnetarizmit në këto dy fusha karakterizojnë shoqërinë kosovare si një shoqëri tepër indiferente me nivel të lartë të mosinteresimit të qytetarëve ndaj jetës publike në përgjithësi. Mirëpo, nivelet e larta të aktivizimit jo formal dhe individual, siç është angazhimi i komunitetit dhe pjesëmarrja në veprime të ndryshme politike individuale, tregojnë se potenciali është i pranishëm, ndërsa i mbetet OSHC-ve dhe të tjerëve ta aktivizojnë këtë potencial. Kjo konfirmon perceptimet e një hendeku midis OSHC-ve dhe qytetarëve, që gjithashtu pasqyrohet në nivelin e besimit ndaj OSHC-ve dhe partive politike të paraqitura në Hulumtimin e Popullsisë. Në fund, mungesa e dallimit në mes të grupeve të ndryshme shoqërore dhe demografike lidhur me aktivizimin e tyre tregon një grup shumë të ndryshëm të qytetarëve aktiv dhe një ekzistencë të ulët të pengesave në mes të grupeve të ndryshme si në angazhimin shoqëror ashtu edhe në atë politik, nëse nuk merret parasysh dallimi ndëretnik. Pasi që fuqia kryesore e shoqërisë civile përqëndrohet në pjesëmarrjen aktive të qytetarëve për avancimin e interesave të përbashkëta dhe krijimin e lidhjeve mes tyre, ky nivel i ulët i angazhimit qytetar është një nga çështjet më të rëndësishme për tu adresuar nga shoqëria civile kosovare.



## 2. NIVELI I ORGANIZIMIT

Niveli i Organizimit ka rezultuar si dimensionimi më i lartë në ISHC, duke treguar se shoqëria civile kosovare karakterizohet me një shkallë solide të institucionalizimit. Shoqëria civile e Kosovës ka një sistem formal të qeverisjes dhe menaxhimit, siç janë bordi i drejtorëve ose kuvendi, edhe pse dallimi në mes të ekzistimit të tyre në letër dhe në praktikë është evident. Një pyetje e ngjashme ka të bëjë edhe me rrjetet. Me vetëm disa rrjete aktive, anëtarësimi i OSHC-ve në këto struktura është më tepër i një natyre formale sesa aktive. Mirëpo, niveli i lartë i komunikimit sektorial dhe disa shembuj të suksesshëm të aktiviteteve të përbashkëta kohëve të fundit, tregojnë për një potencial të madh për bashkëpunim për çështjet e interesit të përbashkët.

Ndërsa burimet teknologjike janë mjaft të larta, situata lidhur me burime financiare duket më e ndërlikuar. Me OSHC-të aktive që kanë arritur një shkallë solide të qëndrueshmërisë financiare, ekziston një perceptim i përgjithshëm se shuma totale e fondeve për shoqërinë civile është në rënie dhe shoqëria civile gradualisht duhet t'i gjejë mënyrat alternative të financimit, për të minimizuar varshmërinë nga donatorët ndërkombëtarë. Ndryshe nga çështjet e lartpërmendura, burimet njerëzore janë ndër pikat më të dobëta të të gjithë sektorit. Përkrahja e bazuar në projekte dhe pamundësia për ngritjen e fondeve institucionale nga burimet alternative i bëjnë OSHC-të të cenueshme ndaj largimit të stafit, dhe si pasojë ato përballen me vështirësi të mëdha në mobilizimin e stafit profesional dhe kompetent.

Përfaqësimi ndërkombëtar është një hapësirë ku shoqëria civile ka arritur një prani më të madhe sesa sektorët tjerë të shoqërisë kosovare. Edhe pse ende ballafaqohet me problemet që vijnë nga njohja e pjesshme e shtetit të pavarur të Kosovës nga komuniteti ndërkombëtar, shoqëria civile ka gjetur mënyra për tu përfaqësuar në platforma dhe forume të ndryshme regjionale dhe Europiane.

## 3. NDIKIMI I PERCEPTUAR

Së pari, zhvillimi ekonomik dhe sundimi i ligjit janë konsideruar nga Komiteti Këshillues si brengat kryesore të shoqërisë kosovare. OSHC-të si dhe akterët e jashtëm e vlerësojnë ndikimin e shoqërisë civile në këto dy çështje si mjaft të ulët, me dallime të vogla në mes të perceptimeve të akterëve të jashtëm dhe vet-perceptimeve të shoqërisë civile, ku grupet e jashtme të interesit mendojnë se ndikimi në zhvillim ekonomik ka qenë më i ulët, ndërsa shoqëria civile mendon të kundërtën. Gjetjet e ISHC-së konfirmojnë se shoqëria civile nuk u përgjigjet mjaftueshëm nevojave reale të shoqërisë dhe anëtarëve të saj.

Një situatë e ngjashme shihet në fushën e politikave. Kur hulumtohet aktiviteti i shoqërisë civile në fushën e politikave dhe ndikimi i saj në politikat publike në Kosovë, rezultatet tregojnë një pajtim në mes të shoqërisë civile dhe akterëve të jashtëm ku ky ndikim vlerësohet i kufizuar. Rastet e studimit tregojnë mungesën e mekanizmave konkret për këtë përfshirje, por gjithashtu tregojnë se dispozitat ligjore tashmë ekzistuese nuk janë shfrytëzuar mjaft as nga shoqëria civile e as nga autoritetet publike. Dallimi në mes të aktivitetit dhe ndikimit në çështjet ekonomike tregon për një mungesë të politikave publike për këtë fushë dhe problemet në zbatimin e tyre, duke paraqitur kështu nevojën për rritjen e përfshirjes së shoqërisë civile në zbatimin dhe mbikqyrjen e politikave/ligjit.

Situata duket më pozitive për sa i përket ndikimit shoqëror, ku shoqëria civile vlerësohet të ketë ndikim pak më të madh si nga vet OSHC-të ashtu edhe akterët e jashtëm, me përkrahjen për të varfërit dhe grupet e marginalizuara, arsimin dhe ndihmën humanitare si fushat shoqërore ku shoqëria civile ka pasur më tepër ndikim. Vet-vlerësimi nga OSHC-të e hulumtuara tregon se sektori si tërësi është i vetëdijshëm se është ende në gjysmë të rrugës drejt përbushjes së pritjeve.

Kur hulumtohet ndikimi i shoqërisë civile në qëndrimet e njerëzve për sa i përket besimit ndërpersonal, tolerancës dhe ndjeshmërisë publike, rezultatet nuk janë inkurajuese. Ky ndikim është tepër i ulët. Në veçanti rezultati është shqetësues sa i përket besimit ndërpersonal, që duket të jetë tepër i ulët edhe në mes të vet anëtarëve të OSHC-ve. Besimi në njerëzit përreth nesh është një kusht për iniciativat e përbashkëta, dhe këto rezultate nuk janë fare premtuese.

Në fund, niveli i besimit që qytetarët e kanë në shoqërinë civile dallon, varësisht nga disa kategori të OSHC-ve. Organizatat humanitare ose bamirëse gëzojnë nivelin më të lartë të besimit midis qytetarëve pasuar me organizatat rinore, ato të artit, muzikore dhe arsimore dhe organizatat që merren me të drejtat e njeriut, duke sugjeruar mundësinë për mobilizimin e qytetarëve në organizatat e tilla.

### 4. PRAKTIKIMI I VLERAVE

Derisa qeverisja me vendim-marrje demokratike fuqimisht theksohet në dokumentet e brendshme të sektorit të shoqërisë civile në Kosovë, në praktikë kjo nuk transmetohet gjithmonë me zbatimin e duhur të këtyre parimeve.

Shoqëria civile në Kosovë nuk është entuziaste për rregulloret e punës, pasi që gjetjet dhe diskutimet e vendosin atë me rezultat më të ulët në kuadër të Praktikimit të Vlerave. Derisa më tepër se gjysma e OSHC-ve deklarojnë t'i kenë rregulloret e shkruara për mundësitë e barabarta dhe pagat e barabarta për gratë, si dhe standardet e punës, vetëm një e treta e tyre bëjnë trajnime për stafin e tyre të ri. Stafi i paguar i OSHC-ve dukshëm nuk ndihet rehat për t'u anëtarësuar në sindikata, pasi që më pak se 10% nga ta janë anëtarë të sindikatave.

Shumica e OSHC-ve thonë se kanë kod të mirësjelljes dhe informata financiare në dispozicion të publikut. Prapë, edhe pse ekzistimi i tyre nuk ka mundur të verifikohet, shumica kanë deklaruar se këto dokumente janë në dispozicion në zyrat e tyre, me një shkallë të ulët të publikimit në uebfaqe.

Komentet e ngjashme janë të vlefshme gjithashtu kur shikohet në standardet mjedisore, ku pak më tepër se gjysma e OSHC-ve kanë standarde mjedisore të shkruara dhe publike. Një trend pozitiv për të gjitha pyetjet mbi politikat dhe rregulloret e shkruara është se shumica e OSHC-ve që kanë deklaruar mos t'i kenë ato, kanë thënë se janë duke menduar për hartimin e rregulloreve të tilla.

Në fund, ISHC-ja konfirmon perceptimin e kahmotshëm se shoqëria civile kosovare është shumë tolerante, paqësore dhe jo e dhunshme. Për më tepër, ajo i promovon këto vlera në shoqëri. Megjithatë, e njëjta nuk qëndron edhe për promovimin e vendim-marrjes demokratike brenda organizatave dhe grupeve të saj. Rezultatet tregojnë se shoqëria civile është ende në gjysmë të rrugës për të arritur këtë, dhe me perceptime të kohë pas kohëshme ose të shpeshta të rasteve të korrupsionit në shoqëri civile, edhe rezultati nuk është befusues.

### 5. AMBIENTI I JASHTËM

Edhe pse nuk posedohet me indikatorë zyrtarë për vlerësimin e kontekstit socio-ekonomik, të dhënat themelore në dispozicion për Kosovë paraqesin situatën reale ekonomike të vendit. Duke qenë si një nga vendet më të varfëra në Europë, gati gjysma e popullsisë vlerësohet që jeton në nivelin kombëtar të varfërisë, dhe njëjtë gjysma e popullsisë është e papunë. Edhe pse ekonomia e Kosovës karakterizohet me një sektor shumë të gjerë jo formal, ajo ende mbetet shumë e varur nga dërgesat nga diaspora dhe ndihmat e donatorëve. E renditur si një nga vendet më të korruptuara në Europë, ekonomia e Kosovës nuk përfaqëson ndonjë ambient inkurajues për veprimin e shoqërisë civile.

Ngjashëm me këtë, konteksti socio-politik ofron hapësirë të kufizuar për zhvillimin e shoqërisë civile. Ndërsa ekzistojnë shumë standarde ekonomike në letër, zbatimi real i të drejtave dhe lirive politike dhe sundimi i ligjit mbesin në nivel jo të kënaqshëm. Periudhat e zgjatura të jo-qëndrueshmërisë politike dhe një sistem shumë problematik gjyqësor – përkundër ndihmës direkte të Bashkimit Europian për këtë sektor – e pozicionojnë Kosovën si një vend pjesërisht të lirë. Një situatë më pozitive ka të bëjë me të drejtat e shoqatave dhe organizatave dhe përvojën e kornizës ligjore mbi shoqërinë civile. Me standardet themelore për regjistrimin dhe operimin e OJQ-ve, ambienti i favorshëm për shoqërinë civile ende ka nevojë për reforma substanciale ligjore dhe politike. Proceset e përgjithshme nëpër të cilat Kosova ka kaluar viteve të fundit si dhe prania ndërkombëtare dhe qasja e donatorëve kanë dëmtuar kulturën e kritikës në Kosovë.

Në fund, konteksti socio-kulturor qëndron më lartë në rezultatin e tij të përgjithshëm, por me vlera të skajshme brenda tij. Derisa niveli tepër i ulët i besimit ndërpersonal midis qytetarëve kosovarë është gjetja më shqetësuese e ISHC-së, nivelet e larta të ndjeshmërisë publike paraqesin shoqërinë kosovare si një shoqëri model nga aspekti etik. Ndërsa rezultati i fundit konsiderohet si i dyshimtë për shkak të tendencës së respondentëve të japin përgjigje moralisht të pranueshme, nivelet e ulëta të besimit ndërpersonal mund të jenë një nga arsyet për vështirësitë në inicimin dhe/ose mbajtjen e veprimeve të përbashkëta, në mes të qytetarëve si dhe OSHC-ve. Toleranca qëndron diku në mes, duke e paraqitur shoqërinë kosovare si mesatarisht tolerante, në veçanti ndaj grupeve të ndryshme fetare dhe etnike, përveç në mes të shqiptarëve dhe serbëve. Disa çështje tabu, siç janë homoseksualiteti dhe HIV/AIDS, konfirmohen të jenë ende shumë të papranueshme për pjesën më të madhe të shoqërisë.

## SHTOJCAT

### SHTOJCA I – LISTA E ANËTARËVE TË KOMITETIT KËSHILLUES

Alban Bokshi (QOHU!)

Aliriza Arenliu (DokuFest)

Anton Berishaj (Universiteti i Prishtinës)

Ariana Qosaj – Mustafa (Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave)

Besim Kajtazi (Qeveria e Kosovës – Zyra e Kryeministrit)

Erolld Belegu (EBC dhe Federata e Basketbollit të Kosovës)

Flaka Surroi (Grupi Koha)

Habit Hajredini (Qeveria e Kosovës – Zyra për Qeverisje të Mirë)

Igballe Rogova (Rrjeti i Grave të Kosovës)

Ilir Deda (Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave)

Iliriana Kaçaniku (Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur)

Luan Shllaku (Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur)

Naxhije Buçinca (Shoqata e Veteranëve të Arsimit)

Petrit Tahiri (Qendra për Arsim e Kosovës)

Raba Gjoshi (Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut)

Ramadan Ilazi (Lëvizja FOL)

Shpend Ahmeti (Instituti GAP)

Valon Murati (Qendra për të Drejtat e Njeriut në Universitetin e Prishtinës)


Venera Hajrullahu (Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile)

Zeqir Veselaj (Qendra Rajonale e Mjedisit – Zyra në Kosovë)

**SHTOJCA II – METODOLOGJIA E HULUMTIMIT TË POPULLSISË**

Hulumtimi i Popullsisë është bërë posaçërisht për ISHC në Kosovë gjatë tetorit 2009. Ky hulumtim është bërë me një mostër përfaqësuese të popullsisë së Kosovës. Respondentët janë përzgjedhur përmes tri nën-mostrave: shqiptarë të Kosovës, serb të Kosovës, dhe minoritetet tjera: boshnjakët, turqit, romët, ashkalinjtë, egjiptasit, goranët, etj. Për qëllime të ndarjes së të dhënave sipas etnisë dhe për rritjen e besimit në rezultatet e hulumtimit për minoritetet, numri i minoriteteve në mostër është rritur. Për këtë arsye, kur janë llogaritur vlerat e përgjithshme për nivel të Kosovës, përqindjet për etnicitete janë peshuar sipas pranisë së tyre në popullsi. Në mënyrë specifike, për të llogaritur shumat e përgjithshme për popullsinë e Kosovës rezultatet për shqiptarët e Kosovës janë shumëzuar me 88%, rezultatet për serbët e Kosovës me 6% dhe rezultatet për të tjerët me 6%, dhe pastaj rezultatet mbledhen.

Intervistat janë bërë drejtpërdrejtë përmes intervistave personale. Analiza statistikore e hulumtimit




është bërë përmes Pakos Statistikore për Shkenca Shoqërore (SPSS).

Hulumtimi i Popullsisë bazohet në intervistimin e 1,296 respondentëve: 834 (64.4%) shqiptarë, 180 (13.9%) serbë, 90 (6.9%) turq, 65 (5%) RAE, 90 (6.9%) boshnjakë, 35 (2.7%) të tjerë dhe 2 (0.2%), banorë të huaj në Kosovë.

*Përfaqësimi etnik i mostrës në përqindje*

Nga aspekti i shpërndarjes gjinore 46.3% e respondentëve ishin meshkuj dhe 54.4 % femra. Sa i përket moshës, moshja e respondentëve është radhitur prej 18 deri 83 me një moshë mesatare prej 37.75. Sa i përket vend ndodhjes 46.5% e respondentëve ishin nga zonat rurale dhe 53.5% nga zonat urbane.



Në pyetjen se cilit grup fetar i përkasin, 81% janë përgjigjur të jenë mysliman, 13% ortodoks, 4% katolik, 2% protestant dhe 2% të grupeve tjera fetare. Kur është krahasuar në aspektin e përqindjes së etnive për Kosovë, denominimi fetar është si në vijim: 88% mysliman, 5% ortodoks, 6% katolik, dhe 1% protestant.

*Religjioni i mostrës, pas peshimit në baza etnike*

**SHTOJCA III – METODOLOGJIA E HULUMTIMIT TË ORGANIZATAVE**

Hulumtimi i Organizatave është bërë nga një ekip i hulumtuesve të ISHC-së gjatë vjeshtës së vitit 2009 dhe pranverës së vitit 2010, me 100 OSHC aktive nga të gjitha fushat e aktivitetit dhe regionet e Kosovës.

Mostra e këtij hulumtimi ka marrë parasysh balancën në mes të OSHC-ve të mëdha dhe kombëtare si dhe OSHC-ve të vogla dhe lokale, mbulimin gjeografik të Kosovës si dhe fushat e ndryshme të punës të mbuluara nga ky sektor. Bazuar në këtë, Komiteti Këshillues është pajtuar të caktojë një mostër që përbëhet nga: 10 OSHC të mëdha, 10 OSHC të vogla, 40 OSHC sipas fushave të ndryshme të punës, dhe 40 OSHC sipas shpërndarjes gjeografike. Kushti tjetër për mostrën e Hulumtimit të Organizatave ka qenë se është dashur të intervistohen vetëm OSHC-të aktive, e që janë OSHC-të që kanë ndonjë lloj të aktivitetit gjatë vitit të fundit.

Pyetësi origjinal i hulumtimit të organizatave është përpiluar nga CIVICUS, ndërsa pyetjet plotësuese janë përfshirë nga ekipi i ISHC-së në Kosovë. Pyetësi gjithëpërfshirës përfshinte 49 pyetje dhe një numër të nën-pyetjeve specifike të cilave OSHC-të duhej t’i përgjigjeshin. Hulumtimi është bërë përmes kombinimit të pyetësorëve elektronik dhe intervistave direkte, si dhe një numri të vizitave në regionet e ndryshme të Kosovës. Është e rëndësishme të përmendet se të gjithë respondentët e Hulumtimit të Organizatave kanë qenë staf me përvojë nga OSHC-të e hulumtuara, me qëllim të marrjes së informatave të fundit dhe të besueshme për OSHC-të përkatëse.

**SHTOJCA IV – METODOLOGJIA PËR HULUMTIMIN E PERCEPTIMIT TË JASHTËM**

Hulumtimi i Perceptimit të Jashtëm është bërë nga ekipi hulumtues i ISHC-së gjatë pranverës së vitit 2010, me grupet kryesore të interesit, ekspertë dhe politikë-bërësit në sektore kyçe jashtë shoqërisë civile. 40 individë të dalluar nga të gjitha sektoret e shoqërisë janë intervistuar gjatë një interviste prej 30 deri 45 minuta, duke iu përgjigjur nëntë pyetjeve dhe nën-pyetjeve më specifike mbi perceptimet e tyre lidhur me shoqërinë civile në Kosovë. Pyetësi i thjeshtë ka siguruar pasqyrimin e perceptimeve mbi aspektet kyçe të shoqërisë civile.

Mostra e respondentëve është aprovuar nga Komiteti Këshillues (KK), në pajtim me udhëzimet e CIVICUS, dhe ka synuar përfaqësimin e të gjitha sektoreve të shoqërisë sipas rëndësisë së tyre brenda shoqërisë në përgjithësi dhe shoqërisë civile në veçanti.

| Sektorët   | Numri i respondentëve |
|--|-----------------------|
| Qeveria qendrore dhe lokale                                | 5                     |
| Kuvendi i Kosovës  | 3                     |
| Sistemi Gjyqësor   | 3                     |
| Sektori Privat   | 3                     |
| Mediat   | 5                     |
| Qarqet akademike   | 3                     |
| Organizatat ndërkombëtare qeveritare                       | 3                     |
| Donatorët  | 2                     |
| Të tjerë   | 2                     |
| Misionet ndërkombëtare në Kosovë (EULEX, ZCN, UNMIK, KFOR) | 3                     |
| Partitë politike   | 5                     |
| Agjencitë e pavarura                                       | 3                     |

**SHTOJCA V – PËRMBLEDHJET E RASTEVE TË STUDIMIT****Angazhimi Civil në Kosovë**

Ky rast studimor tenton të hulumtojë se cili është niveli i angazhimit qytetar në Kosovë, cilët janë faktorët që ndikojnë në organizimin qytetar, dhe cilat janë vlerat e kosovarëve rreth jetës demokratike dhe pjesëmarrëse. Zhgënjimi me politikën vendore si dhe atë ndërkombëtare sot është një nga indikatorët kryesor të ndjenjave politike të qytetarëve kosovarë. Gjetjet tregojnë një zvogëlim konstant të besimit të qytetarëve në politikanë dhe në politikë, e që reflektojnë me rënie në angazhimin civil. Gjithashtu, ky studim ofron rekomandime për qeverinë, komunat dhe qytetarët ashtu që secila palë të mund t'i përmbushë rolin dhe detyrat e saj për të arritur një nivel më të lartë të qytetarisë aktive.

**Bashkëpunimi në mes OSHC-ve – Ligji mbi OJQ-të 2010**

Ky rast studimi tenton të hulumtojë pse bashkëpunimi në mes OSHC-ve brenda rrjeteve të ndryshme nuk është në nivelin e kënaqshëm. Një nga arsyet e identifikuara në këtë studim duket të jetë fakti se rrjetet kanë qenë rrjete të nxitura nga donatorët dhe kanë pushuar së funksionuari pas tërheqjes së donatorëve, ndërsa rastet e suksesshme kanë qenë të bazuara në interesat e vet OSHC-ve dhe nevojën për fuqizim përmes veprimeve të përbashkëta. Në kuadër të këtij studimi, diskutohet një shembull i mirë i bashkëpunimit ndër-sektoral që bazohet në interesat e përbashkëta dhe koordinimin efikas, e që është procesi i suksesshëm i avokimit lidhur me procesin për amendamentimin e Ligjit mbi OJQ-të të vitit 2010.

**Shoqata humanitare dhe bamirëse 'Nëna Tereze'**

Ky dokument është një rast studimi mbi nivelin e lartë të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe vullnetarizmit në fazën e para luftës dhe luftës në Kosovë. Aktori kryesor i këtij studimi është shoqata 'Nëna Tereze'. Si një organizatë e pavarur humanitare që ka luajtur një rol qendror në dhënien e shërbimeve mjekësore dhe shpërndarjen e ushqimit dhe format e tjera të ndihmës humanitare në të gjitha pjesët e Kosovës. 'Nëna Tereze' ka pasur më tepër se 7,200 vullnetarë gjatë viteve të 90-ta, ndërsa sot i ka 4,200 vullnetarë të regjistruar të cilët janë aktiv vetëm në mënyrë sporadike, varësisht nga projektet dhe aktivitetet e mundshme. Mospërshtatshmëria e strategjisë së tyre sipas realitetit të ri në vend është një nga arsyet për këtë rënie, dhe për mungesën e motivimit për vullnetarë potencial, krahasuar me vitet e 90-ta.

**Bashkëpunimi në mes të shoqërisë civile dhe Kuvendit të Kosovës (përfshirja e OSHC-ve në procesin ligjvënës)**

Ky rast studimi tenton të hulumtojë deri në çfarë shkalle është zhvilluar bashkëpunimi në mes të Kuvendit të Kosovës dhe OSHC-ve dhe cilat mekanizma ligjore mundësojnë përfshirjen e OSHC-ve në procesin ligjvënës në nivel të Kuvendit. Gjetjet tregojnë se ekzistojnë disa 'dyer të hapura' që nuk janë shfrytëzuar mjaft as nga autoritetet publike as nga OSHC-të. Përveç kësaj, ai sugjeron se dispozitat e përgjithshme aktuale mbi përfshirjen e OSHC-ve në procesin ligjvënës duhet të bëhen funksionale përmes mekanizmave konkrete të bashkëpunimit. Studimi gjithashtu ofron disa rekomandime për Kuvendin, Deputetët dhe OSHC-të, mbi atë se si të përmirësohen mekanizmat e shpërndarjes së informatave dhe bashkëpunimit me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes aktive të OSHC-ve në procesin ligjvënës.



### Departamenti për Regjistrim dhe Ndërlidhje me OJQ

Ky rast studimi tenton të analizojë funksionimin ligjor dhe praktik të Departamentit për Regjistrim dhe Ndërlidhje me OJQ, si organi i vetëm i Qeverisë për ndërlidhje me OJQ. Gjetjet e këtij studimi tregojnë se aktualisht departamenti kryen punët e tij vetëm pjesërisht, ndërsa roli i tij ndërlidhës nuk kuptohet dhe nuk përmbushet fare. Përveç kësaj, gjetjet tregojnë një mungesë të madhe të kapaciteteve brenda këtij departamenti për bashkëpunimin me sektorin e shoqërisë civile. Gjithashtu, studimi ofron disa rekomandime për qeverinë, departamentin përkatës dhe OSHC-të, dhe rekomandon qartësimin e kornizës ligjore për reformën institucionale në fushën e komunikimit dhe zhvillimit të politikave lidhur me sektorin e shoqërisë civile.

### Fondet e donatorëve ndërkombëtarë për shoqërinë civile në Kosovë

Qëllimi kryesor i këtij rasti të studimit ka qenë gjetja e trendit të përafërt të fondeve të donatorëve ndërkombëtarë për shoqërinë civile në Kosovë, posaçërisht për periudhën 2007-2009 dhe 2010-2012. Studimi gjithashtu tenton t'i gjejë arsyet e mundshme për rënien e fondeve të donatorëve. Edhe pse shuma e fondeve nga donatorët e mëdhenj nuk ka pasur lëvizje të mëdha gjatë kësaj periudhe, shumë donatorë të vegjël duket t'i kenë mbyllur programet e tyre në Kosovë, duke zvogëluar kështu shumën e përgjithshme të fondeve për shoqërinë civile. Përveç kësaj, studimi ka zbuluar një trend ku donatorët e mëdhenj nuk ndajnë fonde të veçanta për shoqëri civile, mirëpo shoqëria civile do të mund të përfitojë nga fondet sektorale tjera. Studimi gjithashtu elaboron disa forma alternative të financimit të OSHC-ve që do të mund t'i zëvendësonin fondet e huaja, dhe ofron disa rekomandime për qeverinë, donatorët, si dhe OSHC-të në lidhje me bashkëpunimin me OSHC-të, duke përshtatur strategjitë në pajtim me nevojat e qytetarëve dhe duke rritur transparencën dhe llogaridhënien e tyre.

## SHTOJCA VI –MATRIKSA E INDIKATORËVE TË ISHC-SË NË KOSOVË

| Matriksa e Indikatorëve të ISHC-së në Kosovë<br>(Bazuar në të dhënat e Hulumtimit të Popullësisë, Hulumtimit të Organizatave dhe Hulumtimit të Perceptimeve të Jashtme) |                                     |                                     |              |
|---|-------------------------------------|-------------------------------------|--------------|
| Nën-dimensioni  | Indikator                           | Emri                                | Rezultati    |
| <b>1) Dimensioni: Angazhimi Civil</b>   |                                     |                                     | <b>44.03</b> |
| 1.1   | Shtrirja e angazhimit shoqëror      |                                     | 21.60        |
|   | 1.1.1                               | Anëtarësimi shoqëror 1              | 15.50        |
|   | 1.1.2                               | Vullnetarizmi shoqëror 1            | 14.00        |
|   | 1.1.3                               | Angazhimi komunitar 1               | 35.30        |
| 1.2   | Thellësia e angazhimit shoqëror     |                                     | 40.50        |
|   | 1.2.1                               | Anëtarësimi shoqëror 2              | 26.40        |
|   | 1.2.2                               | Vullnetarizmi shoqëror 2            | 30.80        |
|   | 1.2.3                               | Angazhimi komunitar 2               | 64.30        |
| 1.3   | Diversiteti i angazhimit shoqëror   |                                     | 80.86        |
|   | 1.3.1                               | Diversiteti i angazhimit shoqëror   | 80.86        |
| 1.4   | Shtrirja e angazhimit politik       |                                     | 21.63        |
|   | 1.4.1                               | Antarësimi politik                  | 12.90        |
|   | 1.4.2                               | Vullnetarizmi politik 1             | 15.30        |
|   | 1.4.3                               | Aktivizmi individual 1              | 36.70        |
| 1.5   | Thellësia e angazhimit politik      |                                     | 32.50        |
|   | 1.5.1                               | Antarësimi politik 2                | 26.30        |
|   | 1.5.2                               | Vullnetarizmi politik 2             | 28.30        |
|   | 1.5.3                               | Aktivizmi individual 2              | 42.90        |
| 1.6   | Diversiteti i angazhimit politik    |                                     | 67.08        |
|   | 1.6.1                               | Diversiteti i angazhimit politik    | 67.08        |
| <b>2) Dimensioni: Niveli i organizimit</b>  |                                     |                                     | <b>70.73</b> |
| 2.1   | Qeverisja e brendshme               |                                     | 89.90        |
|   | 2.1.1                               | Menaxhmenti                         | 89.90        |
| 2.2   | Infrastruktura                      |                                     | 69.70        |
|   | 2.2.1                               | Organizatave mbështetëse/Rrjetet    | 69.70        |
| 2.3   | Komunikimi sektoral                 |                                     | 88.40        |
|   | 2.3.1                               | Komunikimi i brendshëm 1            | 89.90        |
|   | 2.3.2                               | Komunikimi i brendshëm 2            | 86.90        |
| 2.4   | Burimet njerëzore                   |                                     | 18.30        |
|   | 2.4.1                               | Qëndrueshmëria e burimeve njerëzore | 18.30        |
| 2.5   | Burimet financiare dhe teknologjike |                                     | 87.35        |
|   | 2.5.1                               | Qëndrueshmëria financiare           | 83.80        |
|   | 2.5.2                               | Burimet teknologjike                | 90.90        |

## Matriksa e Indikatorëve të ISHC-së në Kosovë

(Bazuar në të dhënat e Hulumtimit të Popullësisë, Hulumtimit të Organizatave dhe Hulumtimit të Perceptimeve të Jashtme)

| Nën-dimensioni                            | Indikator  | Emri  | Rezultati    |
|---|--|---|--------------|
| <b>3) Dimensioi: Praktikimi i Vlerave</b> |  |   | <b>59.43</b> |
| 3.1                                       | Qeverisja me vendimarrje demokratike               |   | 61.60        |
|   | 3.1.1  | Vendim-marrja   | 61.60        |
| 3.2                                       | Rregulloret e punës                                |   | 42.30        |
|   | 3.2.1  | Mundësitë e barabarta                                   | 55.60        |
|   | 3.2.2  | Anëtarët e sindikatave të punës                         | 9.89         |
|   | 3.2.3  | Trajnimet mbi të drejtat e punës                        | 35.70        |
|   | 3.2.4  | Politika të hapura për publikun mbi standardet e punës  | 68.00        |
| 3.3                                       | Kodi i mirësjelljes dhe transparenca               |   | 74.20        |
|   | 3.3.1  | Kodi i mirësjelljes në dispozicion të publiku           | 73.70        |
|   | 3.3.2  | Transparenca  | 74.70        |
| 3.4                                       | Standardet mjedisore                               |   | 57.70        |
|   | 3.4.1  | Standardet mjedisore                                    | 57.70        |
| 3.5                                       | Perceptimi i vlerave në shoqërinë civile si tërësi |   | 61.35        |
|   | 3.5.1  | Perceptimi i kundërshtimit të dhunës                    | 57.10        |
|   | 3.5.2  | Perceptimi i demokracisë së brendshme                   | 49.50        |
|   | 3.5.3  | Perceptimi i nivelit të korupsionit                     | 26.30        |
|   | 3.5.4  | Perceptimi i jo-tolerancës                              | 88.90        |
|   | 3.5.5  | Pesha e përceptuar e gurpeve jo-tolerante               | 67.50        |
|   | 3.5.6  | Perceptimi i promovimit të paqes dhe luftimit të dhunës | 78.80        |

## Matriksa e Indikatorëve të ISHC-së në Kosovë

(Bazuar në të dhënat e Hulumtimit të Popullësisë, Hulumtimit të Organizatave dhe Hulumtimit të Perceptimeve të Jashtme)

| Nën-dimensioni                            | Indikatori                                  | Emri   | Rezultati    |
|---|---|--|--------------|
| <b>4) Dimensioi: Ndikimi i Perceptuar</b> |   |  | <b>31.81</b> |
| 4.1                                       | Reagueshmëria (përceptim i brendshëm)       |  | 26.75        |
|   | 4.1.1                                       | Ndikimi në zhvillimin ekonomik   | 21.20        |
|   | 4.1.2                                       | Ndikimi në sundimin e ligjit   | 32.30        |
| 4.2                                       | Ndikimi shoqëror (përceptim i brendshëm)    |  | 47.58        |
|   | 4.2.1                                       | Ndikimi i përgjithshëm shoqëror  | 43.80        |
|   | 4.2.2                                       | Ndikimi shoqëror i vet organizatës   | 51.35        |
| 4.3                                       | Ndikimi në politika (përceptim i brendshëm) |  | 39.40        |
|   | 4.3.1                                       | Ndikimi i përgjithshëm në politika   | 21.20        |
|   | 4.3.2                                       | Aktiviteti i vet organizatës në politika   | 59.60        |
|   | 4.3.3                                       | Ndikimi i vet organizatës në politika  | 37.40        |
| 4.4                                       | Reagueshmëria (përceptimi i jashtëm)        |  | 23.75        |
|   | 4.4.1                                       | Ndikimi në zhvillimin ekonomik   | 25.00        |
|   | 4.4.2                                       | Ndikimi në sundimin e ligjit   | 22.50        |
| 4.5                                       | Ndikimi shoqëror (ndikimi i jashtëm)        |  | 41.50        |
|   | 4.5.1                                       | Ndikimi shoqëror në problemet e selektuara   | 40.50        |
|   | 4.5.2                                       | Ndikimi shoqëror në përgjithësi  | 42.50        |
| 4.6                                       | Ndikimi në politika (përceptim i jashtëm)   |  | 31.65        |
|   | 4.6.1                                       | Ndikimi në politikat e fushave specifike   | 30.80        |
|   | 4.6.2                                       | Ndikimi në politikat në përgjithësi  | 32.50        |
| 4.7                                       | Ndikimi i Shoqërisë Civile në qëndrime      |  | 12.04        |
|   | 4.7.1                                       | Ndryshimi në besim ndërpersonal në mes të antarëve të shoqërisë civile dhe jo-antarëve         | 2.75         |
|   | 4.7.2                                       | Ndryshimi në nivlete e tolerancës në mes të antarëve të shoqërisë civile dhe jo-antarëve       | 0.00         |
|   | 4.7.3                                       | Dallimi në mes të ndjeshmërisë publike në mes të anëtarëve dhe jo-antarëve të shoqërisë civile | 0.00         |
|   | 4.7.4                                       | Besimi në shoqërinë civile   | 45.40        |
| <b>5) Dimensioi: Ambienti i Jashtëm</b>   |   |  | <b>51.34</b> |
| 5.2                                       | Konteksti socio-politik                     |  | 46.63        |
|   | 5.2.1                                       | Të drejtat dhe liritë politike   | 27.50        |
|   | 5.2.2                                       | Sundimi i ligjit dhe liritë personale  | 35.40        |
|   | 5.2.3                                       | Të drejtat e organizimit dhe pjesëmarrjes  | 50.00        |
|   | 5.2.4                                       | Përvoja nga korniza ligjore  | 77.25        |
|   | 5.2.5                                       | Efektiviteti i shtetit   | 43.00        |
| 5.3                                       | Konteksti socio-kulturor                    |  | 56.05        |
|   | 5.3.1                                       | Besimi ndërpersonal  | 9.10         |
|   | 5.3.2                                       | Toleranca  | 62.58        |
|   | 5.3.3                                       | Ndjeshmëria publike  | 96.47        |

## BIBLIOGRAFIA

Balkan Monitor (2008): *Raporti Analitik 2008*. Gallup dhe European Funds for the Balkans.

Balkan Monitor (2009): *Raporti Analitik 2009*. Gallup dhe European Funds for the Balkans.

Balkan Monitor (2010): *Raporti Analitik 2010*. Gallup dhe European Funds for the Balkans.

Bekaj, Armend (2005): *Civil Society and Peace-building Partnership Gaps in Post-War Kosovo: Analysis of Local NGOs*. Department of Peace Studies, University of Bradford.

Bertelsmann Stiftung (ed.) (2010): *Transformation Index 2010 – Political Management in International Comparison*. Bertelsmann Stiftung.

Blair, Harry, Donaghey, Lorel dhe Velija, Dardan (2004): *Kosovo Civil Society Sector Assessment*. USAID/Kosovë dhe USAID Center for Democracy and Governance.

*Commission Communication on the Western Balkans*, COM(2008)127 final, 5.3.2008. Bruksel, Komisioni Europian.

*Commission Staff Working Paper*. SEC(2009)128 final 3.2.2009 Bruksel, Komisioni Europian.

Duchene, Steve (2006): *Country Profile UNMIK Kosovo*. Salto-Youth South East Europe Resource Centre.

European Center for Not-for-Profit Law (2009): *Legal Environment Assessment Report – Kosovo*. Pristina, Kosovo, Institute for Sustainable Communities (ISC) – Civil Society Strengthening Program in Kosovo.

*European Governance – A White Paper*. (2001) COM(2001) 428 final, 25.7.2001. Bruksel, Komisioni Europian.

External Affairs, Communications and United Nations Affairs, Environmentally and Socially Sustainable Development Network, Operations Policy and Country Services Network, and the World Bank (2005): *Issues and Options for Improving Engagement between the World Bank and Civil Society Organizations*. Banka Botërore.

Freedom House (2009): *Freedom in the World Survey Report*. Uebfaqja e Freedom House (<http://www.freedomhouse.org/>)

Gardner, Rebecca dhe Weichih, Yang (2005): *Analiza e Shoqërisë Civile të Kosovës*. Prishtinë, Kosovë. Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

Grup autorësh (2006): *Roli i shoqërisë civile në modernizimin shtetit të mirëqenjes/ Partneriteti në mes Qeverisë dhe shoqërisë civile në Kosovë – Rruga përpara*.

Grup autorësh (2006): *Rinia – Një gjeneratë e re për një Kosovë të re/Raporti i Zhvillimit Njerëzor 2008*. Prishtinë, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë.

Grup autorësh (2009): *Shoqëria Civile dhe Zhvillimi/Raporti i Zhvillimit Njerëzor 2008*. Prishtinë, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë.

Haxhikadrija, Amir dhe Hoxha, Taulant (2011): *Drejt një bashkëpunimi të strukturuar në mes të autoriteteve publike dhe shoqërisë civile – Analizë e praktikave të mira të rajonit dhe Europës*. Prishtinë, Kosovë. Platforma CiviKos.

Heinrich, Volkhart Finn dhe Fioramonti, Lorenzo (eds.) (2008): *CIVICUS Global Survey of the State of Civil Society, Volume 2: Comparative Perspectives*. Bloomfield: Kumarian Press.

Heinrich, Volkhart Finn dhe Naidoo, Kumi (2001): *From Impossibility to Reality. A Reflection and Position Paper on the CIVICUS Index on Civil Society Project 1999-2001*. Washington, DC: CIVICUS World Alliance for Citizen Participation.

International Center for Not-for-Profit Law (ICNL) (1997): *Guidelines for Laws affecting Civic Organizations*. Open Society Institute (OSI)

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (2001): *Antologjia e shoqërisë civile*. Prishtinë: Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (2009): *Strategjia e Fondit për Grante për Shoqërinë Civile*. Prishtinë, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) (2010): *Dyert, gjysmë të mbyllura apo të hapura? Një studim i shkurtë rreth përfshirjes së shoqërisë civile në procesin legjislativ*. Prishtinë, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) (2010): *The State of Civil Dialogue – Country Situation Kosovo*. Prishtinë, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

Kosovar Research and Documentation Institute – KODI (2007): *Civil Society and the legislative process in Kosovo – Analytical Study at the end of the Second Mandate of the Assembly of Kosovo*. Prishtinë, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE) – Misioni në Kosovë.

*Looking for civil society across the Balkans*. (2009)– EUCLID Network 2009.

Mati, Jacob M, Silva, Federico dhe Anderson, Tracy (2010): *Assessing and Strengthening Civil Society Worldwide: An updated programme description of the CIVICUS Civil Society Index Phase 2008-2010*. Johannesburg: CIVICUS: World Alliance for Citizen Participation.

Members of the Expert Council on NGO Law (2009): *Expert Council on NGO Law – First Annual Report*. OING Conf/Exp (2009) 1. Konferenca e OJQ-Nve e Këshillit të Europës.

Mitchell, Lincoln, Fremming, James dhe Malazogu, Leon (2008): *Kosovo Civil Society Program Final Evaluation Report*. United States Agency for International Development (USAID)

Mrak, Mojmir dhe Tilev, Dragan (2008). *Absorbimi i fondeve të para-antarësimit të BE-së: Koncepte dhe implikimet për Kosovën*. Forumi 2015, Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) and Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

Popper, Karl Raimund (1966): *The Open Society and its enemies – Volume I, The spell of Plato, Fifth edition (revised)*. Princeton, New Jersey: Princeton University Press.

Shatri, Nexhat dhe Zeqiraj, Nehare. *Avokimi për arritjen e mundësive të barabarta dhe pengimin e diskriminimit institucional të personave me aftësi të kufizuar*. Shoqata e personave me paralizë të

fëmijëve “Handicap Kosova” dhe Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështje Gjinore.

Enti Statistikor i Kosovës (2007): *Statistikat Vitale të Kosovës 2006*. Prishtinë: Statistical Office of Kosovo.

Sterland, Bill dhe Rizova, Galina (2010): *The Civil Society environment in the Western Balkans and Turkey – Progress made by governments in IPA countries towards establishing and enabling environment for civil society/A needs assessment report*. Technical Assistance to Civil Society Organizations in the IPA Countries (TACSO).

USAID (2007): *NGO Sustainability Index or Central and Eastern Europe and Eurasia*

USAID (2008): *NGO Sustainability Index or Central and Eastern Europe and Eurasia*

USAID (2009): *NGO Sustainability Index or Central and Eastern Europe and Eurasia*

Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (2010): *State of constriction? – Governance and Free Expression in Kosovo*. Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut.

YVG Kosovo (2005): *Young People in Kosovo*. Misioni i Bankës Botërore në Kosovë.



## MISIONI

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile - KCSF është organizatë e pavarur, jo-fitimprurëse e fokusuar në përkrahjen e iniciativave civile lokale që çojnë në një lëvizje e fuqishme të shoqërisë civile që do të promovojë një kulturë demokratike dhe për t'iu përgjigjur nevojave socio-ekonomike të Kosovës. Perspektiva e integritit evropian të Kosovës i ka sjellë KCSF-së një fokus të fuqishëm në çështjet e lidhura në kornizën e BE-së për Ballkanin Perëndimor dhe Kosovën në veçanti.

## PROGRAMET DHE AKTIVITETET

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile, në kuadër të fushëveprimtarisë së tij angazhohet në kuadër të dy programeve kryesore:

### *Programi i zhvillimit të shoqërisë civile*

Në kuadër të këtij programi, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile angazhohet në përkrahjen e iniciativave civile lokale që çojnë në një lëvizje e fuqishme të shoqërisë civile që do të promovojë një kulturë demokratike dhe për t'iu përgjigjur nevojave socio-ekonomike të Kosovës. Konkretisht, në vitet e fundit KCSF angazhohet për krijimin e një ambienti favorizues për funksionimin e shoqërisë civile në Kosovë, nëpërmjet:

- Ngritjes së kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile dhe autoriteteve publike në Kosovë nëpërmjet ofrimit të informatave, analizave, studimeve, trajnimeve për dhe rreth shoqërisë civile, si dhe rreth bashkëpunimit të autoriteteve publike me organizatat e shoqërisë civile
- Avokimit të drejtpërdrejtë për krijimin e kornizës ligjore dhe mekanizmeve të nevojshme për fuqizimin e rolit të shoqërisë civile në shoqërinë kosovare
- Përkrahjes dhe pjesëmarrjes në iniciativat e rrjetëzimit vendor dhe ndërkombëtar të organizatave të shoqërisë civile

## TË ARRITURAT

- 284 PROJEKTE TË FINANCUARA
- 403 BURSA STUDIUMI
- MBI 600 TË DIPLOMUAR NË SHKOLLËN PËR INTEGRIME EUROPIANE
- MË SHUMË SE 150 TRAJNIME BAZIKE DHE TË AVANCUARA
- MË SHUMË 25 PUBLIKIME



## Si të na kontaktoni?

Fazli Grajqevci 4/a

10000 Prishtinë, Kosovë

Tel/Fax: + 381 (0)38 248 636, 248 643

E-mail: [office@kcsfoundation.org](mailto:office@kcsfoundation.org)

Web: [www.kcsfoundation.org](http://www.kcsfoundation.org)

### *Programi i përkrahjes së procesit të integritit evropian*

Në kuadër të këtij programi, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile angazhohet të promovojë përmirësimin e njohurive për funksionimin e BE-së, të ngritjes së vetëdijes publike dhe promovojë dialogun në procesin e Integritit Evropian. Konkretisht, përmes këtij programi KCSF angazhohet për përshejtimin e procesit të integritit Evropian, informimin dhe ngritjen e vetëdijes për procesin, sikurse edhe monitorimin e zbatimit të dokumenteve kyçe që kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe BE-së, nëpërmjet:

- Informimit dhe ngritjes së vetëdijes së shoqërisë kosovare lidhur me Procesin e Integritit Evropian
- Ngritjes së kapaciteteve të organizatave qeveritare, të shoqërisë civile, mediave dhe autoriteteve publike në Kosovë për Bashkimin Evropian nëpërmjet ofrimit të informatave, analizave, studimeve për dhe rreth procesit të integritit Evropian
- Avokimit të drejtpërdrejtë për krijimin e mekanizmeve të nevojshëm për shfrytëzimin e kapaciteteve të shoqërisë civile në këtë proces
- Promovimit të bashkëpunimit rajonal në procesin e integritit evropian dhe fushat sektoriale të BE-së, nëpërmjet rrjetëzimit dhe ndërtimit të partneriteteve sektoriale nga politikat e përbashkëta të BE-së



Indeksi i Shoqërisë Civile (ISHC) është një hulumtim i bazuar në veprim që ka për qëllim vlerësimin e gjendjes së shoqërisë civile nëpër shtetet e mbarë botës. Projekti iniciohet dhe zbatohet nga dhe për organizatat e shoqërisë civile në nivel vendi, në partneritetet me Aleancën Botërore për Pjesëmarrje Qytetare CIVICUS. Metodologjia globale është e dizajnuar ashtu që të nxjerrë informata specifike në nivel vendi, sikurse edhe informata krahasuese në mes të vendeve dhe rajoneve të ndryshme.

Shumica e të dhënave sasiore janë uniforme dhe lehtë të krahasueshme nga të gjitha vendet që e zbatojnë ISHC-në, ndërsa të dhënat cilësore dhe analizat synojnë që të ofrojnë informata rreth gjendjes së shoqërisë civile në secilin vend në veçanti.

Qasja e projektit të ISHC-së kombinon vlerësimin dhe faktet me reflektim dhe veprim. Si i tillë, ISHC nuk prodhon njohuri për hir të vetes, por synon që këtë dije të nxjerrë ta aplikojë direkt për të nxitur strategji që do ta ngrisin efektivitetin dhe rolin e shoqërisë civile.

PËRKRAHUR NGA:

**B | T | D** The Balkan Trust  
for Democracy

A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND